

**ASLLAN HAMITI**

**PARALELJA SHQIPE NË DY  
FJALORËT SHUMËGJUHËSH  
TË GJORGJI PULEVSKIT**



ASLLAN HAMITI

**PARALELJA SHQIPE  
NË DY FJALORËT  
SHUMËGJUHËSH  
TË GJORGJI PULEVSKIT**

Botoi dhe shtypi  
“Vatra”

Shkup, 2005

Biblioteka:  
Gjuhësi

Botues dhe redaktor:  
Halil Zendeli

Recensues:  
Prof. dr. Imri Badallaj  
Prof. dr. Haki Ymeri

CIP - Каталогизација во публикација  
Национална и универзитетска библиотека  
„Св. Климент Охридски“, Скопје

811.18-374.823(18)

HAMITI, Asllan

Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit  
Asllan Hamiti.- Shkup: Vatra, 2005, -225 str.  
Biblioteka: Gjuhësi

Фусноти кон текстот. – Библиографија: стр. 210-220.- Sumamara;  
The parallel in Albanian in the two dictionaries of Gjorgji Pulevski

ISBN 9989-665-51-6

а) Пулевски, Ѓорѓи (1838-1895)- Лексикографска дејност- албански јазик  
б) албански јазик – Лексикографија-19 век.

COBISS.MK-ID 61923594

## Shkurtesa, shenja transkriptimi dhe shenja të tjera plotësuese

Fjalori I ose vetëm I – *Fjalori katërgjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht-greqisht*, Beograd, 1873.

Fjalori II ose vetëm II – *Fjalori trigjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht*, Beograd, 1875.

[ë] – kllapa katrore për të shënuar tingujt (p.sh. tingulli [a])

// - kllapa të pjerrëta për të shënuar fonemat (p.sh. fonema /p/)

~ - kundërvënie fonologjike midis dy gjymtyrëve të kundërvënies (p.sh. /a/ ~ /e/: dash ~ desh)

: - zanore e gjatë (p.sh. /a:/ pla:k “plakë“)

^ - zanore hundore (p. sh. ã ose â: kâm “këmbë“)

í – zanore e theksuar (p.sh. lirí)

ì - zanore me theks dytësor (p.sh. lirìdâshës)

a<sup>o</sup> – [a] e buzorëzuar

γ - një [y] më pak buzore se varianti themelor i [y]-së, që gjendet afër [i]-së

η - bashkëtingëllore mbylltore, prapagjuhore, tingëlluese, hundore (p.sh. ngat > ηat)

< > - shenjë konvencionale për të shënuar shkronjat (p.sh. shkronja <t>)

[...] – forma shqiptimore e fjalës (p.sh. shkruhet: <pedagogia>, lexohet [pedagog-ja])

> - forma në të majtë kalon fonetakisht në formën në të djathtë (p.sh. shtëpi > shpi)

< - forma në të djathtë kalon fonetakisht në formën në të majtë (p.sh. rryp < rrip)

ı - diftong (p.sh. mı̄r < mirë)

/ - shënon një ndërprerje të shkurtër në rrjedhën e të folurit (presjen) si (p.sh. Agroni/shoku im ...)

// - shënon një pushim të gjatë, të ngjashëm me pikën (p.sh. Unë jam student//)

## PASQYRA E LËNDËS

1. HYRJE .....	5
1.1. Gjorgji Pulevski dhe veprimtaria e tij .....	9
1.2. Punimet e derisotme për veprimtarinë e Pulevskit .....	13
2. STRUKTURA E FJALORËVE DHE RËNDËSIA E TYRE .....	17
3. TIPARET GRAFIKE .....	22
3.1. Shkronjat për fonema zanore.....	27
3.2. Shkronjat për fonema bashkëtingëllore .....	33
3.3. Pasqyrë e grafisë së Pulevskit krahasuar me alfabetin e sotëm të shqipes .....	41
4. DUKURITË FONETIKE E FONOLOGJIKE TË SHQIPES SË PULEVSKIT ..	42
5. VEÇORITË MORFOLOGJIKE .....	57
5.1. Emri .....	58
5.2. Mbiemri .....	62
5.3. Përemri .....	64
5.4. Folja .....	67
5.4. 1. Mënyrat e pashtjelluara .....	72
5.5. Ndajfolja .....	74
5.6. Parafjala .....	74
5.7. Lidhëzat .....	75
5.8. Pjesëza .....	76
5.9. Pashirrma .....	77
6. VËZHGIME PËR PËRKTHIMIN, SINTAKSËN DHE LEKSIKUN E PARALELES SHQIPE TË FJALORËVE TË PULEVSKIT .....	79
7. SHQIPJA E FJALORËVE TË PULEVSKIT VËSHTRUAR NGA ASPEKTI DIALEKTOR .....	85
Përfundim .....	87
Summary .....	98
Fragmente nga dy fjalorët .....	108
Bibliografia .....	120

## 1. HYRJE

Në Fakultetin Filologjik të Prishtinës më vitin 1992, para komisionit prof. dr. Imri Badallaj (mentor), prof. dr. Fadil Raka dhe prof. dr. Murat Blaku (anëtarë) mbrojta me sukses punimin e magjistraturës “Gjuha shqipe në fjalorët e Pulevskit”. Siç dihet, këso kohe arsimit shqip i Kosovës nuk i pranoi masat e dhunshme të pushtetit serb, por veprimtarinë arsimore, shkencore e kombëtare e zhvilloi edhe më tej në mënyrë të pavarur nga pushtetmbajtësit, në kushte shumë të vështira. Përpjekjet e shqiptarëve të Kosovës e më gjerë për ta kundërshtuar dhe luftuar politikën asimiluese serbe hasnin në rezistencë. Veprimtarët shqiptarë dënoheshin me burgje të përjetshme e persekutoheshin me metoda më çnjerëzore. Në një kohë të tillë mjaft të vështirë e të rrezikshme, falë vazhdimësisë së shkollimit shqip si dhe punës arsimore-shkencore të profesorëve të nderuar, punën disavjeçare në studimet pasuniversitare arritëm ta kurorëzojmë me një mbrojtje publike të suksesshme të këtij punimi.

Organet e pushtetit të atëhershëm në Maqedoni, duke u solidarizuar me politikën represive serbe në Kosovë, nuk e njohën për valide punën tonë, andaj edhe magjistraturën nuk e nostrifikuan. Kështu, pas rirregjistrimit në shkallën e tretë, dhënies së dy-tre provimeve dalluese, e njëjta temë u mbarështrua, por tani në maqedonisht, dhe u mbrojt në Fakultetin Filologjik të Shkupit më vitin 1994.

Me rastin e botimit të këtij punimi, falënderoj përzemërsisht mentorin, dhe anëtarët e komisionit recensues të Fakultetit Filologjik të Prishtinës dhe të Katedrës së Gjuhës dhe të Letërsisë Shqiptare të Fakultetit Filologjik “Bllazhe Koneski” të Shkupit.

Objekt shqyrtimi i këtij punimi është ligjërimi shqip, më saktësisht idiolekti shqip i Gjorgji Pulevskit në dy fjalorët shumëgjuhësh: I. Fjalorit katërgjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht-greqisht, Beograd, 1873; dhe II. Fjalorit bisedimor trigjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht, Beograd, 1875.

Vëzhgimin tonë për fjalorët e Pulevskit e kemi mbështetur mbi botimin në origjinal të të dy fjalorëve. Të dy fjalorët i kemi siguruar nga Biblioteka Popullore dhe Universitare e Shkupit me siglat: Fjalori katërgjuhësh: R II-1501/I, ndërsa Fjalori tregjuhësh me siglat: R II-1501/II dbl. Shih ballinat e tyre më poshtë:

<p style="text-align: center;"><b>РЕЧНИК</b></p> <p style="text-align: center;"><b>ОТЪ ЧЕТИРИ ЈЕЗИКА.</b></p> <p style="text-align: center;">I. Српско-Албански. II. Арбански-Арнаутски. III. Турски. IV. Грчки.</p> <p style="text-align: center;">СКРОЈЕНА И НАПИСАНА ОДЪ <b>ЂОРЂА М. ПУЉВСКИ,</b> АРХИТЕКТА У ГАЛИЧНИКЪ ОКОЛУЈЕ ДИБРАНСКО 1872. ГОДИНЕ.</p> <p style="text-align: center;"><b>I-ва ЧАСТЪ.</b></p> <hr style="width: 20%; margin: auto;"/> <p style="text-align: center;"><b>БЕОГРАДЪ,</b> ШТАМПАРИЈА Н. СТЕФАНОВИЊА И ДРУЖИНЕ, 1873. <b>a</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>РЕЧНИК</b></p> <p style="text-align: center;"><b>ОТЪ ЧЕТИРИ ЈЕЗИКА.</b></p> <p style="text-align: center;">I. Српско-аллбански. II. Арбански-Арнаутски. III. Турски. IV. Грчки.</p> <p style="text-align: center;">Скројена и написана одъ <b>ЂОРЂА М. ПУЉВСКИ,</b> архитекта у Галичникъ, околужје дибранско, 1872 године. I-ва ЧАСТЪ. <b>БЕОГРАДЪ.</b></p> <p style="text-align: center;">Штампария Н. Стефановића и Дружине 1873.</p> <p style="text-align: center;"><b>b</b></p>
--	--

1. Ballina e Fjalorit Katërgjuhësh: a) originali, b) e rishkruar me të njëjtin alfabet.

<p style="text-align: center;"><b>РЕЧНИК</b></p> <p style="text-align: center;"><b>ОТ ЧЕТИРИ ЈЕЗИКА.</b></p> <p style="text-align: center;">I. Srpsko-allbanski. II. Arbanski-Arnautski. III. Turski. IV. Grčki.</p> <p style="text-align: center;">Skrojena i napisana ot <b>GJORGJA M. PULEVSKI,</b> arhitekta u Galičnik, okružhje dibransko, 1872 godine. I-va ÇAST. <b>BEOGRAD.</b></p> <p style="text-align: center;">Shtamparija N. Stefanoviqa i Druzhine 1873. <b>c</b></p>
--

2. Ballina e Fjalorit Katërgjuhësh: c) e tejshkruar (e transliteruar) me alfabetin e shqipes

<p>ЏЕРЕМЕТД-ЉИ, МУЏЕРЕМЕТД-ЉИ ДАДЕРИ ЕЉИФ ШАНЛ-; <b>СУЛТАН АБДУЛ АЗИС АЗАМЕТ ЕФЕНД-М-З</b> Саис-нда чинмиш.</p>			<p><b>РЕЧНИК</b></p> <p>ОД ТРИ ЈЕЗИКА</p> <p><b>С. МАКЕДОНСКИ</b></p> <p><b>АРБАНСКИ</b></p> <p>И</p> <p><b>ТУРСКИ</b></p> <p><b>КЊИГА II.</b></p> <p>НАПИСАО</p> <p><b>Ђорѓе М. Пулевски.</b></p>	<p><b>ФЈАЉТОР</b></p> <p>ОСА ТРЕ ГЈУНА</p> <p>ШКЕНИШТ МАКЕ- ДОНИСЕ</p> <p>Ш К И И</p> <p>УДЕ</p> <p><b>ТУРЧИШ</b></p> <p>Либерти II</p> <p>ЕККАШРУУ</p> <p>Ђорѓи Пулес.</p>	<p><b>ЉУГАТ</b></p> <p>УЧ ЛАСАНДИ</p> <p><b>ШИСНИЈМАНЦЕ</b></p> <p><b>АРНАУДЧЕС</b></p> <p>О</p> <p><b>С. МАКЕДОН- ЛУДЕС</b></p> <p>ЉИТАВ II</p> <p>ЈАКШИ</p> <p><b>Ђорѓе М. Пулеоглу.</b></p>
<p>МИЈАК ГАЉИЧКИ,</p> <p>У БЕОГРАД</p> <p>У ДРЖАВНОЈ ШТАМПАРИЈИ</p> <p>ТАБ. ОДУПНИЦ.</p> <p>1875</p>					
<p><b>а</b></p>			<p><b>РЕЧНИК</b></p> <p>ОД ТРИ ЈЕЗИКА</p> <p>С. МАКЕДОНСК И</p> <p>АРБАНСКИ</p> <p>И</p> <p>ТУРСКИ</p> <p>КЊИГА II.</p> <p>НАПИСАО</p> <p><b>ЂОРЂЕ М. ПУЛЕВСКИ.</b></p> <p>МИЈАК ГАЛИЧКИ,</p> <p>У БЕОГРАД</p> <p>У ДРЖАВНОЈ ШТАМПАРИЈ И 1875</p> <p><b>б</b></p>	<p><b>FJALTOR</b></p> <p>NKA TRE G'JUHA</p> <p>SHKINISHT MAKEDONIS E</p> <p>SHKIP</p> <p>EDHE</p> <p>TURQISH</p> <p>Liberti II</p> <p>EKASHRUU</p> <p>GJORGJI PULES.</p> <p>MIJAK GALICËKI,</p> <p>U BEOGRAD</p> <p>U DRZHAVNOJ SHTAMPARIJI 1875</p> <p><b>с</b></p>	

3. Ballina e Fjalorit Tregjuhësh: a) origjinali, b) paralelja në maqedonisht e rishkuar, c) paralelja në shqip e tejshkuar

Studimet filologjike zënë vend të posaçëm në albanologji. Deri më tani është shkruar për gjuhën e shumë shkrimtarëve tanë të traditës. Megjithkëtë edhe më tej duhet vazhduar studimi dhe analiza e teksteve të shkruara. Rezultatet e arritura do të ishin dobiprurëse dhe do të ndriçonin shumë çështje të historisë së gjuhës së shkruar, zhvillimit të dialekteve dhe do të ishin me vlerë për kulturën tonë në përgjithësi. Puna e tillë do të japë rezultate shumëdimensionale, veçmas kur kihet parasysh se shqipja është gjuhë e folur shumë herët, por mjerisht vonë e dokumentuar.<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976, f. 8.



Duke u nisur nga kjo pikëpamje, qëllimi ynë është të ndriçojmë një shqipe të shkruar të shekullit XIX dhe në disa raste, duke e krahasuar me paralelen e shkruar në maqedonishte, të nxjerrim në shesh disa ndërndikime gjuhësore.

Gjatë vëzhgimit gjuhësor të paraleles shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit jemi mbështetur edhe në studimet dhe punimet kushtuar këtij autori. Në punën tonë kemi konsultuar edhe disa punime dialektore që shtjellojnë të folmen shqipe të Dibrës, të Kërçovës, të Tetovës, të Rekës së Epërme, të Gostivarit dhe studime të tjera për grupin e të folmeve të gegërishtes qendrore në përgjithësi. Shfrytëzuam gjithashtu edhe disa artikuj e monografi kushtuar analizës gjuhësore tradicionale të ndonjë teksti e autori të caktuar, studime nga historia e gjuhës shqipe dhe maqedonase<sup>2</sup> etj.

Në analizën gjuhësore të shqipes së dy fjalorëve të Pulevskit kemi zbatuar metodën klasike filologjike, veçmas metodën e analizës, të sintezës, metodën krahasimtare, metodën statistike etj.

Gjatë punës sonë hasëm edhe në disa vështirësi. Ato dalin para së gjithash sepse kemi të bëjmë me një tekst të shkruar, e jo me një ligjërim të folur. Punën e vështirëson edhe fakti se këtu shqipja është shkruar me një alfabet jolatin, autori nuk qe konsekuent në normat e tij dhe shpeshherë gjejmë aq shumë forma fjalësh, saqë e kemi pasur shumë vështirë të gjykojmë cila nga ato larmi formash është autentike. Pulevski vetëm fëmijërinë e hershme e ka kaluar në vendlindje, ndërsa gjatë veprimtarisë së tij si murator ka punuar gjithandej nëpër Ballkan. Si autodidakt nuk zotëronte as njohuritë themelore gjuhësore mëse të nevojshme për një punë leksikografike të suksesshme etj.

Megjithkëtë, pandehim se me këtë punim do të arrijmë të pasqyrojmë tiparet kryesore gjuhësore të shqipes së Pulevskit, opinionin shqiptar ta njoftojmë se nga fundi i shekullit XIX në dy fjalorë shumëgjuhësh, krahas dy-tri gjuhëve të tjera ballkanike, vend të merituar gjen edhe shqipja, të vërtetohet pohimi dhe të jepet edhe një dëshmi se në rrjedhë të kohës, shqipja, përveç me alfabetin latin të përshtatur, alfabetin arabo-turk, grek e ndonjë tjetër, është shkruar edhe me alfabetin cirilik, gjithnjë me përpjekje nga autorë të ndryshëm për të përshtatur abëcëtë e shkrimeve të tyre me inventarin fonematik të shqipes.

Dy fjalorët shumëgjuhësh të Pulevskit, vështuar në tërësinë e trashëgimisë tonë leksikografike, edhe pse nuk meritojnë të zënë ndonjë vend qendror, por për periudhën kohore në të cilën u botuan, vlejnë të përmenden në kuadrin e fjalorëve shumëgjuhësh të kohës dhe përgjithësisht të shënohen në historinë e leksikografisë shqiptare.

Vepra “Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit” përmban një pasqyrë të të dhënave bio-bibliografike për autorin, pasqyrën e punimeve më të rëndësishme për jetën dhe veprimtarinë e Pulevskit, një vështrim për strukturën e fjalorëve dhe rëndësinë e tyre, dhe më pas shqyrtohen tiparet grafike, dukuritë fonetike e fonologjike të shqipes së fjalorëve, çështje të përgjithshme për përkthimin, sintaksën dhe veçoritë leksikore të gjuhës së Pulevskit. Në vazhdim e kemi parë shqipen e fjalorëve nga aspekti dialektor dhe në fund në mënyrë të përmbledhur kemi bërë një përmbyllje në shqip e pastaj edhe në anglisht. Meqë Pulevski dhe dy fjalorët e tij janë pak të njohur në opinionin shqiptar, punimit si material ilustrues ia kemi bashkangjitur edhe disa fragmente nga të dy fjalorët.

Korrik, 2005

Autori

---


<sup>2</sup> Literaturën e konsultuar do ta japim në poshtëshënime gjatë mbarështimit të materies.

## 1.1. GJORGJI PULEVSKI DHE VEPRIMTARIA E TIJ (1817-1893)

Gjorgji (emrin e të cilit e gjejmë të shënuar në disa variante: Gjorgjo, Gjorgjija, Gjorgje, Gjergj; dhe me mbiemrin Pulevski e Pula, 1817-1893) ishte leksikograf, poet, historian, mbledhës i folklorit, gramatikan dhe luftëtar i dalluar kundër perandorisë Osmane për çlirimin e popujve të robëruar. Në bazë të shënimeve të gjetura, por edhe sipas asaj që vetë autori ka shkruar në fjalorë, del se Pulevski qe autodidakt, me profesion murator, ose siç parapëlqente ta quante veten – arkitekt.

Lindi në Galicnik më vitin 1817,<sup>3</sup> katund i Rekës së Vogël në qarkun e Dibrës.<sup>4</sup>

Vetëdija për përkatësinë kombëtare te banorët e Rekës ka qenë dhe ende është mjaft e zbehur. Përgjithësisht, banorët e kësaj ane njohin dy e më tepër gjuhë. Zaten, ka familje që në mënyrë të njëpasnjëshme përdorin disa gjuhë: shqip, maqedonisht, turqisht; por më shpesh dy të parat. Konfiguracioni tokësor malor, izolimi nga pjesët e tjera, por me kontakte të brendshme të zonës së Mjakut, martesat e përziera etj., mund të jenë një ndër faktorët e gjendjes së këtillë. Lulatjes dhe paqartësisë së përkatësisë kombëtare të popullatës së kësaj ane ndonjëherë i vjen në ndihmë përkatësia fetare. Kështu, ata që e ndjejnë veten myslimanë deklarohen për shqiptarë, ndërkaq ortodoksët për maqedonë. Me sa duket, rast i njëjtë është edhe me Pulevskin, i cili veten e shënon edhe si Gjergj Pula.



Për faktorët sociolinguistikë të kësaj çështjeje kanë shkruar disa autorë. Mirëpo, me gjasë, shpjegim më të mirë jep dr. Muhamet Pirraku, kur thotë, veç tjerash, se sipas teorisë së qarqeve diplomatike serbe, në Kosovë (e në Jugosllavinë e dikurshme – shënim yni) nuk ka shqiptarë, por vetëm arnautë – serbë a sllavë të shqiptarizuar, dhe, filluan të thellojnë dukurinë e asimilimit të elementit shqiptar, veçmas të besimit ortodoks. Sllavizimit me anë të kishës, të gjuhës e të alfabetit iu nënshtroan sidomos shqiptarët ortodoksë të Rekës.<sup>5</sup>

Sido që të jetë, duke u mbështetur në të dhënat për jetën dhe veprimtarinë e tij, - Pulevski lindi dhe vetëm fëmijërinë e hershme e kaloi në qarkun e Dibrës, ndërsa pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Beograd e Sofje, mori pjesë aktive në luftën e bullgarëve dhe të rusëve kundër turqve dhe mbi të gjitha nga shkrimet e tija, - mund të thuhet se pavarësisht nga etnogjeneza, Pulevski nuk e ndjeu veten shqiptar. Nga tiparet gjuhësore hetohet se pati kontakte të shpeshta me shumë shqiptarë visesh të ndryshme. Megjithkëtë, përkatësia nacionale e cilitdo njeri nuk është parësore, shumë e

<sup>3</sup> Блаже Конески, *Македонисџиоџи Ѓорѓи (Ѓорѓо) Пулевски*, Културен живот, месечник за култура, просвета, уметност. Орган на работничката културно-просветна заедница на Македонија, година VI, број 2, Shkup, shkurt, 1961, f. 25.

<sup>4</sup> Блаже Ристовски, *Ѓорѓија М. Пулевски*, Одбрани страници, Македонска книга, Скопје, 1974, f. 5.

<sup>5</sup> Muhamet Pirraku, *Çështje të alfabetit të shqipes në qarqet shkencore e diplomatike serbe në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë, 1980, f. 191-199.

rëndësishme është puna e tij. Për ne i vlefshëm është shkrimi i shqipës në dy fjalorët tre-katër gjuhësh. Andaj, si çdo vepër e shkruar në shqip, edhe teksti i Pulevskit meriton një analizë gjuhësore.

Kushtet e vështira ekonomike, pozita e papërshtatshme gjeografike bënë që banorët e këtij qarku të jetojnë në varfëri. Prandaj, afër 90% e meshkujve të Rekës, të aftë për punë, merrnin rrugën e kurbetit.<sup>6</sup> Familja Pula e Rekës që nga të parat që shkoi



për punë sezonale në vend të huaj. Kjo mënyrë e jetesës e përcolli edhe Gjergjin. I ati i Gjergjit ishte kurbetçi, murator në Rumani, në vendin e quajtur Turno-Mogurell.

Njohësit e mirë të jetës dhe të veprimtarisë së Pulevskit thonë se ky e mori me vete të birin qysh atëherë kur Gjergji kishte vetëm shtatë vjet. Atje, nga mjeshtrit dhe shegertët i mësoi shkronjat. Supozohet se nevoja që të komunikojë me anë të letrave me të afërmit e vet dhe me familjen, e cila ende jetonte në Galiçnik, e nxiti Pulevskin që të mësojë shkrim-leximin. Edhe pse nuk pati fat të vijoje ndonjë shkollë të rregullt, pati vullnet të madh dhe interesim për vetarsimim dhe ngritje të përgjithshme intelektuale. Ai u njoh me të kaluarën e popujve të Ballkanit, me gjuhën dhe kulturën ballkanike.

Nga Rumania, në çerekun e parë të viteve 70 të shekullit XIX, Pulevski do të gjendet në Beograd. Aty ai botoi dy fjalorët shumëgjuhësh për të cilët do të bëjmë fjalë.

Kontaktet e shumta të Pulevskit me patriotë nga vise të ndryshme mundësuan që edhe ai të frymëzohej me ide revolucionare e patriotike. Këtë e dëshmojnë, përveç shkrimeve të tija, edhe pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në shumë luftëra. Siç dihet, ai me një çetë bashkatdhetarësh, shumica nga regjioni i Mjakut, mori pjesë në luftën kundër turqve me rastin e rrethimit të kalasë së Beogradit (1862), me çrast garnizoni turk e bombardoi qytetin.<sup>7</sup> Pas përfundimit të luftës, nga qarqet serbe të Beogradit kërkoi të emërohet mësues në vendlindje. Meqë kjo dëshirë nuk i plotësohet, Pulevski shkoi në Sofje të Bullgarisë.

Ai me disa bashkëluftëtarë vullnetarë ishin pjesëmarrës në anën e rusëve në luftën ruso-turke (1877/78), duke u shquar në përlëshjet e njohura në vendin e quajtur Shipka. Meqë u dallua për guxim e trimëri, u dekorua nga perandori rus Aleksandër Nikollaeviq me medalje për trimëri. Pulevski edhe kësaj here nga pushtetmbajtësit kërkoi ndonjë detyrë a punë, por nuk e fitoi.<sup>8</sup>

Do përmendur se Gjergji luftoi kundër perandorisë turke si në territorin e Serbisë, ashtu edhe në tokat e Rusisë, duke menduar se njëherë nga këto troje duhet çrrënjosur sundimi osman e pastaj do të vijë koha kur edhe në Maqedoni dhe në pjesët e tjera të Ballkanit duhet zhvilluar një luftë e tillë. Ishte i mendimit se gjithë të robëruarit duhet ta ndihmojnë njëri-tjetrin, sepse vetëm të bashkuar do të mund të çliroheshin.

Nga skica jetësore e Pulevskit merret vesh se ai mori pjesë në kryengritjen e Kresnenit në Maqedoninë Lindore, që u bë në tetor të vitit 1878. Në këtë kryengritje ai

<sup>6</sup> Глигор Тодоровски, *Малореканскиот предел*, Shkup, 1970, f. 66-69.

<sup>7</sup> Ѓорѓи Пулевски, *Избрани текстови*, приредил д-р Томе Саздов, Наша книга, Shkup, 1985, f. 8.

<sup>8</sup> Блаже Конески, *Македонскиот Ѓорѓу (Ѓорѓо) Пулевски*, Кон македонската преродба, Shkup, 1959, f. 87.

ishite prijës i çetës VI dhe anëtar i Këshillit të vojvodëve. Në vitin 1878 ka qenë prefekt i Qustendillit dhe ditët e fundit të jetës së tij i kaloi në Bullgari. Në vitin 1888 Pulevski ushtroi detyrën e krytarit të shoqërisë letrare sllavo-maqedonase (“Славјанско-Македонска книжевна дружина”) me seli në Sofje. Në pleqëri, larg nga vendlindja, vdiq më 13 shkurt të vitit 1893 në Sofje ku dhe u varros.

Siç shihet, jeta e Pulevskit sillej në trekëndëshin Maqedoni - Serbi - Bullgari. Jeta dhe orientimi i tij revolucionar, patriotik e luftarak do të shprehen edhe në shkrimet e tija. Me pendë e pushkë në dorë luftoi kundër robërisë shumëshekullore turke dhe njëherit kontribuoi për bashkimin e popujve të shtypur në luftë të përbashkët kundër robëruesit të njëjtë.

Vetë fakti se shkroi dy fjalorë: njërin katërgjuhësh e tjetrin tregjuhësh flet bindshëm se ai ishte poliglot, përkatësisht dinte maqedonisht, serbisht, bullgarisht, shqip, greqisht e turqisht. Pulevski kishte mendim të drejtë se në kushtet e bashkëjetesës e të simbiozës në një territor të përbashkët duhej pasur një fqinjësi të mirë ndërmjet popujve si dhe njohja reciproke e gjuhëve, e kulturës, e traditave etj. është mëse e nevojshme. Përveç kësaj, popujt kanë nevojë shumë të madhe për komunikim të drejtpërdrejtë, andaj duhet jetësuar dygjuhësia dhe shumëgjuhësia.

## **Bibliografia e Pulevskit**

Në vazhdim po paraqesim bibliografinë e Pulevskit sipas radhitjes kronologjike. Duhet thënë se disa nga veprat e tij janë të njohura për opinionin, disa janë në dorëshkrim, por ka edhe të tilla që përmenden nga vetë autori, por për to nuk dihet asgjë. Ne do t'i shënojmë titujt në origjinal, e pastaj të përkthyer në gjuhën shqipe:

1. “**Речник отъ четири језика:** I. Српско-Албански. II. Арбански-Арнаутски. III. Турски. IV. Грчки. Скројена и написана отъ Ђорђа М. Пулџвски, архитекта у Галичникъ, окружје дибранско, 1872 године. I-ва часть. Београдъ. Штампарија Н. Стефановића и Дружине, 1873” (**Fjalor katërgjuhësh:** maqedonisht-shqip-turqisht-greqisht, Beograd, 1873).

2. “**Речник од три језика:** С. Македонски, Арбански и Турски. Књига II. Написао Ђорђе М. Пулевски, мијак галички. У Београд, у државној штампарији, 1875.” (**Fjalor tregjuhësh:** maqedonisht-shqip-turqisht, Beograd, 1875).

3. “Македонска песнарка I, II”; Софија, 1879 (Këngëtorja maqedonase I, II; Sofje, 1879).

4. “Славјанско-насељениски-македонска слогница речовска за исправување правословски-језическо писание. III-та книга. Написал ју Ѓ. М. Пулевски. Основана на III-то одделение училишко, а напичатена пот настолателством Г. Угринa Џиков, трг. Галички от Албанија. 1880 година в Софија. Први дел” (Gramatika e popullsisë sllave-maqedonase për shkrimin e drejtë të fjalëve. Libri III. E shkroi Gj. M. Pulevski. Hartuar për klasën III të shkollës, ndërsa botuar nën përkujdesjen e zotëri Ugrina Xhikovit, tregtar i Galiçnikut të Shqipërisë. Viti 1880 në Sofje. Pjesa e parë).

*Njohësit e jetës së këtij autori, thonë se Pulevski në dorëshkrim ka lënë këto vepra:*

5. “Славјанскомакедонска општа историја за сви полострофски народности” (Historia e përgjithshme për të gjithë popujt e Gadishullit Ballkanik),

tekst që ka mbi 1600 faqe. Dorëshkrimi ruhet në Bibliotekën Popullore “Qirili dhe Metodi” të Sofjes.

Ky autor në *Gramatikën ...* pohon se ka përgatitur edhe disa libra të tjerë, që deri më sot nuk janë zbuluar, si:

- a) “Родословница” (Fond i pasur shkronjash dhe fjalësh);
- b) “II Граматика. Речница” (Gramatika II);
- c) “Народна песнословница – Митологија” (Këngë popullore – mitologji);
- ç) “Смисленица – Лоѓика” (Logjika);
- d) “Буквар који је от четири језика: турски, словенски, латински и грчки” (Abetare në katër gjuhë: turqisht, sllavisht, latinisht, greqisht); dhe
- dh) “Обичаји и песни југословенски” (Zakone dhe këngë sllave të jugut).

## 1.2. PUNIMET E DERISOTME PËR VEPRIMTARINË E PULEVSKIT

Për jetën dhe veprimtarinë e Gjorgji Pulevskit në gjuhën maqedonase e bullgare deri më tani janë shkruar disa artikuj e monografi. Por, përgjithësisht në gjuhën shqipe për të është shkruar pak, andaj e shohim të udhës që për lexuesit e interesuar shqiptarë të shënojmë bibliografinë e punimeve më të rëndësishme kushtuar këtij leksikografi popullor:<sup>9</sup>

Në vazhdim po paraqesim bibliografinë e Pulevskit sipas radhitjes kronologjike. Duhet thënë se disa nga veprat e tij janë të njohura për opinionin, disa janë në dorëshkrim, por ka edhe të tilla që përmenden nga vetë autori, por për to nuk dihet asgjë. Ne do t'i shënojmë titujt në origjinal, e pastaj të përkthyer në shqip:

Asllan Hamiti, *Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit*, Vatra, Shkup, 2005.

Аслан Хамити, *Реципрочното влијание на македонскиот и албанскиот јазик во речниците на Пулевски: Македонскиот јазик во XIX век*, Shkup, 1995: 215-222;

Аслан Хамити, *Албанскиот јазик во речниците на Пулевски: Јазичите на почвата на Македонија*, МАНУ, Скопје, 1996: 177-185;

Asllan Hamiti, *Disa veçori fonetike dhe fonologjike të tekstit shqip të fjalorëve të Gjorgji Pulevskit: Shqyrtime albanologjike 6*, Shkup 2000: 161-176;

А. П. Стоилов: “Фолклор V в. Марица” (1878-1885): Известија на Народнија етнографски музеј в Софија, 1926 год., VI, nr. 1-4: 27-28.

Блаже Конески, *За јазикот на Пулевски – графиски, фонетски и фонолошки особености: Македонскиот од XIX век*, Култура, Скопје, 1986: 210-223;

Блаже Конески, *Белешки за Пулевски (јазично и книжевно-историски прилози): Македонскиот IX век*, Култура, Скопје, 1986: 224-230;

Блаже Конески, *Кон македонската преродба: Македонските учебници од XIX век*, Скопје, 1949: 87-97;

Блаже Конески, *Македонистот Ѓорѓи (Ѓорѓо) Пулевски: Културен живот*, Скопје, 1961, VI, бр. 2: 25-26;

Блаже Конески, *За македонскиот литературен јазик: Избрани дела во седум книги*. Култура, Скопје, 1967: 253-265;

Блаже Конески, *Граматиката на Ѓ. Пулевски: Македонски јазик IV*, Скопје, 1953, 2: 45-47.

Блаже Конески, *Ѓорѓи Пулевски: Литературен збор, XXV*, книга 2, Скопје, 1954.

Блаже Конески – Оливера Јашар - Настева, *Балкански јазични паралели во речниците на Ѓорѓи Пулевски: Прилози IX 2*, МАНУ, Скопје, 1984: 57-63.

---

<sup>9</sup> Një bibliografi të pasur të artikujve e studimeve lidhur me jetën dhe veprimtarinë e Pulevskit e hartoi dr. Tome Sazdovi (Ѓорѓи Пулевски, Избрани текстови (e redaktoi: д-р Томе Саздов), Наша книга, Shkup, 1985, f. 194-195). Pjesa më e madhe e kësaj bibliografie bartet edhe këtu, por regjistri i njësive bibliografike është pasuruar edhe me njësi të reja.

Блаже Ристовски, *Ѓорѓија М. Пулевски: Одбрани страници*, Македонска книга (përzgjedhjem redaktim, parathënie dhe shënime), Shkup, 1974;

Блаже Ристовски, *Ѓорѓија М. Пулевски и неговите книшки: “Самовила македонска” и “Македонска песнарка”*, Институт за фолклор I, Скопје, 1973;

Блаже Ристовски, *Ѓорѓија М. Пулевски како поет и фолклорист: “Македонската народна и уметничка литература”*, Шестти “Рацинови средби”, Титов Велес, 1969: 70-83;

Блаже Ристовски, *Прилог кон проучувањето на македонските научно-литературни друштва и афирмацијата на македонската национална и државна мисла: “Развиток на државноста на македонскиот народ”*, Скопје, 1966: 171-188.

Блаже Ристовски, *Појави и профили од македонската културна историја*, 2 дел, Студентски збор, Скопје, 1982;

Блаже Ристовски, *Белешки за Пулевски: Македонскиот XIX век*, Јазично и книжевно-историски прилози, Скопје, 1986: 225-230.

Д. Пановски, *Ѓорѓија М. Пулевски: Литературни портрети*, Развитие, Битола, 1975: 105-117.

Д. Лепчески, *Ѓорѓе Пулевски: Културен живот*, Скопје, 1965, година X, бр. 6: 25-27.

Г. Трајчев, *Книга за мијациите* (Историско-географски очерк), Софија, 1941: 42.

Georg Hazai, Rumeli ağızları tarihinin iki kaynağı üzerine: *Türk Dili Araştırmaları Yılığı Belleten*, 1963: 117-120 (TDK Yayınları 234).

Х. Поленаковић, *Мијачки лексикограф Ђорђе М. Пулевски*: Глас Југа, Скопје, 1941: 30-32;

Х. Поленаковић, *За граматиката на Пулевски*: Македонски јазик IV, 1953, бр. 8: 188-189.

К. Шапкарев, *Народни песни и старини*, Марица, Пловдив, 13. 04. 1982 и 16. 04. 1882.

М. Георгиевски, *Песнарките од Ѓорѓи Пулевски*, Журнал, Скопје, 10. 10.

1970.Петро Јанура, *Значајот на делото на Ѓорѓи Пулевски како претходник во културната преродба на Албанскиот народ*: Бигорски научно-културни собири, Научен собир I: 169-175.

Петро Јанура, *Кирилицата во албанската писменост*: Литературен збор, бр. 6, Скопје, 1969.

Оливера Јашар - Настева, *За речниците на Пулевски и албанската паралела во нив*: Прилози (kontributions), IX 2, МАНУ, Скопје, 1984: 43-56;

Оливера Јашар - Настева, *Искажувањата на Ѓорѓи Пулевски за јазичната ситуација во Македонија*: Јазичите на почвата на Македонија, МАНУ, Книга 3, Скопје, 1996: 33-51.

П. Драганов, *Етнографическиј очерк славјанској части Македонии. Дебријане: Арнауто-Арбанаси и Албано-Мијаци*: Известија С. Петербуршкога славјанскога благотворителнаго обителства, С. Петербург, 1888, бр. 2: 89;

- П. Драганов, *Македонско-славјанскиј сборник с приложением словарѳа*. Редактура П. Драганов, Винуск I, С. Петербург, 1894: 230-234;
- П. Драганов, *Дедо Георго Пулевски*, Дебрски глас, Софија, 6. 05. 1911: 4.
- П. Драганов, *Дедо Георго Пулевски*, Македонија – Macedonia, Софија, 17. 06. 1911: 1.
- Трајко Стаматоски, “Слогница речовска” – израз на националната свест на Пулевски: Нова Македонија, Скопје, 28. 12. 1980: 9;
- Трајко Стаматоски, *Од историјата на македонската книжевност – “Граматика” израз на националната свест на Пулевски*: Нова Македонија, Скопје, 28.12. 1980: 9;
- Trajko Stamatovski, *Gjorgji Pulevski dhe gramatika e tij*: Jehona, nr. 10, Shkup, 1987: 29-40;
- Трајко Стаматоски, *Страници од историјата на нашиот јазик, Македонистот Ѓорѓи Пулевски - автор на првата граматика на македонскиот јазик*: Нова Македонија, бр. 3432. XI (04. 12. 1955): 5;
- Трајко Стаматоски, *Кон графискиот систем на Пулевски*: Бигорски научно-културни средби, I, Науна средба, Гостивар, 21-22. 10. 1971, Скопје, 1973: 37-44;
- Трајко Стаматоски, *Ѓорѓи Пулевски и неговата “Слогница речоска*: Македонски јазик XXXI, Skorје, 1980.
- Томе Саздов, *Ѓорѓи Пулевски*: Избрани текстови, Скопје, 1985;
- Томе Sazdov, *Vepra e Gjorgji Pulevskit (1838-1895)*: Jehona, nr. 7, Shkup, 1984: 92-109.
- С. Димевски, *Ѓорѓи Пулевски*: Вечер, Скопје, 12-19. 06. 1971;
- С. Димевски, *Две писма на Ѓорѓи Пулевски до браќата Баџовиќ од 1878/79*: Разгледи, година XIV, бр. 10, 1972, Скопје: 1130-1132.
- П. Чакар, *Нови откритија по случај 75-годишнината од смртта на Ѓорѓи Пулевски. Мијачкиот ѕидар – највиден македонист учебникар*: Нова Македонија, Скопје, 25. 08. 1969 и 04. 09. 1969: 10.
- Т. Панговски, *Нов прилог кон издавањето на речниците на Ѓорѓи Пулевски во Белград*: Просветно дело, Скопје, 1965, XXI, бр. 7-8: 399-404.
- Т. Смиланиќ - Брадина, *Борђе М. Пулевски (Мијак галички)*: Јужни преглед, Скопје, 1927, I, бр. 2-3: 61-65.
- Весна Матијашевиќ, *Јазикот на текстовите на Ѓорѓи Пулевски (punim magistrature, arkivi i Fakultetit të Filologjisë “Bllazhe Koneski” në Shkup, Shkup, 1992)*.
- Viktor Fridman, *Gjorgji Pulevski, fjalorët e tij dhe Rilindjet kombëtare Shqiptare e Maqedone*: Konferenca për 100-vjetorin e Lidhjes së Prizrenit, Prishtinë, 1978.

Рјеса мѳ е мадхе е пунимеѳе тѳ дерисотме, қѳ и шѳнуам нѳ кѳтѳ библиографи, бѳјнѳ фјалѳ пѳр паралелен е гјухѳс маqedонасе, мѳ ми рѳ тѳ теми сllаве, тѳ фјалорѳе, пѳр вјershѳзат е Пулевски, пѳр Граматикѳн е тѳј, јетѳн, идетѳ револуционаре е патриотике тѳ авторит етј. Пѳр шqипен е фјалорѳе три-катѳр гјуhѳш тѳ Пулевски пак ѳштѳ шkруар, edhe pse кѳта фјалорѳ јанѳ шfлетуар nga disa гјуhѳтарѳ.



Albanologët deri më sot kanë bërë jo pak studime për gjuhën e veprave të shkruara në gjuhën shqipe. Mirëpo, është e nevojshme që ky lloj studimi filologjik të vazhdojë edhe më tej, për të ndriçuar gjithë trashëgiminë e teksteve shqip. Këto studime janë dobiprurëse dhe do të hedhnin dritë mbi shumë çështje të historisë së shqipes së shkruar dhe përgjithësisht të historisë së gjuhës, zhvillimit të dialekteve dhe të të folmeve shqipe në rrjedhë të kohës. Rezultatet e arritura do të kenë vlerë të madhe edhe për kulturën tonë kombëtare në përgjithësi. Puna e këtillë dë të jepte rezultate shumëdimensionale, kur dihet se shqipja është gjuhë që është folur shumë herët, por mjerisht vonë e dokumentuar.<sup>10</sup>

Duke e parë këtë dobi frytdhënëse nga studimi filologjik i veprës së një shkrimtari, iu kemi rrekur punës që të vëmë në pah tipatret gjuhësore të shqipes në fjalorët e Gjorgji Pulevskit. Burim të dorës së parë gjatë punës sonë hulumtuese i kemi pasur dy fjalorët: Fjalorin katërgjuhësh dhe Fjalorin trigjuhësh.

---

<sup>10</sup> Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1987, f. 8.

## 2. STRUKTURA E FJALORËVE DHE RËNDËSIA E TYRE

Siç u tha edhe më parë, Gjorgji Pulevski ka shkruar, veç tjerash, edhe dy fjalorë shumëgjuhësh:

“**Речник оть четири језика**: I. Српско-Албански. II. Арбански-Арнаутски. III. Турски. IV. Грчки. Скројена и написана оть Ђорђа М. Пулѣвски, архитекта у Галичникъ, окружје дибранско, 1872 године. I-ва часть. Београдъ. Штампарія Н. Стефановића и Дружине, 1873”. Në përkthim të fjalëpërfjalshëm në shqip do të ishte: **Fjalor katërgjuhësh**: I. serbisht-shqip. II. arbanisht-arnautisht. III. turqisht. IV. greqisht. Hartuar dhe shkruar nga Gjorgja M. Pulevski, arkitekt nga Galiçniku, qarku i Dibrës, 1872. Botimi I. Beograd, Shtypshkronja e N. Stefanoviqit dhe e Shoqërisë, 1873. Sipas shqipes së sotme ky fjalor do të emërtohej si **Fjalor katërgjuhësh**: maqedonisht-shqip-turqisht-greqisht, Beograd, 1873.

“**Речник од три језика**: С. Македонски, Арбански и Турски. Књига II. Написао Ђорђе М. Пулевски, мијак галички. У Београд, у државној штампарији, 1875.” Në përkthimin e bërë nga vetë autori në gjuhën shqipe shënon: “**Fjalor nka tre g-juha**: shkinisht-makedonise, shqip ede turqish, liberti II, ekashruu Gjorgji Pules.” Sipas shqipes standarde mund të themi se ky është **Fjalor trigjuhësh**: maqedonisht-shqip-turqisht, Beograd, 1875.

Nga titujt e veprave të Pulevskit, si edhe nga dy fjalorët e tij vërehen dy gjëra të rëndësishme. Së pari, rregullisht i shënon me shifra romake librat e vet: *Fjalori katërgjuhësh* sipas tij është *libri I*; *Fjalorin trigjuhësh* e shënon me *II*, dhe *Gramatikën* me numrin romak *III*. Me atë që për Gramatikën thotë se është pjesa e parë, paralajmëron se ka ose do të ketë edhe pjesë të tjera të saj. Dhe meqenëse, *Vjershëzat (Pesnarki)* nuk i numëron, fitohet përshtypja se ato janë jashtë serisë së paramenduar, ndoshta janë lënë për një publikim më të gjerë.

Së dyti, vërehen emërtime të larmishme për gjuhët. Kështu, për të emërtuar gjuhën shqipe përdori termet *arbanski-arnautski* në ballinën e Fjalorit katërgjuhësh, ndërsa në brendi të tij disa terme të tjera, si: *arbanski* – 66 herë, *arnautski* – 16 herë dhe vetëm 6 herë - *albanski*. Termin *arbanski* për emërtimin e shqipes e shkruan në kolonat e Fjalorit trigjuhësh, por në faksimilin e po të njëjtit fjalor shkruan *shqip*. Këto emërtesa janë të njohura në shkencën albanologjike.<sup>11</sup>

Autori, duke ditur disa gjuhë, por duke mos pasur as njohuritë elementare linguistike, emërtimin e shqipes e bëri me një larmi të madhe, sikundër bëri edhe me emërtimin e gjuhës sllave të pranishme në kolonën e parë në të dy fjalorët. Atë gjuhë sllave, tani mund të themi një maqedonishte të përzier me përplot serbizma, bullgarizma etj. e pagëzoi si *srpsko-albanski*, *s(lovensko)-makedonski*, *slavjansko-makedonski*, *slovenski*, *makedonski* etj. Kjo mund të shpjegohet me faktin se në atë kohë nga qarqet serbe, maqedonasit ende nuk njiheshin si komb e as maqedonishtja si gjuhë kombëtare.<sup>12</sup>

Sido që të jetë, për ne me rëndësi më të madhe është struktura gjuhësore e shqipes së shkruar në të dy fjalorët. Për lehtësi shënimi, në punën tonë të mëtejme

<sup>11</sup> Për këto shih në: Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1976, f. 85-88; Rexhep Ismajli, *Emri i shqiptarëve*, në *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë, 1987, f. 96-104 etj.

<sup>12</sup> Shih: Блаже Конески, *Бележуки за Пулевски*, Македонскиот XIX век, Јазично и книжевно-историски прилози, Shkup, 1986, f. 225-230.

*Fjalorin katërgjuhësh* do ta shënojmë me numrin romak I, ndërsa *Fjalorin trigjuhësh* me numrin II.

Fjalorët në shqyrtim dallohen mjaft njëri nga tjetri si në strukturë, ashtu edhe në metodën e mbarështrimit, në grafi etj. *Fjalorin katërgjuhësh* mund ta quajmë në një mënyrë si fjalor të mirëfilltë. Në kolonën e parë janë shënuar fjalët në maqedonisht (përkatësisht në sllavisht) e pastaj në kolonat gjegjëse për gjuhët e tjera është dhënë fjala e përkthyer. Këtu nuk kemi fare të dhëna për përkatësinë gramatikore të fjalës, as për shumkuptimësinë e fjalëve, figurshmërinë e tyre, fushat e përdorimit etj., por janë dhënë vetëm fjalët, pa shënuar asgjë pas tyre, si p.sh.:

<i>maqedonisht</i>	<i>shqip</i>
место	вени (veni)
нос	унда (unda)
ГОСПОДИН	зотнии (zotnii)
глава	Кока, креа, каптина (koka, krea, kaptina)

Siç po shihet nga shembulli i fundit, në disa raste janë dhënë disa sinonime fjalësh, që pasurojnë fondin e fjalorit. Ndonjëherë e njëjta fjalë është paraqitur disa herë në forma gramatikore të ndryshme: në trajtë të pashquar e në të shquarën, në njëjës e në shumës etj., si p.sh.: *ni vii, vijat* I 18; *sumbull, sumbullat* I 30; *shapoll, shapolla* (shapullë, shuplakë) I 23 etj.

**Fjalori katërgjuhësh** ka afërsisht 2.560 fjalë e shprehje shqipe, por duke marrë parasysh se ka raste kur një fjalë e vetme na paraqitet me forma të ndryshme, ky fond fjalësh është më i vogël. Ky fjalor ka 98 faqe të formatit 14 x 17 cm. Fjalori është i ndarë në 74 qerdhe fjalësh, me sfera leksikore të ndryshme. Kështu, bie fjala, aty ka leksema “për perëndinë dhe mirësinë e tij” nga faqja 12 deri në faqen 14. Pastaj kapituj me fjalë nga sfera e gjithësisë, emërtime gjeografike, gurë e metale; emërtime të kohës dhe të ditëve; numrat themelorë; shprehje dhe emra gjërash të veshmbathjes; terme nga sfera e orendive shtëpiake dhe e enëve; fjalë nga sfera e blegtorisë, emra drurësh, tituj e profesione njerëzish, emërtime veglash e sendesh, emërtime njerëzish për nga moshja e pamja e jashtme (ngjyra e lëkurës); shprehje përsëritëse, fjalë pa ndonjë lidhje me botën materiale etj.

Në fund të librit janë dhënë përmirësimet e gabimeve teknike e në tri faqet e fundit janë shënuar emrat e parapaguesve të fjalorit me të dhënat për profesionin, adresën si dhe numrin e ekzemplarëve të paguar, përkatësisht emrat e njerëzve që e financuan botimin e librit.

**Fjalori trigjuhësh** dallohet shumë nga Fjalori katërgjuhësh, sidomos për nga forma. Fjalori trigjuhësh nuk është fjalor klasik ose fjalor fjalësh, por i tipit pyetje – përgjigje, që mund të quhet fjalor bisedimor. Në të kemi paralele trigjuhësore me fjali e periudha të tëra, pra me tekst të kontinuar. Ky libër i përgjigjet një enciklopedie të kohës me njohuri të llojllojshme nga religjioni, filozofia e jetës, historia, gjeografia etj. Sipas Bllazhe Koneskit, Pulevski në 91 faqet e para të *Fjalorit trigjuhësh* e ka shfrytëzuar në tërësi (me ndonjë ndryshim të vogël e përshtatje) tekstin e Kuzman Shapkarevit (1834-1909) “*Mësimet fillestare për fëmijët e vegjël*”, botuar në Stamboll në vitin 1868.<sup>13</sup>

<sup>13</sup> Блаже Конески, *Кон македонската преродба*, Македонските учебници од XIX век, Институт за национална историја, Shkup, 1959, f. 90.

Model për përpilim të tillë të fjalorit, autori ka mundur të gjejë edhe në bisedat dhe dialogjet e banorëve të kësaj ane, si dhe te banorët e vendeve të tjera. Për këtë është e njohur sidomos oda shqiptare e quajtur edhe si “fakultet i popullit”, sidomos atëherë kur përvoja njerëzore, dija, trashëgimia mendore e kulturore bartej vetëm nëpërmjet traditës gojore.

Krahas burimit të zbuluar për 90 faqet e para të Fjalorit trigjuhësh, është konstatuar se Pulevski ka shfrytëzuar edhe modele të tjera. Kështu, prej faqes 93 deri në faqen 128 hetohet se Pulevski ka shfrytëzuar ndonjë shkrim serb, që vërehet sidomos në modelet gjuhësore. Nga faqja 127-157 gjendet një regjistër fjalësh sipas alfabetit, të hartuar nga autori.

*Fjalori tregjuhësh* (Fjalor nka tre g-juha) është i formatit 14 x 20 cm me gjithsej 162 faqe tekst të shkruar me pyetje-përgjigje në tri kolona: sllavisht (maqedonisht), shqip dhe turqisht, me fjali e periudha të tëra. Kjo mënyrë e hartimit të fjalorit mundëson të bëhet vështrim mbi strukturën gjuhësore të këtij fjalori. Nga ky pastaj mund të bëhen përgjithësime për tërë gjuhën shqipe të regjistruar nga Pulevski, anipse Fjalori katërgjuhësh nuk është i këtij tipi.

Fjalori në fjalë fillon me një bisedë (maq. - razgovor, shqip - kuvend dhe turq. - muhabet) dhe mandej vazhdon me pyetje (maq. pitanje, shq. pjutmea e turq. suval) dhe përgjigje (maq. odgovor, shq. u prxheq e turq. xhuvab).

Në të dy fjalorthët shumëgjuhësh, kolona e maqedonishtes së përzier me gjuhë të tjera sllave është bazë, e cila është përkthyer në dy-tri gjuhët e tjera. Mirëpo, në Fjalorthin tregjuhësh autori herë-herë i është shmangur paraleles maqedonase, duke u përpjekur ta ruajë origjinalitetin e çështjeve që shtjellon, varësisht nga gjuha në të cilën shkruan. Kështu, bie fjala, në f. 49 kur bën fjalë për popujt dhe atdheun e tyre, në shtyllën e maqedonishtes thotë se: maqedonasit janë popull dhe se atdheu i tyre quhet Maqedoni, ndërkaq në paralelen e përkthyer në shqipen shkruan se tash jo maqedonasit, por shqiptarët janë popull që jetojnë edhe në Maqedoni: maqedonisht: “*Taka i makedoncive se narod i mestovo njihovno je Makedonija*. Shqip: *Ashtu ede shkipitarat jan njeraz ede vendin etijse po thijn Makedonija, cili po roin aqe.*”

Nga faqja 41-48 të Fjalorit II ku trajtohen çështje për ardhjen e sllavëve në Gadishullin Ballkanik, ndarjen e tyre në popuj, vendosjen e tyre, degëzimin dialektor të maqedonishtes etj. teksti është shkruar vetëm në maqedonisht, pa u përkthyer fare as në shqip e as në turqisht. Gjykojmë se kjo pjesë nuk është përkthyer sepse autorit i është dukur se kjo tematikë është e parëndësishme për shqiptarët dhe turqit.

Për nga metodologjia e hartimit, dallohet edhe pjesa e fundit e Fjalorit II ku nga faqja 113 deri në faqen 118 është dhënë pasqyra e alfabetit të përdorur në këtë fjalës, bashkë me disa përshkrime nyjëtimore të tingujve themelorë të paraqitur me shkronjat e alfabetit të tij. Artikulimi i tingujve është dhënë në mënyrë popullore e laike. Prej faqes 121 deri në faqen 128 përsëri kthehet në pyetje e përgjigje e më pas në 30 faqet pasuese jepet një fjalorth në afro 30 faqe (f. 128-157) me fjalë të radhitura sipas alfabetit cirilik të modifikuar, ku kemi edhe një përpjekje për paraqitje gramatikore të fjalëve, me ndarje dhe shënim të formave të mundshme të tyre.

Në pesë faqet e fundit të Fjalorit II (163-167) janë shkruar emrat e parapaguesve, profesioni i tyre, adresa e numri i kopjeve të porositura dhe përmbajtja. Sipas kësaj liste të gjatë, mund të shihet se interesimi i njerëzve për këtë Fjalorth qe i madh. Pason një përshëndetje mirënjohëse kushtuar parapaguesve dhe njëherit autori bën thirrje për t’u parapaguar (ose për ta financuar) e ndihmuar materialisht botimin e një abetareje në katër gjuhë: turqisht, sllavisht, latinisht dhe greqisht. Ndërkaq, këngë

dhe zakone të kombeve e kombësive të sllavëve të jugut, Pulevski sipas kësaj që ka shënuar, e pati planifikuar t'i publikojë për një rreth më të gjerë lexuesish.

Edhe ky Fjalor, i ashtuquajtur i dytë, është ndarë në tema të ndryshme me sfera të veçanta leksikore. P.sh. ka një hyrje, pastaj shkruhet për vetitë psiko-fizike të njeriut, për bimët e kafshët, për xehet dhe lëgurat, për kontinentet e botës, yjet, për fenomenet natyrore, për banorët e Mjakut etj.

Të dy fjalorët e Pulevskit, vështruar në retrospektivën kohore, patën rëndësi relativisht të madhe, ashtu si edhe çdo fjalor tjetër shumëgjuhësh. Këtë konstatim mund ta mbështesim me disa fakte:

- Fjalorët (veçmas Fjalori tregjuhësh) paraqesin një enciklopedi të vogël popullore të kohës.

- Fjalorët patën karakter praktik, d.m.th. se u hartuan për nevojat praktike të popullatës së Ballkanit, por edhe më gjerë; për të nxënë disa gjuhë ballkanike (maqedonishten, shqipen, greqishten e turqishten), për komunikim të ndërsjellë, njohjen reciproke të gjuhëve dhe kulturave, por edhe për afrimin e tyre. Komunikimi i njerëzve që flasin gjuhë të ndryshme është më se i nevojshëm. Të përkujtojmë me këtë rast konstatimin e njohur të gjuhëtarëve se njohja e disa gjuhëve ka pasoja pozitive edhe në intelegjencë. Përvoja në dy e më tepër sisteme gjuhësore ndikon që personi i tillë të ketë fleksibilitet më të madh mendor, superioritet në përpilimin e ideve si dhe shumë më tepër zgjedhje të aftësive mendore nga njeriu që di vetëm një gjuhë. Njeriu që zotëron disa gjuhë e vështron botën në disa aspekte të ndryshme. E në fund, mesi me dy e më tepër gjuhë e kultura mundëson që njohësi i këtyre gjuhëve të fitojë përvojë më të pasur e më të llojllojshme. Prandaj, bashkëjetesa, kontaktet e përditshme të popullatës në anët e Maqedonisë Perëndimore ndërmjet folësve të disa gjuhëve ka krijuar domosdonë e hartimit të fjalorëve shumëgjuhësh.

- Nga fjalorët del konstatimi se gjuhët duhet të jenë të barabarta, d.m.th. duhet zbatuar dygjuhësia e shumëgjuhësia e jo diglosia, qëndrim ky më i drejti për mjediset shumëgjuhësore. Nuk është e rastit zgjedhja e gjuhëve: maqedonisht, shqip, turqisht e greqisht. Të rikujtojmë se në atë kohë greqishtja ka qenë gjuhë e arsimit, e kulturës etj., turqishtja – gjuhë e administratës shtetërore; ndërsa shqipja e maqedonishtja gjuhë amtare e popullsisë së Maqedonisë si dhe gjuhë e komunikimit të përditshëm në kushtet e bashkëjetesës së shqiptarëve dhe maqedonasve.

- Fjalorët janë edhe një dëshmi se shqipja u shkrua, përveç me alfabetin latin, arabo-turk, grek edhe me alfabetin cirilik. Siç dihet, shkrimi i shqipes me alfabet cirilik ka një traditë të shkurtër. Kështu, si i pari dokument me alfabet cirilik merret mbishkrimi tregjuhësh që gjendet mbi derën e manastirit të Shën Vlladimirit të Elbasanit, ndërtuar nga princi shqiptar Karl Topia më 1381. Sprovimet e para për të shkruar shqipen me alfabet cirilik i bënë Papa Totasi ose Anonimi i Elbasanit, beratasi Kostë Berati, Teodor Haxhi Filipi etj.<sup>14</sup>

Shqipen me alfabet cirilik e shkruan edhe Gjorgje Pulevski, Kuzman Shapkarevi etj. Vlen të përmendet se Fjalorët e Pulevskit nuk janë të parët ku në fjalorët shumëgjuhësorë gjuhësh ballkanike hartuar nga joshqiptarët në shekullin XIX merr pjesë edhe shqipja. Shqipen e ndeshim edhe në një fjalor Katërgjuhësh: greqisht-arumanisht-shqip dhe maqedonisht nga voskopojari Pop Danailli, botuar në Veneci më 1794, botimi I dhe më 1802 botimi II.

- Fjalorët kanë rëndësi leksikografike, meqë përbëjnë një nga hallkat në vargoin e leksikografisë shqiptare.

---

<sup>14</sup> Dr. Petro Janura, *Nga historia e alfabetit të gjuhës shqipe*, Shkup, 1969, f. 43-56.

- Edhe pse në Fjalorë nuk është pasqyruar me besnikëri shqipja e kohës, d.m.th. format e fjalëve e të fjalive duhet marrë me rezervë, megjithkëtë mund të thuhet se të njëjtit kanë rëndësi gjuhësore, sepse këtu e gjejmë një variant të shkruar të shqipes së shekullit XIX. Aty na paraqiten disa forma të vjetra të shqipes, ka tipare të të folmes së qarkut të Dibrës, tipare gjuhësore të të folmeve të tjera gege, një numër të vogël veçorish gjuhësore të të folmeve toske, por edhe kalke, forma e fjalëkrijime të paqëlluara etj. Megjithë mangësitë që ka, shqipja e Pulevskit siguron një material të shkruar për të vëzhguar gjuhën dhe stilin e tij, për të parë zhvillimin historik të të folmes së Dibrës, e bashkë me shkrimet e tjera të kohës, për të pasqyruar rrjedhën kohore të grupit të të folmeve të gegërishtes qendrore e më gjerë. Meqë është fiksuar një shqipe e shekullit XIX, Fjalorët mund të plotësojnë një pjesë të mozaikut për ecurinë kohore të dialekteve dhe të të folmeve shqipe, historinë e shqipes së shkruar e të historisë së gjuhës në përgjithësi.

Këta Fjalorë, gjithashtu na sigurojnë një material të vlefshëm (por jo autentik) për të parë ndikimet ndër-gjuhësore në shekullin XIX ndërmjet disa gjuhëve ballkanike.

- Dy fjalorët kanë edhe njëfarë vlere historike për shkencën albanologjike, veçmas për gjuhët dhe kulturat ballkanike në përgjithësi.

Materiali i dy Fjalorëve është shfrytëzuar në punimin e Aleksandër Beliqit “Dialekti i Galiçnikut”, Beograd, 1935, por ai mund të shfrytëzohet si burim edhe për shumë çështje të tjera gjuhësore, kulturore e historike.

### 3. TIPARET GRAFIKE

Gjatë analizës gjuhësore të shqipes së Fjalorëve të Pulevskit kemi hasur në disa vështirësi, ashtu siç ka vështirësi çdo studiues i teksteve të shkruara. Probleme na kanë dalur së pari sepse kemi pasur para vetes një tekst të shkruar e jo një ligjërim tingullor të njerëzve. Në vend të tingujve këtu kemi shkronja, e siç dihet, shkronjat në mënyrë të zbehtë e ndonjëherë të deformuar paraqesin fonemat. Pra, nuk ka asnjë sistem grafik aq të përsosur, i cili do të mund t'i regjistronte në mënyrë besnike të gjitha nuancat tingullore që i merr fonema në pozicione të ndryshme fonetike e kombinatorë në procesin e ligjërimin.

Vështirësia është edhe më e madhe kur kihet parasysh se Fjalorët shumëgjuhësh të Pulevskit nuk janë shkruar me alfabetin latin të modifikuar për transkriptimin e shqipes. Autori ka përdorur ato grafema të sllavishtes të cilat ka pandehur se më së miri e pasqyrojnë vlerën e fonemave të shqipes. Por, megjithatë, gjuhët e ndryshme kanë edhe tinguj themelorë të ndryshëm, disa nga ta për nga shqiptimi mund të jenë të ngjashëm ose të përafërt, por asnjëherë të njëjtë. Të përkujtojmë, veç kësaj, se dallime akustike të tingujve ka edhe ndërmjet pjesëtarëve të një gjuhe, të një dialekti, nëndialekti, grupi të të folmes, të folmes, por dallime fonike hasen edhe ndërmjet individëve të një të folmeje. Kështu, pra edhe e folmja e qarkut të Dibrës, që përbën bazën dialektore të shqipes së fjalorëve në spikamë, nuk është gjithkund e njëjtë. Zaten, përveç kësaj baze gjuhësore, gjuha e Fjalorëve ka plot veçori gjuhësore edhe të të folmeve të tjera të gegërishtes si dhe tipare të toskërishtes.

Me një fjalë, shqipja e fjalorëve të Pulevskit është një “amalgamë gjuhësore artificiale”: një gjuhë popullore joautentike, një stil që dëshmon nivelin e ulët të njohjes së natyrës së shqipes, me përzierje të shqipes territoriale, me shumë ndikime të huaja joreale, pa ndarje morfologjike në shkrimin e fjalëve, përplot me kalke e krijime artificiale të autorit etj.

Duke pasur para vetes një përfaqësim të tillë të dobët të shqipes së një autodidakti, me grafi jokonsekuente e pa kritere të caktuara gjuhësore, kuptohet se e kishim mjaft të vështirë të gjejmë rregulla të përgjithshme për tërë sistemin gjuhësor të shqipes së fjalorëve. Megjithatë, jemi përpjekur të nxjerrim dhe t'i njoftojmë të interesuarit shqiptarë me tiparet kryesore të variantit shqip të të dy Fjalorëve.

Alfabeti që e përdori Pulevski qe fonematik, i plotësuar me alfabetin rrokjesor. Përgjithësisht, mund të thuhet se fjalët i shkroi sipas parimit fonetik, sipas të cilit fjalët shkruhet ashtu siç shqiptohen dhe lexohen ashtu siç shkruhen. Në shkrim, siç dihet, fonemën e përfaqëson grafema, andaj në këtë vëzhgim gjuhësor do të flitet për grafinë e Pulevskit. Përgjithësisht, me një shkronjë Pulevski ka shkruar një fonemë, ka edhe dyshkronjësha si dhe ndonjëherë me një shkronjë ka paraqitur një rrokje (sipas traditës shkrimore të rusishtes e bullgarishtes). Meqë gjatë përfaqësimit grafik të disa fonemave hetohet mospërputhje ndërmjet grafemës e fonemës, do të bëhet fjalë edhe për këtë mospërputhje.

Sistemi grafik i teksteve të Pulevskit, si edhe gjuha e tij, nuk është e njëjtë, por dallohet nga teksti në tekst. Grafia e dy Fjalorëve të botuar në Beograd dallon nga grafia e teksteve të tjera të botuara në Sofje. Edhe dy fjalorët e Pulevskit botuar në Beograd në dallim kohor vetëm për dy vjet (Fjalori I më 1873, ndërsa Fjalori II më 1875) dallohen mjaft edhe në grafi. Fjalori katërgjuhësh është shtypur me alfabetin

cirilik tradicional (me shkronja serbe-ruse-sllave), ndërsa në Fjalorin tregjuhësh është përdorur alfabeti cirilik i reformuar i Vuk Karaxhiqit.<sup>15</sup>

Për sistemin grafik të Pulevskit kanë bërë fjalë disa gjuhëtarë maqedonas, ndër ta Trajko Stamatovski, Bllazhe Koneski, Blazhe Ristovski, Tome Sazdov etj.<sup>16</sup> Për shkrimin e të gjitha paraleleve gjuhësore të fjalorëve, d.m.th. në maqedonisht, shqip, greqisht e turqisht është përdorur i njëjti alfabet. Në këtë punim do të përiqemi të japim inventarin e grafisë dhe të shpjegojmë me çfarë vlere është përdorur ky sistem grafik për të shënuar fonemat e idiolektit shqip të Pulevskit.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë për grafinë e Pulevskit, më poshtë po shënojmë dy alfabetet, të fjalorit I dhe të Fjalorit II:

Alfabeti i Fjalorit katërgjuhësh:

Alfabet fonetik							
А а	Б б	Ц ц	Ч ч	Д д	Е е	Ь (ъ)	Ф ф
Г г	Ђ ђ	Х х	И и	Ј ј	К к	Л л	Лл л
М м	Н н	О о	П п	Ћ ћ	Р р	С с	Ш ш
Т т	Ѡ ѡ	У у	В в	Ѣ ѣ	З з	Ж ж	
Alfabet rrokjesor							
Ѣ	Я я	Ю ю	Ы ы				

Alfabeti i Fjalorit tregjuhësh:

Alfabet fonetik							
А а	Б б	Ц ц	Ч ч	Д д	Е е	-	Ф ф
Г г	Ђ ђ	Х х	И и	Ј ј	К к	Љ љ	Л л
М м	Н н	О о	П п	Ћ ћ	Р р	С с	Ш ш
Т т	Ѡ ѡ	У у	В в	Ѣ ѣ	З з	Ж ж	
Alfabet rrokjesor							
Је је	Ја ја	Ју ју	Ји ји				

Nga këto dy tabela të alfabeve, mund të shihet se pjesa më e madhe e shkronjave është e njëjtë në të dy Fjalorët. Numri i shkronjave në paralelen shqipe në të dy Fjalorët është i njëjtë – 35 shkronja, me dallim që në Fjalorin I përdor edhe një shkronjë më tepër, siç e quajnë në gjuhët sllave “erin e madh” <ъ>, por pa ndonjë vlerë fonematike.<sup>17</sup>

Në Fjalorin tregjuhësh ai i mënjanoi disa shkronja të vjetra të përdorura në Fjalorin katërgjuhësh, por e mbajti mend vendin e vlerën e tyre shenjuese. Kështu, fonografet e para i zëvendësoi me të dytat, si <Ѣ> = /je/ ose /e/, <Ы> = /ji/ ose /i/ <я> = ja, <ю> = /ju/ etj. Shkronjat <ћ> = /q/, <ђ> = /gj/ dhe shkronjën greke <Ѡ> = /th/ i

<sup>15</sup> Блаже Конески, *Македонскиот XIX век*, Јазични и книжевно-историски прилози, Shkup, 1986, f. 219.

<sup>16</sup> Shih: Б. Конески, *рнит и саро ситвар*, f. 211; Т. Стаматоски, *Кон графискиот систем на Пулевски*, Бигорски научно-културни средби, I Научен собир, Gostivar, 1971, f. 37-44; Б. Конески, *За јазикот на Пулевски* (графиски, фонетски и фонолошки особености), Македонскиот XIX век, Shkup, 1986, f. 210-223; А. Hamiti, *Албанскиот јазик во речниците на Пулевски*, Јазичите на почвата на Македонија, AShAM, Shkup, 1996, f. 177-185;

<sup>17</sup> Në faqen 111 për sasinë e shkronjave, Pulevski thotë: “Slavjanise kishten 44, po veç me 35 shtil ma pastr u shkrunte”.



përdori në të dy Fjalorët. Këtë të fundit kuptohet se e përdori për paralelen në gjuhën shqipe dhe greke, ndërkaq në maqedonishten nuk e shënon, ngase maqedonishtja nuk e ka këtë fonemë; me përjashtim të emrit të Metodit që e shkruan si Μεθοδιје (Methodije) II 42.

Në Fjalorin I nuk pamë grafemë për ta shënuar fonemën /nj/. Mirëpo, këtë e shkruan me kombinimin e shkronjës <н> (n) dhe <ы> (ji): *нызетепес дремъ* (njizetepes drem) I 97; *ныокъ* (nji ok), *ны окасъ* (nji okas) I 97, *ны* (nji) I 34 etj. ose me kombinimin <н> + <я>, si p.sh. *ня* (nja) I 27, 28; *няни* (njani) I 53; ndërkaq për rrokjen /je/ shkroi <ѣ>: *нѣрии* (njerii) I 97, *бѣваръ* (bjevar, blerës) I 88, *темѣръ* (tëmjer) I 74 etj.

Dallimi në grafi ndërmjet dy Fjalorëve shihet edhe se në Fjalorin I /л/-në shqipe e shënon me fonografin <л>, ndërsa /ll/-në me <лл>, me siguri nën ndikimin e shkronjës <ll> të shqipes. Në Fjalorin II /л/ = <лъ> e /ll/ = <лл>.

E folmja maqedonase e Galiçnikut, në inventarin e saj nuk e ka fonemën /x/, andaj Pulevski nuk ka shkronjë për ta shënuar këtë fonemë, por këtë e zëvendëson me ndonjë tingull tjetër.<sup>18</sup>

Në Fjalorin e Parë i gjejmë mjaft dendur dy shkronja të sllavishtes së vjetër (tani të bullgarishtes e rusishtes) të quajtura eri i madh <ъ> dhe eri i vogël <ь>. Këto dy grafema shpeshherë kanë vlerë tingullore e në disa raste shërbejnë për t'i mbyllur fjalët që mbarojnë me bashkëtingëllore. Eri i madh sipas etimologjisë është gjysmëzanore, mirëpo në shqipen e Fjalorëve të Pulevskit, kjo shkronjë më së shpeshti i mbyll fjalët që mbarojnë me bashkëtingëllore, sipas modelit të sllavishtes. P.sh. *чиласъ* (çillas) I 11, *чилатъ* (çillat) I 11, *пунатъ* (punat) I 11, *зотъ* (zot) I 11, *малъ* (mal) I 16, *ливадъ* (livadh) I 16, *уратъ* (urat) I 18, *гуръ* (gur) I 19 etj.

Në gjuhët sllave para erit të madh (<ъ>) është ruajtur shqiptimi më i butë (më i prapmë) i bashkëtingëllores që gjendet para saj, e më vonë në maqedonishten dhe bullgarishten eri i madh ka kaluar në /e/. Se vërtet shkronja <ъ> te shkrimet e Pulevskit përdoret për të mbyllur fjalët që mbarojnë me bashkëtingëllore, dëshmojnë mjaft qartë edhe po të njëjtat fjalë duke marrë trajta të ndryshme gramatikore, si p.sh.: *гуръ* – *гури* (gur-guri) I 19, *вени мадемитъ* – *мадеми екуритъ* (veni mademit – mademi ekurit), *балли* - *баллъ* (balli – ball) I 21, *барку* - *баркъ* (barku – bark) I 22, *шаполлъ* – *шаполла* (shapoll – shapolla) I 23, *нызетъ* - *нызете ня* (njizet – njzete nja) I 26, *тредиетъ* – *тредиете ня* (tredhiet – tredhiete nja) I 27, *нандадијетъ* – *нандадијете ня* (nandadhijet – nandadhijete nja) I 28 etj.

Duke pasur parasysh se foljen *jam* në vetën e tretë në Fjalorin e dytë Pulevski e shkruan *аште* (ashtë), atëherë mund të supozohet se këtë formë e ka përdorur edhe në Fjalorin e parë. Nga kjo mund të përfundojmë se erin e madh <ъ> e ka përdorur në disa raste për të shënuar /ë/-në e shqipes, si *схеллатъ ѡштъ* (e khellat është, “e kthjellët” është). Në faqen 65 të Fjalorit katërgjuhësh kemi lexuar *турпъ аштъ* edhe *мабаре ѡштъ* (turp është, mabare "mbarre" është). Shembujt si këta na japin të drejtë të gjykojmë se përveç mbylljes së leksemave që mbarojnë me bashkëtingëllore, shkronja <ъ> ka raste edhe kur shënon /ë/-në e shqipes në pozitë fundore të patheksuar, por rrallëherë edhe në pozitë nistore (ѡштъ).

Në përdorimin e gjysmëzanosës, përkatësisht erit të vëgël <ь>, çështja na del më e njësuar. Në gjuhën maqedonase, Pulevski këtë shkronjë e ka përdorur për shënimin e shqiptimit më të butë të bashkëtingëllores /n/ dhe për formimin e shkronjës për të

<sup>18</sup> Блаже Конески, *Македонскиот XIX век*, Јазични и книжевно-историски прилози, Shkup, 1986, f. 219.

regjistruar bashkëtingëlloren /nj/.<sup>19</sup> Në shqipen e Pulevskit kjo shkronjë është përdorur për ta shënuar zanoren /ë/. Krahaso shembujt: кѣмбѣ, кѣмбатѣ (këmb, këmbat) I 22, дѣмбѣ, дѣмби, дѣмбатѣ (dhëmb, dhëmbi, dhëmbat) I 22, нѣнѣскетулла (nënësketull) I 21, катѣрдијетѣ (katërdhijet) I 27, песѣдијетѣ (pesëdhijetë) I 27, кѣсула (kësula) I 29, нѣн кок (nën kok) I 32, пѣрфундѣ (përfund) I 38 etj.

/Ë/-në shqipe Pulevski në Fjalorin II nuk e shënon me erin e vogël <ь>, por me një vizë të shkurtër <->, e njohur si vizë lidhëse: м-шилур (mëshilur) II 99, вог-ль (vogël) II 104 etj. Edhe në fjalët пас ц-л, пас ц-ла, пас цилат (pas cëll, pas cëlla, pas cillat) II 149 viza ka shënuar zanoren /ë/, meqë përemrat pyetës *cili, cila, cilët* në të folmen e Kërçovës dalin në formën *cëlli, cëlla, cëllët*.<sup>20</sup>

Disa grafema në Fjalorin e dytë të Pulevskit janë regjistruar me një lloj kryqëzimi a simbioze ndërmjet shënimit të tyre të vjetër (në Fjalorin I) dhe shënimit të ri, si <њ>: бошњјакисѣ (boshnjakise) II 40, њјани (njjani) II 24, њја (njja) II 68, њјевин (njjevin “njefin, njehin, numërojnë”) II 24, њјофим (njjofim, “njohim”) II 10; <љ>: њољј (gjolj, gjol “liqen”) II 19, циљј (cilj, “cili”) II 21, љјдме (ljđme, “lindme, lindur”) II 13, уљјиндим (uljindim “lindim”) II 14 etj.

Pulevski nuk ka përdorur shkronja të veçanta për ndërdhëmboren e zëshme të shqipes /dh/ e as për shumëdrdhësen tingëlluese /rr/, meqë gjuhët sllave nuk i kanë këto fonema, rrjedhimisht asnjë nga alfabetet e gjuhëve sllave nuk kanë as shkronja për to. Ndërdhëmboren e shurdhët /th/ Pulevski e shënoi me shkronjën greke <θ>. Nga kjo që u tha deri më tani mund të pandehim se edhe Fjalori tregjuhësh që shkruar me alfabet cirilik tradicional, por më vonë me ndonjë sugjerim para botimit, u bë një transliterim i vogël.

Teksti i fjalorëve në shqip mund të vlerësohet i një niveli shumë më të ulët shkrimor sesa shkrimet e tjera shqipe të kohës. Pulevski që autodidakt dhe si duket nuk e ka njohur traditën e shkrimit të shqipes. Përgjithësisht, mund të thuhet se teksti i tij i takon stilit popullor, që përshkohet nga rregullat e fonetikës sintaksore, pa ndarje morfologjike të fjalëve, derisa mund të lexohet edhe një fjali e tërë e shkruar si një fjalë e vetme: *potabojshindet* I 75; *kushkoni, kurdoshkojsh* I 78, *bjerinishkëm* I 76, *aikurëqeshen* I 61, *mosufrik, eboplak* I 80, *ekabarove* II 8, *poçillojm* II 75, *mosufrik* I 80, *eboplak* I 71 etj.

Gabime të shumta hetohen si në kufijtë e ndarjes së fjalëve, ashtu edhe në shenjat e pikësimit. Shkrimi i fjalëve veçmas, bashkë ose me vizë në mes të Pulevski kanë një ndryshim të madh nga mënyra e sotme e shkrimit. Kështu, p.sh. një fjalë të vetme që shkruhet bashkë, Pulevski e shkruan ndaras në dy apo tri pjesë; ose dy e më tepër fjalë (që sot shkruhen ndaras) ai i shkruan si një fjalë të vetme të pandarë. Thënë troç, më shumë gjejmë fjalë të shkruara gabimisht, sesa fjalë të shkruara sipas ndarjes së rregullt të tyre. Le t’i regjistrojmë disa shembuj të tillë të transliteruar me alfabetin e sotëm të shqipes:

“*Tretisë ubojet xhoja çі porujn tufa dhen dhi kalë shum edhe lopa* II 55; ... *that sira, apo kuashtë, uhoq, plot, ashtë, menji* II 18; *mepemna* II 21; *gjith çvar* II 9; *melikura* II 35; *pougjeg* II 31; *ma shum, tadijm, nkaduhet, ekam, çepreajo* II 3; *let lishoe* II 8; *matemadh* II 11; *pouxhindet* II 11; *mefjali* II 16; *dot uthojet* II 160; *zotishindosh* I 76, *zotishindosh* I 76, *nëqofëshindosh* I 75, *mëngjesimir* I 75, *ipamartoum* I 70, *venekuror* I 64, *damimadh* I 82, *besaturçisht* I 78, *ipapasun* I 69” etj.

<sup>19</sup> Shih: Б. Конески, *vepra e cituar*, f. 219.

<sup>20</sup> Lulzim Aliu, *Gjuha në disa këngë të moçme kërçovare* (punim magjistrature në dorëshkrim), Shkup, 2005.

Siç shihet nga shembujt e dhënë “kjo nuk është një ortografi fonetike moderne, me ndarje morfologjike të fjalëve, por është një ortografi popullore e fonetikës sintaktike.”<sup>21</sup> Autori laik, ashtu siç e ka ndier me veshë, ashtu e ka shënuar.

Dihet se çdo fjalë, kur shqiptohet e veçuar nga të tjerat, ka theksin e vet. Mirëpo, kur ato bashkohen në fjali, disa e humbasin theksin, përkatësisht bëhen të patheksuara. Përgjithësisht, fjalët emërtuese a quajtëse e ruajnë theksin, ndërsa fjalët shërbyese bëhen të patheksuara. Si fjalë të patheksuara në fjali paraqiten zakonisht fjalët shërbyese (parafjalët, lidhëzat, pjesëzat, foljet ndihmëse, nyjat, trajtat e shkurtra të përemrave vetorë etj.), por edhe disa fjalë emërtuese, zakonisht njërrrokëshe. Këto fjalë klitike (pa theks) bashkohen në shqiptim me fjalët emërtuese që kanë theks (me fjalët akcentogjene), formojnë me to një grup që shqiptohet me një theks të vetëm, d.m.th. formojnë një njësi theksore ose, siç thuhet ndryshe, formojnë një fjalë fonetike.<sup>22</sup>

Vlen të përmendet edhe ajo se të vetmet shenja të pikësimit të përdorura në glosarët për të cilët po bëjmë fjalë janë presja, pika dhe kllapat. Por, edhe këto tri shenja pikësimi, Pulevski nuk i përdor me vend. Bie fjala, për t’i ndarë pjesët homogjene të fjalisë, autori nuk përdor presje: “*A po të zhallurat jan njerji dele kali lopa edhe qeter shum*” II 24. Nga ana tjetër, ka raste kur pothuajse pas çdo fjale është vënë presje, si: “*Cila, msume, zan diktojet nja, bas nja, pre, xhithë, trej, mpretënija, vrtetunis*” II 25 me kuptimin “Cila dije tregon shtruar për tri mbretëritë e së vërtetës?”; ose një shembull tjetër për përdorimin e pavend e të tepruar të presjes: “*Kallaji, ashtë, bardhë, edhe mademi, but, cili, po xhindet, prziun, me troll ...*” II 25 etj.

Për t’u njohur më hollësisht me sistemin grafik të shqipes së shkruar në dy fjalorët shumëgjuhësh të Pulevskit, në vazhdim do t’i paraqesim të gjitha grafemat veç e veç dhe do të përcaktojmë çfarë fonemash shënojnë ato. Nuk i kemi trajtuar si shkronja të posaçme dyzimin e grafemave të njëjta, të cilat janë përdorur për të paraqitur një zanore të theksuar dhe të gjatë. Do të shihet se autori ka përdorur edhe dyshkronjësia për ta shënuar një fonemë të vetme. Nganjëherë na shfaqen edhe mospërputhje ndërmjet grafemës dhe fonemës, për të cilat do të bëjmë fjalë gjatë shqyrtimit të fonografeve. Në shqipen e Fjalorëve shpeshherë dalin dy e më tepër grafema për një fonemë të vetme, por kemi edhe raste të kundërta kur një fonemë shkruhet me dy e më tepër grafema.

---

<sup>21</sup> Eqrem Çabej, “*Meshari*” i *Gjon Buzukut (1555) I*, Tiranë, 1968, f. 93.

<sup>22</sup> Anastas Dodi, *Theksi dhe shkallëzimi i tij në gjuhën shqipe*, Gjuha jonë 2/1990, Tiranë, f. 8.

### 3.1. SHKRONJAT PËR FONEMA ZANORE

#### Shkronja <a>

Me këtë shkronjë edhe te Fjalorët shumëgjuhësh të Pulevskit shënohet fonema /a/ e shqipes (e hapur, qendrore e pabuzorëzuar)<sup>23</sup> në të gjitha pozicionet fonetike të fjalës, si p.sh. вла (vlla), авул (avull) II 87, даллга (dallga) I 16, машкулл (mashkull) II 9, шпирта жал (shpirta zhall) II 8; кока, креа, каптина (кока, креа, картина) I 21, дамаратъ (damarat) I 23 etj.

Nga shembujt e sjellë, sipas mënyrës së shqiptimit të sotëm dialektor, disa nga zanoret [a] realizohen si të gjata, si vlla:, a:vull, ma:shkull etj., por autori nuk është konsekuent në shënimin e gjatësisë së zanoreve, për dallim nga shumë raste të tjera ku /a/-ja e gjatë shënohet me dyzimin e shkronjës, përkatësisht me <aa>, si аваа (ava:), вллаа (vlla:) I 63, калаа (kala:) I 17, е таа (e tha:) II 8, саа (sa:) II 74, наа (na:) II 15 etj.

Grafema <a> na del e dyzuar edhe atëherë kur bie faringalja [h]: саати (saati < sahati) I 71, саатчи (saatçi < sahatçi) I 55 etj.

#### Shkronja <e>

Edhe kjo grafemë në Fjalorët e Pulevskit shërben për ta regjistruar fonemën /e/ (gjysmë e hapur, e përparme e pabuzorëzuar)<sup>24</sup> në të gjitha pozicionet në fjalë. Mënyra e nyjëtimin duhet të ketë qenë e njëjtë me shqiptimin e sotëm të kësaj zanoreje si në të folmen shqipe të Dibrës, ashtu edhe në gjuhën stanarde shqipe. Kështu kemi: пелъа (pela) I 40, делъе (dele) I 41, дереце (drexhe) I 59, еде (edhe) etj.

Me grafemën <e> ndonjëherë është shënuar /ë/-ja e shqipes, si: перенди (perëndi), вјетер (vjetër) II 12, несер (nesër) I 85, ка веше (ka veshë), кан веше (kan veshë), аште (ashtë), krahas shënimit të kësaj foljeje ndihmëse edhe pa shkronjën <e> fundore: ашт (asht) II 14 etj.

Si çdo fonograf që shënon zanore të gjatë në këta dy Fjalorë, ashtu edhe <e>-ja haset e dyzuar në shumë raste: вртее (vrte: < vërtet), улеени (u le:ni < lindni), рее (re:) II 36. Edhe këtu, me rënien e tingullit [h] ka raste të dyfishimit të grafemës <e>: шкреен (shkre:n < shkrihen, shkrehen) II 27. Shembuj të shkrimit të dy <e>-ve të njëpasnjëshme kemi vënë re edhe me rastin e rënies së /n/-së ndërmjet dy <e>-ve, si зее (ze: për zene, zine, zëre) I 37 si dhe me rënien e [j]-së epretitike: прее (pree, pre: < preje) I 66 etj.

#### Shkronjat <и, ѝ>

Marrë në tërësi, shkronja <и> (lexohet i) në Fjalorët në shqyrtim shënon fonemën /i/ të shqipes (varianti themelor i saj karakterizohet se është e përparme, e mbyllur e pabuzorëzuar)<sup>25</sup>, si p.sh. куљумри (kulumri) II 148, чиш (çish < çysh, si) II 14, цили (çili) II 15, дети (deti) II 18, мишъ (mish) I 39, мишин (mishin) II 53, љуми (lumi) I 56 etj. Kjo grafemë përdoret në të dy Fjalorët. Fonografi <ии> shërben për ta shënuar /i/-në e gjatë. Ja disa shembuj të nxjerrë nga Fjalorët: диитун (di:tun),

<sup>23</sup> Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 45.

<sup>24</sup> Bahri Beci, *Fonetika*, Prishtinë, 2004, f. 36.

<sup>25</sup> Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe* (dispensë në dorëshkrim), Shkup, 2004, f. 83.

дии (di: < dy), кии (ki:) II 15; пии (shi:) II 86, зотнии (zotni:) I 53, сиитъ (si:t < sytë) I 33, мииръ (mi:r < mirë) I 63 etj.

Në pozitë fundore dhe në mes të fjalës në Fjalorët e Pulevskit ndërkëmbehen mesgjuhorja /j/ me zanoren /i/. Nga kjo del se me grafemën <и> ndonjëherë këtu është shënuar bashkëtingëllorja /j/, si p.sh. шкои (shkoj), па фаи (pa faj) I 67, е дреита (e drejta) I 68, уи (uj < ujë) I 86, дуи (duj < duej) I 89, че андеи (çe andej) I 97, θоин (thoin < thojn < thojnë, thonë) II 3, та мсоим (ta msojm < ta mësojmë) II 4, дритоин (dritojn < drejtojnë) II 4, та бесоим (ta besojm < ta besojmë) II 5, шкоим (shkojm < shkojmë) II 14, пастаи (pastaj) II 26, маимун (majmun) I 48 etj.

Shënimi i fjalëve me grafemën <й> është i rrallë te paralelja shqipe e fjalorëve të Pulevskit. Gjatë analizës grafike të fjalorëve në shqyrtim kemi gjetur vetëm tri fjalë në përbërjen shkronjore të të cilave e kishte edhe këtë: нѣрый (njerii), дречурый (dreçurii) dhe шпотурый (shpoturii) I 12. Këtë grafemë autori e ka përdorur vetëm në Fjalorin katërgjuhësh dhe si duket me këtë ka regjistruar /i/-në e shqipes.

### Grafema <o>

Rreth përdorimit të kësaj shkronje nuk kemi ndonjë vështirësi, meqë në këta Fjalorë përdoret pa luhate dhe shënon fonemën /o/ të gjuhës shqipe (gjysmë e hapur, e prapme, e rabuzorëzuar), si пошта (poshta < posta) I 11, мос бон (mos bon < mos ban, bën, bëj) I 11, вдор (vdor, borë) I 15, фтохт (ftoht) I 15, гропа (gropa) I 16, нофула (nofulla) II 15, дорза (dorza, doreza) I 30, бошт (bosht) I 32, шош (shosh < shoshë) I 33, ода (oda) I 35, зот (zot) II 5, фажтор (fajtor) II 10, по ројм (po rojm < po rrojmë, po jetojmë) II 16, коломбоћ (kollomboq, misër) II 30, роса (rosa) I 44, сор (sor < sorrë) I 44 etj.

Gjithashtu, edhe shkrimi i njëpasnjëshëm i dy <oo>-ve shënon fonemën /o/ të gjatë: доо (do:), пунтоор (punto:r < punëtor) I 55, пуноо (puno:) I 65, боо бес (bo: be:) I 82, лышоо (lisho:) I 10, метроо (metro: me kuptimin numëro, mat) etj.

### Shkronja <y>

Shkronja <y> është shënuar me vlerë të fonemës /u/: дул (dul < doli) I 15, гур (gur) I 15, трулл (trull < truell, truall) I 15, пруга (prua < përua < përdua) I 16, фусх (fush < fushë) I 16, гури (guri) I 19, унда (unda < hunda) I 21, гуша (gusha) I 21, кумбулла (kumbulla) I 46, пешку бут (peshku but < peshku i butë) I 51, куш (kush) II 14, ку рет уји (ku reth uji < ku rrjedh uji) II 19, грун (grun) II 64, руш (rush < rrush) II 64, шућуръ (shuqur < shuqur) I 76, нруше (nrushe < ndryshe) II 72, шум (shum < shumë) II 74, пулумбъ (pullumb < pëllumb), дулундиши (dullundishi < dallëndyshja), гугушка (gugushka < gugutka, pëllumbi), һуће (quqe < quqe) I 44, пуле детит (pule detit < pulë e detit, pulë deti) I 44, буфъ (буф) I 44 etj. Pulevski shpeshherë /u/-në e gjatë e shënon me dyzimin e saj, si куу (kuu, ku:) II 78, шкруур (shkruur) II 91, суу (thuu) II 21, труутъ (truut) I 23 etj.

Siç dihet, në sistemin e saj vokalik maqedonishtja nuk e ka fonemën /y/. Këtë fonemë nuk e kanë as shumica e të folmeve të gegërishtes qendrore.<sup>26</sup> Sipas studimeve

<sup>26</sup> Bahri Beci, *Të folmet qendrore të gegërishtes*, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987; *Mbi katër inovacionet fonetike të të folmeve të Gegënisë së Mesme*, Konferenca e Parë e Studimeve

të bëra për të folmen e Dibrës<sup>27</sup> dhe të folmet e tjera të gegërishtes qendrore, si të folmes së Tetovës, Dervenit (që gjendet ndërmjet Tetovës e Shkupit),<sup>28</sup> të folmes shqipe të Shkupit (Karshiakës,<sup>29</sup> Karadakut)<sup>30</sup>, të Tuhinit të Kërçovës,<sup>31</sup> të Gostivarit<sup>32</sup> etj. mbizotëron mendimi se në të shumtën e rasteve /y/-ja është zhbuzorëzuar në /i/, përkatësisht është humbur kundërvënia fonologjike /y/ ~ /i/. Te një grup fjalësh /y/-ja pasi është zhbuzorëzuar në /i/, ajo pastaj ka evoluar edhe më tej, përkatësisht është diftonguar në variante të ndryshme diftongjesh dytësore.

Te disa fjalë /y/-ja është shndërruar në /u/, si në fjalët шухуръ (shuqur < shyqyr) I 76, нруше (nrushe < ndryshe) II 72, hyhe (quqe < qyqe) I 44 etj.

Thënë troç, fonemën /y/ nuk e ka as e folmja shqipe e Dibrës e as maqedonishtja, prandaj te Pulevski nuk kemi grafemë për ta shënuar fonemën /y/ të shqipes. Sipas të dhënave që kemi, fonemën [y] e ka e folmja e Zajazit dhe e Sërbicës së Kërçovës.<sup>33</sup> Sipas një analize të grafisë së dy Fjalorëve shumëgjuhësh në shqyrtim kemi ardhur në përfundim se me kombinimin e dy shkronjave të shkruara bashkë <ui> (lexohet [ui]) autori në fjalë në disa raste ka regjistruar një tingull që gjendet në mes të [y]-së dhe [i]-së, përkatësisht një [y] e hapët më pak e buzorëzuar se ajo e shqipes së përbashkët, e cila sipas shenjave të transkriptimit shënohet me [ɥ].<sup>34</sup> P.sh. дуи (dɥ < dy) II 112, у суй (u thɥ) I 36, друи (drɥ) I 34, нуи (nɥ < ny, nyje) I 45, друи (drɥ < dry) I 32, 34; у фруи (u frɥ < u fry) I 36, буик (bɥк < byk) I 32, думадийет (dɥmadhijet < dymbëdhjetë) I 26 etj.

Pohimi ynë ka mbështetje të fuqishme edhe në studimet dialektore për të folmen e Dibrës. Kështu, sipas prof. Bahri Becit në të folmen e Grykës së Madhe të Dibrës ndonjëherë tingulli [y] dëgjohej si një [y] që shkon në drejtim të [i]-së: brrɥl, dɥ, gryk, gj'ɥsh, kɥsh, krɥq' etj.<sup>35</sup> Vlen të përmendet se /y/-në edhe si grafemë edhe si fonemë e ka përdorur Josif Bageri, bashkëvendas i Gjergj Pulës në “Kopësht malsori”<sup>36</sup>. Kjo zanore e përparme e mbyllur dhe e buzorëzuar ruhet edhe në të folmen e Rekës së Epërme.<sup>37</sup> Se e folmja e Rekës e shqipton /y/-në pohon edhe prof. Remzi Nesimi.<sup>38</sup>

Albanologjike, Tiranë, 1965; *E folmja e Shkrelit*, Dialektologjia shqiptare I, Tiranë, 1971; *Hulumtime gjuhësore në Mat*, BUSH, SShSH, Tiranë, 1962

Bahri Beci, *E folmja e Grykës së Madhe të Dibrës*, Studime filologjike nr. 3, Tiranë, 1972; *E folmja e Reç-e-Dardhës së Dibrës*, Studime filologjike 4, Tiranë, 1964; *E folmja e Luznisë së Dibrës*, Dialektologjia shqiptare II, Tiranë, 1774. Naim Basha, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989.

<sup>28</sup> Remzi Nesimi, *Përdorimi dhe diftongimi i vokaleve /i/ dhe /u/ në të folmen shqipe të rrethit të Tetovës*, Jehona nr. 2, Shkup, 1972; *Diftongimi i zanoreve /i/ dhe /u/ në folmen e Dervenit*, Shkup, 1997, f. 85-104. Fadil Sulejmani, *Vokalizmi në të folmen e Malësisë së Sharrit të Tetovës*, Gjurmime albanologjike 15-85, Prishtinë, 1986.

<sup>29</sup> Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997. Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit* (punim doktorati në dorëshkrim), Shkup, 1999.

<sup>30</sup> Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit* (punim doktorati në dorëshkrim), Shkup, 1999.

<sup>31</sup> Qemal Murati, *Mbi të folmen shqipe të rrethinës së Tuhinit të Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989.

<sup>32</sup> Fehim Reçani, *Ligjërimi shqip i rrethit të Gostivarit – fonetikë e morfologji* (temë magjistrature e mbrojtur në Prishtinë).

<sup>33</sup> Lulzim Aliu, *Gjuha në disa këngë të moçme kërçovare* (punim magjistrature në dorëshkrim), Shkup, 2005.

<sup>34</sup> Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1975, f. 32.

<sup>35</sup> Bahri Beci, *E folmja e Grykës së Madhe të Dibrës*, Studime filologjike III, Tiranë, 1972, f. 90.

<sup>36</sup> Shaqir Berani, *Gjuha e Josif Bagerit*, Prishtinë, 1988, f. 63.

<sup>37</sup> Sefedin Haruni, *E folmja shqipe e Rekës së Epërme*, Shkup, 1998; *Veçoritë karakteristike të së folmes së Rekës së Epërme*, Çështje të studimeve albanologjike (materiale nga Simpoziumi shkencor i mbajtur në Prishtinë më 29 dhe 21 dhjetor 1985), Prishtinë, 1987.

Pra, e folmja e Rekës, e vendlindjes së Pulevskit në sistemin e saj e ka fonemën /y/, por meqë maqedonsishtja e asnjë nga gjuhët e tjera sllave nuk e kanë këtë fonemë, autori në gjuhën shqipe dallon zanoren e buzorëzuar /y/, por të cilën nuk ka mundur ta shqiptojë ashtu siç duhet, rrjedhimisht edhe të përdorë ndonjë grafemë të veçantë për të, por bën kombinimin e dy shkronjave <уи> (ui) për ta shënuar një /y/ që është më pak buzore se e rëndomta.

### Shkronjat <ь> dhe <ѣ>

Këto dy shkronja i gjejmë vetëm te Fjalori katërgjuhësh. Shkronjën e parë sllavistët e quajnë “er i vogël”, ndërsa të dytën “er i madh”.<sup>39</sup> Me këto dy grafema janë shënuar dy zanore të sllavishtes së vjetër. Ato kanë qenë vokale të reduktuara – shqiptimi i tyre ka qenë edhe më i shkurtër sesa zanoret e shkurtra të sotme. Mirëpo, nga shekulli X e XI nujëtimi i këtyre gjysmëzanoreve u ndryshua, përkatësisht u inkadrua në fushën e shqiptimit të [o]-së dhe [e]-së.<sup>40</sup> Këto dy shkronja i ruan në alfabetin e saj rusishtja dhe bullgarishtja, i shkroi Pulevski edhe në paralelen shqipe të Fjalorit katërgjuhësh.

Me “erin e vogël” Pulevski në shqipen e Fjalorëve të tij ka shënuar fonemën /ë/: кѣмѣ, кѣмѣтъ (këmb, këmbat < këmbë, këmbët) I 22, дѣмѣтъ (dhëmbatë < dhëmbët) I 22, тѣи (tëi < ti) I 96, кѣтъръ (katër) I 26, 27, 28, 29; елѣъ (ellë < hell, helli) I 33, чѣлѣзница (çellëznica < punëtori çelësash) I 34, бѣштѣтъ (bështet < mbështetë) I 34, вогѣлъ (vogël < i vogël) I 36, дѣмѣ (dhëmb) I 22, мѣзъ (mëz) I 40, пѣрфундѣ (përfund) I 38, тѣлинѣ (tëlin < tëlyen) I 39 etj.

“Eri i madh” i mbyll fjalët që përfundojnë me bashkëtingëllore dhe në të shumtën e rasteve nuk ka vlerë fonematike, si: гиштѣ (gisht) I 22, суѣтъ (thuat < thonjtë), баркѣ (bark), микѣтъ (mikat < miqtë) I 64, фисѣтъ (fisat < fiset) I 64, гури шкрѣпѣсъ (guri shkrepës) I 19, цѣпѣтъ (xherpat) I 29, сумбулѣлъ (sumbull) I 30, лѣшѣ (lesh), памбуку (pambuk) I 31 etj.

Ndonjëherë me erin e madh është shënuar edhe /ë/-ja, si кѣпуѣ, кѣпуѣѣтъ (këpusë, këpusat) I 30, ѣштѣ (është) I 15, 65; јо сѣштѣ (jo s’është) I 96 etj.

### Grafema <ѣ>

Kjo grafemë në gjuhën maqedonase të Fjalorit katërgjuhësh të Pulevskit, nëse kihet parasysh shpërndarja e saj e vjetër nëpër librat kishtarë sllave, përdoret vetëm atëherë kur ndihet nevoja që të theksohet shqiptimi kishtar i sllavishtes së vjetër.<sup>41</sup> Mirëpo, në paralelen e shqipes së Fjalorit I ka disa funksione:

a) Fonografi <ѣ> shënon fonemën /e/ të shqipes në pak raste, si мѣсѣ нат (mes nat < mes natë) I 85. Këtë edhe më bindëse e bën shkrimi i fjalës *neser* ose *nesër* në dy variante, ku në njëërën formë në vend të grafemës <ѣ> gjendet <e>-ja: нѣсер dhe несер I 85.

<sup>38</sup> Remzi Nesimi, *Mbi disa veçori të sistemit vokalik të së folmes shqipe të rrethit të Tetovës*, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987, f. 184.

<sup>39</sup> Блаже Конески, *Македонскиој ...*, f. 213.

<sup>40</sup> Блаже Конески, *Историја на македонскиој јазик* (Historia e gjuhës maqedonase), Shkup, 1989, f. 28-29.

<sup>41</sup> Блаже Конески, *Македонскиој XIX век, ...*, f. 211.

b) <ѣ> = [je]: мѣкра (mjekra < mjekrra) I 21, вѣтеръ (vjetër) I 31, 41; вѣра (vjera < vjehrra) I 64, мѣштеръ (mjeshtër) I 36, вѣнь (vjen) I 51, луле бѣшкитъ (lule bjeshkit < lule bjeshke) I 36, нѣрыи (njeri) I 21, нѣрсъ (njers < njerëz) I 21, пѣкуръ (pjekur) I 39, пѣштъ (pjesht < plesht) I 52, свѣн ма (s'vjen ma) I 67, мѣръ (mjer) I 69, бѣваръ (bjevar < blerës) I 88, пѣргулъ (pjergull) I 47, пѣшкъ (pjeshk) I 47 etj.

c) <ѣ> = [ja]: ѣунѣ (gjunja) I 22, 54; ѣунѣтъ (gjunjat < gjunjtë) I 22, бринѣтъ (brinjat < brinjët) I 22, бринѣ (brinja < brinj) I 42 etj.

Ka shembuj që takimi i grafemës <ѣ> me një <e> pasuese formon fonemën /e:/ të gjatë, si бѣет (bjeet < bletë) I 72, вѣетер (i vjeetër) I 31, тѣетер (tjeetër < tjetër) I 72 etj.

### Grafemat <ы, я, ю; ја, ју, је>

Tri shkronjat e para Pulevski i ka përdorur vetëm në Fjalorin katërgjuhësh, ndërsa tri të fundit vetëm në Fjalorin tregjuhësh. Shkronja <ы> ka regjistruar herë fonemën /i/ e herë /j/-në e shqipes, si p.sh. фаы dhe фаи (fai, faj) I 98, ны (nji < një) I 18, бие шыи (bie shii) I 15, турыи (turi) I 21, сыи hora (sii qora < sy qorra, të verbër) I 22, сытъ (sit < sytë) I 21, ѣумштѣтъ (qumshtit < qumështit) I 23, дылли бые (dilli bie < dielli bie) I 14 etj. Si /j/ e kemi konsideruar në fjalët уыи (uji) I 16, ныеръ (njier < një herë) I 52, ныфѣ (njif < njeh < numëro) I 10 etj.

Me shkronjat <я> dhe <ю> grafikisht është paraqitur rrokja [ja], përkatësisht [ju]. P.sh. <я> = [ja]: вия (vija) I 19, цяпъ (сјар) I 43, зоня (zonja) I 12, 53, 54; гоја (goja) I 11, яка (jaka) I 30, зяри (zjari < zjari) I 38, вям (vjam) I 39, фяли (fjali) I 81, мялти (mjalti) I 53, бия (bija) I 63, мяфѣтъ (mjaf) I 70, 79; аяти (ajati < hajati) I 38 etj. Kemi hetuar pak raste kur përdoret grafema <я> me vlerë të [ja]-së, por pas kësaj edhe shënim të <a>-së, që ka për pasojë dyfishimin e /a/-ve, si te fjalët дуняа (dunjaa < dunja) I 14 por edhe дуня (dunja) në të njëjtën faqe të fjalorit Katërgjuhësh; вьям (vjaam) I 39, я кияа (ja kijaa < ja kjo) I 96 etj. Të vetmin rast të përdorimit të dyfishtë të <j>-së e kemi parë në fjalën дјял (djjal) I 70, s'do mend se është gabim teknik.

<ю> = [ju]: юве (juve) I 21, 52, 76; пьюте (pëjute < pyete) I 63, 93; юјенумиярь (jujenumijar < yjenumërues) I 59 etj.

Për Pulevskin, bashkimi i mesgjuhores tingëlluese /j/ me zanoret /i/, /a/ ose /e/ paraqet grafemë dhe fonemë më vete dhe si të tilla i trajton në Fjalorin tregjuhësh. Kështu, [j]-ja para zanoreve është tingull paraprirës për artikulin e zanoreve që pasojnë. Në këtë mënyrë i ka krijuar grafemat e veçanta <ји> (lexohet [ji]), <ја> dhe <је>. Këto grafema janë përdorur vetëm në Fjalorin trigjuhësh, por mjaft rrallë. Sa për ilustrim po sjellim disa fjalë në përbërjen grafike të të cilave i gjejmë edhe grafemat <ји, ја, је>. Krahaso:

<ји> = [ji]: њјери (njjeri < njeri) II 9, рјим (rjim < rrimë) II 14, рји (rji < rri) II 71, њјисер (njjier < një herë) II 70, шји (shji < shi) II 87, зотији (zotiji < zotni, zotëri) II 9, венди штрјир (vendi shtrjir < vend i shtrirë) II 20 etj.



<ja> = [ja]: шкронџа (shkronjja < shkronja) II 95, њјани (njјani < njani, njeni, njeri) II 31 etj.

<je> = [je]: уксујет (u kthujet < u kthye), напјера (napërjera < nëpër era, erëra) II 32 etj.

Vlen të theksohet me këtë rast se disa shkronja në Fjalorin trigjuhësh të Pulevskit janë pasqyrë e një kryqëzimi ndërmjet shënimit të tyre të vjetër (në Fjalorin katërgjuhësh) dhe shënimit të ri (në Fjalorin trigjuhësh), si bie fjala: њјани (njјani < njani, njeri) II 1, њјофмеја (njјofmeja < njohuria, dituria) II 10, њјом (njјom < i njom) II 31, њја (njja < nja, një) II 68, мураџи (muranjji < murlani, stuhia) II 17, кањјофун (kanjјofun < ka njohur) II 60 etj.

### Grafema <->

Jemi përcaktuar ta konsiderojmë për shkronjë edhe vizën, sepse me këtë shenjë grafike Pulevski ka regjistruar disa fonema zanore. Duke dashur që t'i regjistrojë sa me më përpikëri vlerat tingullore të fjalëve, autori në spikamë ka përdorur vizën lidhëse, sepse ka pandehur se asnjë grafemë tjetër që shënojnë zanore nuk i përgjigjet plotësisht pasqyrës reale nyjetimore e akustike. Kështu, duke menduar se sistemi grafik zanor është i varfër për t'i shprehur disa nuanca tingullore të zanoreve, autori i fjalorëve përdori edhe vizën lidhëse.

Këtë fonograf e gjejmë në Fjalorin trigjuhësh në paralelen shqipe, maqedonishte dhe turqishte. Në shqipen e shkruar të fjalorëve mund të supozojmë se çka shkon në vend të vizës së tekstit dhe kështu ne del se viza te Pulevski shënon:

a) Fonemën /ë/ të shqipes: к-ндон (këndon) II 125, вог-л (vogël < i (e) vogël) II 149, м-нџес (mëngjes) II 142, пуп-за (pupëza) II 144, к-га (këta) II 149, т-и (tëi < ti) II 130, ф-нђи (fëngji < fëngjill < thëngjill) II 133, данд-р (dhëndër, dhëndër) etj.

b) Viza në disa raste shënon rënien e [ë]-së fundore, që dikur shënoheshin me apostrof: м-џа, т-џа, м-џан (m'џа < më џа, t'џа < të џа, m'џан < më џанë) II 138, т-фала (t'fala < të fala) II 154, м-бојет (m'bojet < më bëhet) II 157, н-доо (n'doo < në do, nëse do), по н-даш (po n'dash < po në dash, në даç) II 127, н'кам (n'kam < në kam) II 131 etj.

c) Te shqipja e Fjalorit trigjuhësh viza është përdorur për të shënuar edhe ndonjë zanore tjetër, derisa edhe shqiptimin më të zgjatur të bashkëtingëllores pas të cilës është shkruar, si p.sh. с'ште (s'është) II 127, з-м-р (zemër) II 152, з-м-рат (zemrat) II 152, аф-роје (affroje < afroje) II 144, м-шиљур (mshilur < mshelur, mbyllur) II 99, им- (imm) II 139, грамб-љ (grambul), грамб-љат (grambulat) II 129 etj.

### 3.2. SHKRONJAT PËR FONEMA BASHKËTINGËLLORE

Derisa në shënimin e fonemave zanore në tekstet shqip të Fjalorëve të Pulevskit kemi një laramani të madhe shkronjash, çështja e grafisë së bashkëtingëlloreve na del më e qartë. Për të kuptuar vlerat fonematike të grafemave bashkëtingëllore në këta fjalorë, mjafton të dihet alfabeti i sotëm cirilik i plotësuar me disa shkronja të sllavishtes së vjetër, alfabetit të Vuk Karaxhiqit, një shkronjë greke etj.

Në vazhdim do t'i paraqesim të gjitha grafemat të përdorura për shënimin e bashkëtingëlloreve në të dy fjalorët dhe do të japim vlerën e tyre fonematike. Për disa fonografe kemi shkruar më pak e për disa më tepër, ashtu siç e kemi parë të udhës, ngaqë leximi i disa shkronjave nuk paraqet vështirësi.

E folmja shqipe e Dibrës në inventarin e saj konsonantik ka 27 fonema bashkëtingëllore.<sup>42</sup> Në këtë të folme janë defonologjizuar dhe kanë rënë nga sistemi bashkëtingëllor i fonemave faringalja e shurdhët /h/ dhe shumëdridhësja tingëlluese /rr/. Vetvetiu parashtrohet pyetja se si e paraqet sistemin konsonantik Gjorgji Pulevski në paralelen shqipe të fjalorëve të tij?

Analiza grafike e tekstit na nxori po ashtu 27 fonema bashkëtingëllore, me dallim se këtu mungon paragjuhuria afrikate /x/ dhe shumëdridhësja /rr/, e cila në tekstin në fjalë plotësisht është njësuar në /r/. Fonema /h/ në shqipen e fjalorëve të Pulevskit përdoret në të gjitha pozitat e fjalës (në pozitë nistore, mesore dhe fundore), ndërkaq /rr/-ja mungon si në të folmen e Dibrës, ashtu edhe në shqipen e Gjergjit. Sistemi konsonantik i përfutur nga analiza grafike e fjalorëve të Pulevskit mund të paraqitet në këtë mënyrë:

Vendi i formimit			Buzore		Gjuhore					Glotalë	
			Dybu-zore	Buzore-dhëmbore	Paragjuhore			Mes-gjuhore (palatale)	Prapa-gjuhore (velare)		
					Ndërdhëmbore	Alveo-dhëmbore	Alveolare				
Mënyra e formimit			p			t			q	k	të shurdhëta
			b			d			gj	g	të zëshme
Të zhurmëta	Mbylltore	Shpër-thyese									të shurdhëta
		Afri-kate				c	ç				të zëshme
	Shtëgo-re		f	th		s	sh			h	të shurdhëta
			v	dh		z	zh				të zëshme
Sonore	Hundore	m				n		nj			
	Anësore				ll	l					
	Mesore							j			
	Dridhëse					r					

<sup>42</sup> Naim Basha, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989.

### Grafema <б>

Me këtë shkronjë është shënuar fonema dybuzore mbylltore e zëshme /b/ e shqipes, si në fjalët боне, баро (bone, baro < bane, bëre; mbaro, përfundo) I 11, у збардъ (u zbard < u zbardh) I 14, буримъ (burim) I 16, барка (barka) I 19, мбас (mbas, pas) II 3, барна (barna) II 9, 25; букур (bukur < i bukur) II 26, брум (brum) II 35, бјешка (bjeshka) II 62 etj.

### Grafema <в>

Kjo shkronjë regjistron fonemën buzore-dhëmbore të zëshme /v/ të shqipes në tekstin e dy fjalorëve të Pulevskit, si p.sh. кувенд (kuvend) II 3, ка ветвете (ka vetvete < nga vetvetja) II 6, вдоръ (vdor, borë) I 15, изворъ (izvor, burim), венешъ (vënesh vneshtë, vreshtë) I 16, вии (vijë) I 18, вени (veni < vendi) I 20, ветулла (vetulla) I 21, неве (neve) II 70, вјетин (vjetin < vitin) II 82, јава (java) II 83, вера (vera) I 25, арове (arove harrove) I 80 etj.

### Grafema <г>

Shkronja <г> përdoret për ta paraqitur në mënyrë grafike fonemën /g/ të shqipes në të dy fjalorët e Gjorgji Pulevskit, që është një prapagjuhore mbylltore e zëshme. Si në rastet e dy shkronjave të mëparme (<б, в>), ashtu edhe shkronja <г> shënen në të gjitha rastet, pa përjashtim, vetëm fonemën /g/, si гуръ (gur) II 16, гρυа (grua) I 43, гропа (gropa) I 16, гуша (gusha) I 21; гурмазе, грика (gurmazë, grika < gurmazi, gryka) I 21, гаць (gac gacë) I 38, гомари (gomari) I 40, нгушт (ngusht) II 19, гјуха (giuha, gjuha) II 20 etj.

### Grafema <д>

Kjo shkronjë është përdorur për të regjistruar disa fonema bashkëtingëllore të shqipes së fjalorëve në shqyrtim. Në rend të parë ajo shënon /d/-në e shqipes (majegjuhore, alveolare-dhëmbore, mbylltore e zëshme)<sup>43</sup> si në fjalët: перенди (perëndi) I 12, дита (dita) I 13, вдоръ (vdor < vdorë, borë) I 15, дритъ (drit dritë) I 17, доратъ (dorat < duart) I 22, дитъ (dit < ditë) I 24, II 8; дега (dega) I 45, чадъръ (çadër < ombrellë) I 58, дамъ (dam, dëm) I 61, дии (dii, di) II 9, вдесин (vdesin) II 24, мадем (madem, хехе) II 25, дасме (dasme, dasmë) II 148 etj.

Germa <д> shënon edhe fonemën /dh/: еде (edhe), и мад (i madh) I 12, у збард (u zbardh) I 14, згедин (zgjedhin < zgjedhin), ден (dhen) I 35, у дерд (u derdh) II 59, дарда (dardha) I 46, барде (bardhë, i bardhë) II 96, дји (dhi), дамбатъ (dhambat < dhambët) I 22, деу (dheu) I 62, верд (verdh) II 92, дандъръ (dhëndër) I 64 etj.

Në pak fjalë, si дрида (drida drita) I 86, даллга е дедитъ (dallga e dedit < e detit) II 16 e në ndonjë rast tjetër në vend të paragjuhores mbylltore të shurdhët [t] është shënuar korresponduesja e saj e zëshme [d], që mund të konsiderohet si gabim teknik. I njëjti ngatërrim i çiftit të bashkëtingëlloreve të pazëshme e të zëshme është bërë edhe

<sup>43</sup> Anastas Dodi, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004, f. 78.

me shënimin e /th/-së dhe /dh/-së. Në Fjalorët në spikamë kemi edhe për “ethe” I 90 ose чедунъ, ђедуръ (çedhun < çethun, qedhur < qethur) I 41, të cilat shqiptohen me /th/ në mes.

### Grafema <ж>

Këtë shkronjë Pulevski e përdori për të shënuar si në maqedonishten, turqishten e greqishten e fjalorëve të tij edhe /zh/-në shqipe (paragjuhore, qiellzore-alveolare, dyvatërshe, shtegore, shushuritëse, e zëshme). Denduria e përdorimit të saj në paralelen shqipe është e vogël.<sup>44</sup> Në të shumtën e rasteve kjo grafemë përdoret në strukturën fonematike të fjalëve të huaja. E folmja e Rekës së Dibrës, si dhe disa fshatra të qarkut të Shkupit (Karshiakës) shpeshherë [gj]-në e afrikatizojnë në [xh], por ka raste edhe kur e këmbëjnë me [zh]-në.<sup>45</sup>

Kjo dukuri gjën mbështetje edhe për arsye se e folmja maqedonase e Galiçnikut në inventarin fonematik nuk e ka /zh/-në, prandaj Pulevski shpeshherë e këmben me /xh/-në, si p.sh. жумон (zhumon < gjëmon) II 88, шпирта жал (shpirta zhall < shpirtra të gjallë, me kuptimin “gjallesat”), жалура (zhallura < gjallesat) II 8, жалла (të gjalla) I 68, мулежиу (mullezhiu < mullexhiu) I 55, жамадан (zhamadan < xhamadan) I 29, аждер (azhder, krokodil) II 35, литеражи (literazhi me kuptimin “njeri që ka për profesion përpunimin e litarëve) I 56, чережи (çerezhi < çerrexhi < qerrexhi, qerrepunues) I 56 etj.

Në Fjalorin trigjuhësh bëhet përpjekje më e madhe për dallimin e bashkëtingëllores /zh/ dhe /xh/. Kështu, kemi жив (zhiv < zhivë) II 28, цалура (xhallura < gjallesa), краhas жалура (zhallura) II 34, цал (xhall < gjallë) II 95 etj.

### Grafema <з>

E gjejmë të shkruar në të dy fjalorët dhe rregullisht shërben për pasqyrimin grafik të bashkëtingëllores /z/ të shqipes. Po sjellim disa fjalë në strukturën shkrimore të të cilave e ka edhe këtë shkronjë: измети (izmeti < hyzmeti, shërbimi) I 13, зине (zine, zëre) I 13, анза (anza < hanza hëna) I 14, II 76; забель (zabel) I 16, збразе (zbrazе) I 37, шкозъ (shko:z < shkozë) I 46, е зезъ (e zez e < zezë) I 47, brez (brez) II 23, дуизет (duizet < dyzet) II 83, њераз (njeraz < njerëz) I 47, II 48; зјари (zjari zjarri) I 38 etj.

### Grafema <j>

Përgjithësisht grafema <j> në shqipen e fjalorëve në shqyrtim përdoret për regjistrimin e fonemës /j/, si: ajo (ajo) II 11, јан (jan < janë) II 11, јет (jet < jetë) II 16, уји (uji) II 18, бјешк (bjeshk < bjeshkë) II 21, зјар (zjarr) II 21, вјети (vjeti) II 23, бије (bije < bie) II 23, кусија (kusiја, kusia) II 27, маји (maji) II 81, муји (muji, muaji) II 81 etj.

Në shumë raste në të dy fjalorët, në vend të <j>-së e kemi shkronjën <и>, që shënon /i/-në e shqipes, si p.sh.: θоин (thoin < thojnë, thonë) II 33, кувендоин

<sup>44</sup> Denduria e përdorimit të bashkëtingëllores /zh/ është e vogël edhe në shqipen dialektore e standarde. Ajo zë vendin e 33-të vetëm me 0.213% denduri leksikore apo 0.035% denduri ligjërimore. Shih: Asllan Hamiti, *Fonetika dhe fonologjia e gjuhës standarde shqipe* (dispensë në dorëshkrim), Shkup, 2003, f. 158.

<sup>45</sup> Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997, f. 88-89 jep shembujt: i zha:ll < i gjallë, zhaku < gjaku, zhimsa < gjysma, zharpen < gjarpën etj.

(kuvendojnë) II 38, дреит (drejt) II 78, по роин (po roin < po rrojñë, po jetojnë) II 12, мсоин (msoin mësojnë) II 14, луин (luin lujnë), пастаи (pastai pastaj) II 32 etj.

Kemi edhe pak raste të përkundërt ku <j>-ja ia zë vendin shkronjës <и>, si чельк (çeljk < çelik) II 26, por edhe челик (çelik) në të njëjtën faqe të fjalorit etj. Kemi parë një fjalë ku <j>-ja shënon /dh/-në: жи (dhii < dhi) I 55.

### Shkronja <к>

Kjo shkronjë shënon vetëm fonemën prapagjuhore mbylltore të shurdhët /k/. P.sh. кумбулла (kumbulla) I 46, кам (kam) II 3, нук (nuk) II 21, кафе (kafe) II 34, кур (kur) II 79, калнор (kallnor) II 81, ка (ka) II 81 etj.

### Shkronjat <љ, л, лл>

Me këto shkronja janë shënuar tingëllueset lëngëzore /l, ll/ në paralelen shqipe të fjalorëve të Pulevskit. Dy shkronjat e para <љ, л> janë përdorur në Fjalorin trigjuhësh, ndërkaq dyshkronjeshja <лл> vetëm në Fjalorin katërgjuhësh. Ky dyshkronjesh u krijua sipas modelit të <ll>-së shqipe (l + l = ll → л + л = лл).

Grafema <љ> në gjuhën maqedonase shënon një tingull tjetër nga [l]-ja shqipe. Në maqedonishten ky tingull shqiptohet në atë mënyrë ka fillim të ngjashëm me [l]-në, por mbarim të [j]-së, përkatësisht si [lj]. Megjithë këtë ndryshim nujëtimor, Pulevski me [љ]-në ka shënuar /l/-në shqipe: љуље (lule) I 49, фољим (folim, flasim) II 10, љуми (lumi) II 19, амље (amlë < ambël < i ambël) II 19, цоли (xholi, liqeni) II 19, љопа (lora), пеља (pela), деље (dele) II 34; пуља (pula) II 35, љикура (likura < lëkura) II 37 etj.

Shkronja [л] në përgjithësi shënon fonemën /ll/, si te fjalët троли (trolli) II 34, бал (ball ballë) II 38, славјан (sllavjan, sllav) II 41; анадол (Anadoll, Turqi) II 41, коломбоћ (kollomboq, misër) II 53, машкул (mashkull) II 9 etj.

Kemi vërejtur dy raste ku kjo shkronjë shënon /dh/-në shqipe: ултар (ulltar udhtar < udhëtar) II 75 dhe ул (ull < udhë) II 144, por edhe ulltar (ulltar < udhëtar) I 56; ulla, uda (ulla, uda < udha) I 18 për arsye se Pulevski nuk e ka pasur në bazën e vet nujëtimore ndërthemboren e zëshme /dh/; si dhe /l/-në në fjalën лелек (lelek < lejlek) I 45.

Grafemat <л, лл> për shkrimin e shqipes i kanë përdorur edhe disa autorë të tjerë, si Pjetër Bogdani në veprën “Çeta e profetëve”, Rainholdi në “Netë Pellazgjike”, Theodor Kavalioti, Dhaniel Naхhiu e Dhimitër Kamarda.<sup>46</sup> Dyshkronjeshen <лл> e vërejmë vetëm në Fjalorin katërgjuhësh, me të cilën autori ka shënuar /ll/-në, si молла (molla), кумбулла (kumbulla) I 46, сонгилль (songill < thëngjill) I 38, штиилль (shtiill < shtyllë) I 38, турбулл (turbull) I 17, муллия (mullija < mullini, mulliri) I 18, ветулла (vetulla) I 21, даллга (dallga) I 16, ћерпалла (qerpalla < qepalla) I 21, полломба (pollomba < pëllëmba) I 24, филль (fill fyell) I 57, каллнорь (kallnor, janar) I 25 etj.

<sup>46</sup> Dr. Petro Janura, *Nga Historia e alfabetit të gjuhës shqipe*, Shkup, 1969, f. 15-16.

### Shkronjat <м, н, њ>

Shkronja e parë në këta fjalorë pasqyron dybuzoren hundore /m/, e dyta /n/-në dhe e treta /nj/-në. Këto përdoren me përpikëri dhe nuk ka luhajtje e as shmangie nga shënimi i fonemave përkatëse. P.sh. земра (zemra) II 14, манастир (manastir) II 64, памбук (pambuk) II 64, маљесија (malësija, malësia) II 65, мбас (mbas) II 66, ерсима (ersima < errësira) II 69, шум (shum < shumë) II 70, smundem (s'mundem) II 73, муји (muji, muaji) II 81, марс (mars) II 81; нук (nuk) II 14, вендин (vendin) II 65, јан (jan < janë) II 67, на (na, ne) II 71, шиконте (shikonte) II 77; доњи (donji < ndonjë) II 3, њи (nji < një) II 20, њераз (njeraz < njerëz) II 35, њофе (njofe < njihe) II 5, кишњен (kishnen, kishit) II 48, нањи (nanji < ndonji < ndonjë) II 127, њом (njom < i njomë) њери (njerii, njeri) II 140 etj.

### Shkronja <п>

Nuk patëm ndonjë problem në leximin e fjalëve me këtë shkronjë, ngase këtë edhe sot e ka alfabeti cirilik dhe ka shërbyer në fjalorët për të cilët po bëjmë fjalë për shënimin e dybuzores së shurdhët /p/, si: Шкипиниј (Shkipinij < Shqipëri) II 64, перенди (perëndi) II 5, I 12; по (po) II 6, апо (apo) II 7, пор (por) II 50, па (pa) II 53, паша (pasha) II 109, прифт (prift) II 109, прсе (prse përse) II 113, шпирти (shpirti) I 13, II 113; пун (pun punë) I 11, пошта (poshta posta) I 11, пруга (prua < përrua) I 16 etj.

### Shkronja <р>

Grafema <р> në të dy fjalorët përdoret për shënimin e bashkëtingëllores sonante dridhëse /r/. Meqë e folmja shqipe e Dibrës, po edhe gjuhët sllave nuk e kanë fonemën /rr/ mund të gjykojmë se kjo shkronjë përdoret nergut për /r/-në. Ja disa shembuj: корба (korba < korbi) I 44, кумри (kumri, pëllumb) I 44, лепур (lepur) I 47, грош (grosh) I 49, врима (vrima) I 49, букур (bukur < i bukur) II 137, кур (kur) II 135, мир (mir < mirë) II 132 etj. Po sjellim edhe disa fjalë me këtë shkronjë, por të cilat sipas normës drejtshkrimore e drejtshqiptimore të shqipes së sotme standarde duhej të ishin me fonemën /rr/: шара (shara < sharra) I 57, чере (çere < qerre) I 57, бур (bur < burrë) I 71, бар (bar < barrë) I 89, рена (rena < rrena) I 81, зјар (zjar < zjarr) II 26, сор (sor < sorrë) I 44, ар (ar < arrë) I 47, руш (rush < rrush) II 64, прала (pralla < përralla) I 59 etj.

### Shkronja <с>

Kjo shkronjë Pulevskit i ka shërbyer për ta regjistruar /s/-në dhe ndërthemboren e zëshme /dh/ të shqipes. P.sh. rosa (rosa) I 44, беса (besa) II 14 etj., ndërsa /th/-në në fjalët суа (thua) I 22, у суи (u thy) I 36, сат (that < i thatë) I 38, дрис (drith) I 49; сонгилл (thëngjill) I 38, II 26; сарт (thart < i thartë) I 39, секњ (thekën) I 49, њис (gjith < gjithë) I 37, 82; вдасун (vdathun, zbathur) I 42 etj. Kemi parë dy raste kur fonema /th/ është shënuar me bigramet <ст> dhe <дс>: њист (gjith < gjithë) I 82 dhe дсан (than < thanë) I 46.

## Shkronja <т>

Shkronja <т> ka dy funksione:

a) shënon fonemën /t/ të shqipes së fjalorëve të Pulevskit, si në fjalët трупа (trupa) II 15, 86; пует (puet < pyet) II 15, сахат (sahat, orë) II 83, дит (dit) II 83, вјет (vjjet) II 84, мрети (mreti < mbreti) II 84, ашту (ashtu) II 84, те (te) II 87 etj., dhe

b) shënon fonemën /th/: те цита (të xhitha < të gjitha) II 13, тире (thire < thirre) II 50, тошин (thoshin) II 146, кртиза (krthiza < kërthiza) I 22; тес, тесат (thes, thesat, thasët) I 49, ктеим (ktheim < kthejmë) II 17, рет (reth < rrjedh) II 19 etj.

## Shkronjat <ф, х>

Shkronja e parë shënon /f/-në, ndërsa e dyta /h/-në. Po japim disa fjalë me <ф>: фич (fiç < fiq < fik) I 46, фрор (fror) II 82, фтохт (ftoht) II 23, фара (fara) II 32, фолмат (folmat < të folmet) II 3, форте (fortë < i fortë) II 10, кафе (kafe) II 33, нофула (nofulla) II 118, дифтому (diftomu < diftom mua, më dëfto, më trego) II 10 etj.

Fonema /h/, siç thamë edhe më parë, nuk bën pjesë në inventarin fonematik të të folmes shqipe të Dibrës, mirëpo Pulevski e shënon këtë fonemë në të dy fjalorët me shkronjën <x>, si p.sh.: духет (duhet) II 10, 27, 28, 30, 91, 94; џуха (gjuha) II 20, захметъ (zahmet) I 14, фтохт (ftoht) I 15, II 28; ханат (hanat < hanet) I 18, крахат (krahāt < krahët) I 21, у хоћ (u hoq) I 64, мендоху (mendohu) I 79, џунахъ (gjunah < gjunah) I 81 etj.

Përdorimi i fonemës /h/ në dy fjalorët për të cilët po bëjmë fjalë mund të shpjegohet me faktin se autori ka qenë njohës edhe i turqishtes, gjuhë ku ruhet mjaft mirë kjo fonemë me një frymëtim mjaft të fuqishëm dhe me përdorim të dendur. Kështu që edhe pse e folmja shqipe e Dibrës nuk e shqipton këtë tingull, edhe pse në maqedonishte ka përdorim të rrallë dhe me frymëtim të dobët që mezi dëgjohej ose shpeshherë nuk dëgjohej fare.

Fonema /h/ shënohet me të njëjtën grafemë <x> edhe te Pjetër Bogdani, Lekë Matrënga, Gavril Dara – Gjyshi (Plaku), Jul Variboba, Jeronim de Rada, Rainholdi etj.<sup>47</sup>

## Shkronjat <ц, ч>

Shkronja e alfabetit cirilik <ц> në këta fjalorë ka shënuar pa asnjë përjashtim afrikaten majegjuhore /c/, si në fjalët гац (gac < gacë) I 38, цяпъ (сјар) I 41, цона (сора) II 58, цонацон (сорасорë) II 66, маца (маса < масја) II 90, циљи (cili) II 90, копуц (корус < këpusë) II 93 etj.

Germa <ч> shënon afrikaten majegjuhore të shurdhët /ç/: фич (fiç < fiq < fik) I 46, чаји (çaji) II 32, че кач (çe kaç < qe kaq < ja kaq) II 48, чоин (çoin < çojnë) II 56, те пача (të paça) II 95, чипш (çish < çysh, si) II 12 etj. Autori nuk e dallon mirë mesgjuhoren /q/ nga afrikatja /ç/, prandaj edhe në shkrim vërehet kjo përzierje. Bie fjala, ai të njëjtën fjalë e shënon njëherë me njëren bashkëtingëllore e herën e dytë me bashkëtingëlloren tjetër, si џафа dhe чафа (qafa dhe çafa) I 21, фаће dhe фаче (faqe dhe façe) I 21; пор чеп (çep për qepë) I 50 e ndonjë rast tjetër të afrikatizimit të mesgjuhore /q/ në /ç/.

<sup>47</sup> Dr. Petro Janura, *Nga Historia e alfabetit të gjuhës shqipe*, Shkup, 1969, f. 15-19.

## Shkronjat <ш, ђ>

Shkronja <ш> edhe në paralelen shqipe të fjalorëve të Pulevskit ka po të njëjtën vlerë fonematike si edhe në alvfabetin cirilik, pra shënon /sh/-në, si шкaлл (shkall < shkallë) I 34; дашъ, дешъ (dash, desh) I 41, душкъ (dushk) I 46, шкилъе (shkile) I 66, шкои (shkoj) I 66, шкиништ (shkinisht, sllavisht) II 3, куш (kush) II 3, ашт (asht) II 5, таш (tash), шкон (shkon) II 12; шум (shu:m < shumë) II 14, шећер (sheqer) II 33, шкип (shkip < shqip) II 67 etj.

Grafema e alfabetit të greqishtes <θ> edhe në fjalorët shënon /th/-në. P.sh.: θa (tha) II 3, 6, 8, 146; θιθ (xhith < gjithë) II 3, 13, 14; θерун (therun) I 71, θоште (thoshte) II 8, θошин (thoshin) II 40, дритθ (drith) II 22, 30; θаш (thash) II 58 etj.

Shkronja <θ> është përdorur me vlerë të /th/-së edhe në alfabetin e Nikollë Ketës, Gavrill Darës – Plakut, Jul Varibobës, Jeronim de Radës, Dhimitër Kamardës, Rainholdit, Thimi Mitkos etj.

Gjatë punës sonë në tiparet grafike të fjalorëve të Pulevskit kemi hetuar dy shembuj kur për fonemën /th/ është shkruar dyshkronjëshi /θс/: θсана (thana) I 46 dhe θсикар (thikar “njeri që merret me punimin e thikave”) I 55.

## Shkronjat <ћ, ђ, џ>

Grafemat <ћ> dhe <ђ> i hasim në alfabetin e Vuk Karagjiqit si dhe në “Mesharin” e Gjon Buzukut” (1555) etj.<sup>48</sup> Shkronja <ћ> regjistron bashkëtingëlloren qiellzore /q/, si p.sh. колломбоћ (kollomboq, misër) I 16, спанаћ (spanaq < spinaq) I 50, ћели (qelli < qielli) II 9, дућан (duqan) I 18, кућ (kuq) I 20, мустећи (musteqi < mustaqja) I 21, ћора (qora < qorra, të verbër) I 22, ћелће (qelqe) I 34, леће (leqe) I 41, већили (veqili) I 54, леће (leqe) I 41, ћелћеди (qelqexhi) I 55, шћепон (shqeron < shqeroon < shqiponjë) II 35 etj.

Shkronja <ђ> ka vlerën e /gj/-së. Ja disa shembuj: ђат (gjat < i gjatë) II 23, ђит (gjit, çka)<sup>49</sup> II 37, ђитθ (gjith < gjithë) II 30, сунђер (sungjer, sfungjer) I 60, шенђерђе (Shëngjergjë, Shëngjergj) I 13, ђуђи (gjugji < gjyqi) I 19, арђенди (argjendi) I 31, зођа (zogja, zogi) II 9 etj.

Edhe këtu kemi përzierje të mesgjuhores /gj/ me afrikaten /xh/, si ђашт (xhasht < gjashtë) I 26, ђердани (gjerdani < xherdani) I 32; зимс, џимс, ђисм (zims, xims, gjism < gjysmë) I 36 etj.

Shkronja <џ>, siç u pa edhe në disa shembuj të mëparmë, shënon bashkëtingëlloren /xh/, si p.sh. џепате (xhepatë, xhepat) I 29, џал (xhall gjallë) II 9, хамиит (xhami:t) I 18, џеваир (xhevair xhevahir) I 20, пенџере (penxhere, dritare) I 34, миџ (mixh mixhë) I 64 etj. Siç mund të vërehet, këtë shkronjë e hasim më shpesh te fjalët e huazuara orientale. Në sistemin konsonantik të të folmes maqedonase të Galiçnikut mungon kjo fonemë, ajo është këmbyer me disa fonema të tjera.<sup>50</sup> Këtu qëndron arsyeja e përzierjes së shënimit grafik të <џ>-së me disa të tjera, si me fonemat /gj, z, zh/, si p.sh. џете (xhete < gjete) dhe ђете (gjete) I 34, џалура krahas жалура

<sup>48</sup> Eqrem Çabej, “Meshari” i Gjon Buzukut (1555) – pjesa I dhe II, Tiranë, 1968, f. 47.

<sup>49</sup> Në të folmen e fshatrave Brezë dhe të Malinë, që gjenden në Karadakun e Shkupit për përemrin pyetës çka përdoret fjala gjit e afrikatizuar në formën fonetike xhit, ndërsa për diçka përdorin fjalën e përngjitur dixhit, që është përemër i pacaktuar. Shih: Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit* (punim doktorati në dorëshkrim), Shkup, 1999, f. 179.

<sup>50</sup> Блаже Конески, *ver. e cit.*, f. 219.



(xhallura, zhallura për gjallesa, frymorë) II 34, циндет (xhindet për gjendet) II 79, царпун (xharpun për gjarpër) II 35, минцес (minxhes për mëngjes) II 82 e ndonjë fjalë tjetër.

### 3.3. PASQYRË E GRAFISË SË FJALORËVE TË PULEVSKIT KRAHASUAR ME ALFABETIN E SOTËM TË SHQIPES

Edhe gjatë përpunimit të sistemit grafik të tekstit shqip të të dy fjalorëve të Pulevskit i kemi krahasuar grafemat që na dalin këtu me shkronjat e alfabetit të gjuhës shqipe. Mirëpo për të përfutur një ide sa më të qartë të alfabetit të Pulevskit, po japim edhe një pasqyrë që dëfton vlerën kryesore fonematike të shkronjave, duke shënuar majtas shkronjat e alfabetit të sotëm të shqipes e djathtas shkronjat e përdorura në fjalorët në shqyrtim:

Abëcëja e shqipes	Alfabeti i Pulevskit	Shembuj
<b>a</b>	а	вла, влаа, авул, машкул, кока, калаа,
<b>b</b>	б	барка, барна, букур, брум, бјешка, мбас
<b>c</b>	ц	цопа, гац, маца, циљи, цонаџоп, копуц
<b>ç</b>	ч	чаји, че кач, чепъ, те пача, чиш
<b>d</b>	д	дита, дега, перенди, дии, дамъ, вдесин
	д	еде, и мад, у збард, у дерд, ден, верд, уда
	ј	ји
	л	ул, ултар
	лл	улла, уллтар
	е	пела, деле, беса, рее, тетъ, леш
	ѣ	нѣсеръ, мѣс
	-	з-м-р, з-м-рат
	е	катеръ, ка веше, аште
	ь	катъръ, вогълъ, мьзь, с'ьштъ, кьмбъ
	ъ	ьштъ, кьпуцатъ
	-	т-и, з-м-р, вог-лъ, к-та, м-нџес, данд-р
<b>f</b>	ф	фара, фрор, фтохт, фич, нофула
<b>g</b>	г	гуръ, гропа, гомари, гаць, груа
<b>gj</b>	ђ	ђат, џашт, џиџ, џит, џуђи
<b>h</b>	х	ханат, фтохт, духет, џуха, у хођ
	и	мишин, кии, шии, миир, зотнии, дети
	ы	дылли бые, фаы, ны, сыи, сыт, џумшты
<b>j</b>	ј	јан, јет, маји, уји, вјети, бије, кусија
	я	вия, зона, гоя, яка, фяли, мялти, бия
	ѣ	бринѣ, џунѣт
<b>je</b>	ѣ	мѣкра, вѣра, пѣшт, пѣргулл, нѣрс

<sup>51</sup> Alfabeti i shqipes është plotësisht fonematik, d.m.th. një tingull = një shkronjë të thjeshtë ose të përbërë. Rrjedhimisht, grafemat <ja, je, ju> nuk janë pjesë e alfabetit të shqipes, por ato i ka përdorur Pulevski në tekstet e tij. Shkronjat rrokjesore të Fjalorit trigjuhësh të Pulevskit <ja, je, ju> në Fjalorin katërgjuhësh korrespondojnë me shkronjat po kështu rrokjesore të alfabetit të sotëm të rusishtes <я, ю, ы>, të cilat lexohen kështu: <я> = [ja], <ю> = [ju], <ы> = [ji] ose [i].

<b>ju</b>	ю	юве, пьютете, јю, јюве, фјютуръ
<b>k</b>	к	кам, нук, кафе, кур, калнор, ка
	љ	љуље, фолџим, љуми, љопа, пеља, деље
	л	лелек
	л	бал, троли, Анадол, славјан, коломбоћ
	лл	ветулла, молла, каллнор, даллга
<b>m</b>	м	мбас, муји, манастир, земра, шум
<b>n</b>	н	нук, на, натан, вендин, јан, анза
	њ	њи, њом, њофе, њери, доњи, нањи
	ня	дуня, зоня, няни, куняа
<b>o</b>	о	ода, зот, нофула, пошта, вдор, мос бон
<b>p</b>	п	перенди, пор, па, апо, паша, пруга, прсе
<b>q</b>	ћ	ћелћеци, дућан, ћора, шећер, шћепон
<b>r</b>	р	кур, мир, лепуръ, грош, корба, кумри
<b>s</b>	с	соръ, беса, роса, прсе
<b>sh</b>	ш	шкаллъ, дашъ, деш, душк, шкиле, шкип
<b>t</b>	т	трупа, пует, сахат, дит, труп, те мрети
	Ѡ	Ѡаш, Ѡон, Ѡоште, дриѠ
	т	тире, тошин, тесат, рет, цита, тес, ктес
	с	суа, дрисъ, сартъ, ћисъ, мбасуръ, сатъ
<b>u</b>	у	дул, пруга, фуш, унда, гуша, кумбулла
<b>v</b>	в	венди, вера, ви, вдор, ветулла, јава
<b>xh</b>	Ѡ	Ѡал, Ѡепат, Ѡамиит, миѠъ, Ѡеваир
γ <sup>52</sup>	уи	дуи, друи, суи, дуимадијет, дуизет
<b>z</b>	з	зине, забель, збразе, брез, шкозъ
<b>zh</b>	ж	жаба, жив, аждер

<sup>52</sup> <γ> grafemë që shënon një [y] më pak buzore se [y]-ja e rëndomtë e mbarë shqipes. Nga struktura grafike e Pulevskit mungon grafema që do ta shënonte fonemën /x/ të shqipes.

#### 4. DUKURITË FONOLOGJIKE E FONETIKE

##### TË SHQIPES SË PULEVSKIT

Veçoritë fonologjike e fonetike të tekstit shqip të fjalorëve të Pulevskit i kemi nxjerrë nga forma e shkruar e shqipes, edhe pse kjo rrugë është mjaft e vështirë dhe e pasigurt, që nuk garanton edhe saktësi të madhe, sepse kemi të bëjmë me grafema e jo me tinguj të nyjetuar. Pra, duhet të nisemi nga shkrimi e të supozojmë se çfarë tingulli themelor apo foneme përfaqëson ajo shkronjë me të gjitha veçoritë akustike e fiziologjike dhe pastaj të nxjerrim ndonjë rregull për veçoritë fonetike e fonologjike. Ndryshe do të ishte puna kur për burim do të kishim ligjërimin njerëzor në formën e folur. Sido që të jetë, mendojmë se do të jetë me interes gjuhësor përpjekja jonë që t'i shënojmë disa nga veçoritë fonetike e fonologjike për tekstin e shkruar në gjuhën shqipe në dy fjalorët e Pulevskit.<sup>53</sup>

1. *Dallimi fonologjik i gjatësisë së zanoreve.* - Dihet se në të folmet e gegërishtes fonetikiqisht dallohen tri gjatësi zanore: të shkurtra, të mesme dhe të gjata. Mirëpo, fonologjikiqisht dallohen dy gjatësi, të cilat janë në kundërvënien midis tyre.<sup>54</sup>

Në veprat e shkrimtarëve të vjetër shqiptarë të shekullit XVI - XVIII zanoret e gjata janë shënuar me dyzimin e shkronjave të njëjta.<sup>55</sup> Gjorgji Pulevski në tekstin shqip të të dy Fjalorëve e shënon edhe gjatësinë e zanoreve. Zanoret e shkurtra dhe të mesmet i regjistron vetëm me një shkronjë, ndërsa të gjatat, marrë në tërësi, me dyzimin e po të njëjtave shkronja.<sup>56</sup> P. sh.: zanore të mesme e të shkurtra, si poshta "posta", dita I 13; ara I 16, veni "vendi" I 17, furka I 32, ajo II 3, jemi II 10 etj.; zanore të gjata, si vllaa "vëlla" I 63, kalaa "kala" I 17, avaa "hava" II 63, zotnii "zotëri" I 53, siit "sitë", kush doo "kush do" I 33, puntoor "punëtor" I 55, punoo "puno" I 65, tuu "tu" II 58, msuur "mësuar" I 58, kuu "ku" II 78, dhii "dhi" II 70 etj.

Nganjëherë, në këto tekste takim dy zanore të njëjta vërejmë edhe në fjalët ku bie laringalja [h]: poushqeen (< po ushqehen) II 65, preer (< përherë) II 149, shkreen (< shkrehen) II 27, saati (< sahati) II 71 etj. Sipas të gjitha gjasave, këto zanore janë shqiptuar jo si një zanore e vetme e gjatë, por si dy zanore të njëjta të njëpasnjëshme dykulmore.

2. *Inventar fonemash pa zanore hundore.* – Përgjithësisht është pranuar se areali i gegërishtes në inventarin fonematik, përveç zanoreve gojore, ka edhe zanore

---

<sup>53</sup> Asllan Hamiti, *Disa veçori fonetike e fonologjike të tekstit shqip të fjalorëve të Gjorgji Pulevskit*, Shqyrtime albanologjike 6, Shkup, 2000, f. 161-176.

<sup>54</sup> Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1975, f. 61-69; Tiranë, 1998; *Dialektet e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1989 etj. Bahri Beci, *Të folmet veriperëndimore të shqipes dhe sistemi fonetik i së folmes së Shkodrës*, Tiranë, 1995, f. 179 -187, 232; Rexhep Ismajli, *Rreth kuantitetit të zanoreve të theksuara të shqipes*, në Artikuj mbi gjuhën shqipe, Prishtinë, 1987, f. 193-200, etj.

<sup>55</sup> Shaban Demiraj, *Fonologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1996, f. 52.

<sup>56</sup> Zanoret e gjata shënohen me shkronja të dyfishuara edhe te Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani, Matrënga, Serembe etj.

hundore.<sup>57</sup> Shkalla e hundorësisë së zanoreve është më e madhe në veri dhe duke shkuar më nga jugu në shtrirjen territoriale të shqiptarëve, kjo shkallë e hundorësisë zvogëlohet. Është hetuar gjithashtu se disa të folme gege nuk kanë fonema zanore hundore, si e folmja e Dibrës, e Preshevës, e Ulqinit, e Prilepit dhe Krushevës<sup>58</sup> etj. Rrjedhimisht, Pulevski në të folmen shqipe të Dibrës nuk ka dëgjuar shqiptim të ndër-hundshëm të zanoreve,<sup>59</sup> andaj as që përdor ndonjë shenjë grafike për ta shënuar hundorësinë e zanoreve.

Duke u mbështetur në kundërvëniet me vlerë fonologjike të shkallës së gjatësisë së fonemave zanore (të shkurtra ~ të gjata), pa serinë e fonemave hundore (nga se nuk i ka), mund të pohojmë se shqipja e Fjalorëve të Pulevskit në rrokje të theksuar ka gjithsej 12 fonema zanore: /a/, /a:/, /u/, /u:/, /e/, /e:/, /o/, /o:/, /i/, /i:/, /ɣ/<sup>60</sup> dhe /ë/, nga të cilat:

**6 fonema zanore të shkurtra:**

/a/

/e/

/u/

/o/

/i/

/ë/

**6 fonema zanore të gjata:**

/a:/

/e:/

/u:/

/o/

/i:/



/ɣ:/

<sup>57</sup> Imri Badallaj, *Nazalizimi i zanoreve si veçori qenësore e dialektit gegë*, Zëri i arbëreshëve nr. 10, Janinë, 1977.

<sup>58</sup> Mustafa Ibrahim, *Disa dukuri fonetike në të folmen shqipe të Prilepit dhe Krushevës*, Shqyrtime albanologjike 6, Shkup, 2000, f. 151-160.

<sup>59</sup> Naim Basha, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 143 - 144.

<sup>60</sup> Zanore e përparme, e mbyllur, që është më pak e buzorëzuar se varianti themelor i [y]-së së rëndomtë.




Siç shihet nga inventari i dhënë i fonemave zanore, në fjalorët shumëgjuhësh të Pulevskit /ë/-ja edhe si tingull edhe si fonemë del vetëm si e shkurtër, pra nuk e ka ekuivalenten e saj të gjatë. Këtu mungon edhe fonema /y/ e mirëfilltë, sepse është zhbuzorëzuar në /i/ dhe është humbur kundërvënia /y/ ~ /i/. Kështu ndodh edhe në shumicën e të folmeve të gegërishtes qendrore, kuptohet se edhe në të folmen e Dibërës dhe qarkut të saj, në të folmen e Kërçovës, të Gostivarit, të Tetovës, të Shkupit, Kumanovës, të Lumës, Lurës, Peshkopisë, Krujës, Matit, Mirditës etj.

E folmja e Rekës së Epërme, disa të folme të qarkut të Kërçovës, të Prilepit etj., megjithëse me një denduri të vogël përdorimi, megjithatë mund të thuhet se ruajnë një [Y] me një shkallë më të vogël buzorëzimi sesa /y/-ja e mbarë shqipes. Sido që të jetë, shqipja e fjalorëve të Pulevskit shfaqet me /y/ të zhbuzorëzuar në /i/, përveç disa rasteve të pakta ku kemi një /y/ më pak labiale se e rëndomta, të cilën do ta shënojmë me /Y/. Te një grup fjalësh, /y/-ja e theksuar përveç që ka kaluar në /i/, ajo pastaj ka evoluar edhe më tej dhe sipas rrethanave fonetike është diftonguar në [ëi], si *fyell* > *fy:ll* > *fi:ll* > *fëill* I 57. Autori i fjalorëve këtë [Y] më pak të buzorëzuar e shënon me dyfishimin e shkronjave <ui> (<уи>), si *ду* (dY) I 27, II 112; *думадужеу* (dYmadhijet) I 26, II 125; *дрyu* (drY) I 34, *cyu* I (sY) 83, *буук* (bYk) I 32, *y фpyu* (u frY) I 36, *y θyu* (u thY) I 36 etj.

Kundërvënia fonologjike e këtyre dy fonemave të përparme, të mbyllura, njërës të pabuzorëzuar dhe tjetrës të buzorëzuar /i/ ~ /y/ mund të hetohet në disa çifte minimale fjalësh, si *bik* (dem) ~ *bYk* (byku), *di* (djem) ~ *dY* (vajza), *ni* (një) ~ *nY* (nyje) etj. I 27, II 112;

Analiza e tekstit shqip të këtyre Fjalorëve na nxori 26 fonema bashkëtingëllore. Në krahasim me shqipen standarde, këtu mungojnë paragjuhorja afrikate e zhurmët [x]<sup>61</sup>, sonorja shumëdridhëse [rr] dhe laringalja [h].



I

3. **Zanorja [ë].** – Siç dihet, në të folmet e gegërishtes [ë]-ja është e paqëndrueshme: ajo nuk përdoret asnjëherë në rrokje të theksuar dhe nuk bën pjesë në inventarin e fonemave zanore, d.m.th. në të folmet geqe ka statusin e tingullit, por jo edhe të fonemës. Në gjendjen e sotme në rrokje të patheksuar ka kufizime në përndarjen e saj: asnjëherë nuk përdoret as në rrokje nistore të fjalës e as në rrokje fundore të fjalës, por edhe në mes të fjalës shpeshherë nuk nyjëtohet. Përgjithësisht, në mbarë gegërishten [ë]-ja fundore ka rënë në këta dy-tre shekujt e fundit, duke shkaktuar një kompensim në zgjatjen e zanores paraprijëse. Mirëpo, te shkrimi i shqipes në fjalorët për të cilët po bëjmë fjalë jemi të mendimit se ekzistojnë pak shembuj të ruajtjes së kësaj zanoreje edhe në pozitë fundore. Ky mendim mund të arsyetohet nëse paraprakisht pranojmë që me shkronjën <e> në fundin e disa fjalëve Pulevski ka shënuar [ë]-në.

<sup>61</sup> Fonemën /x/ nuk e ka as e folmja maqedonase e Galiçnikut (qarku i Dibrës). Shih: Bllazhe Koneski, *Makedonskiot XIX vek*, Jaziçni i knizhevno-istoriski prilozhi, Shkup, 1986, f. 219.

E folmja e Dibrës, për dallim nga shumica e të folmeve të tjera të gegërishtes, [ë]-në e ruan edhe sot relativisht mirë. <Ë>-në e shënon edhe Josif Bageri,<sup>62</sup> bashkëvendës i Pulevskit. Megjithëse e kemi mjaft vështirë ta identifikojmë [ë]-në shqipe në tekstet e fjalorëve në shqyrtim, morëm guximin të shkruajmë për disa raste më karakteristike të përndarjes së kësaj zanoreje. Tradita e shkrimit të shqipes na bën me dije se shumica e shkrimtarëve në letrat e tyre përpiqen të shkruajnë në një gjuhë mbikrahinore e mbidialektore, e cila është më e përgjithësuar dhe e kuptueshme për të gjithë shqiptarët. Këtë rrugë të trasuar nga shumë Rilindës tanë e ndoqi edhe Gjergj Pula. Analiza grafike e tekstit shqip të Pulevskit justifikon mendimin se aty /ë/-ja përdoret edhe në rrokje të theksuar edhe në rrokje të patheksuar:

a) /Ë/-ja në rrokje të theksuar: mëz I 40, këmb(ë) I 22, 24; dhëmb I 22, shkëmb I 34 etj.

b) [Ë]-ja në pozitë fundore: është II ose ashtë I 15, 65, 96; II 91, 160, 161; mixhë I 64, punë I 11, të hollë I 31, derdhë I 46, cucë II 161, perëndojë II 71, arë (< arrë) I 47, farë II 67, ngrohtë II 67 etj.

c) Në pozitë parafundore, përkatësisht në rrokje të mbyllur nga bashkëtingëlloret sonore /r, l, ll, m, n, j, nj/, si në fjalët: dhandër II 133, katër I 26, 27, 28, 29; çadër I 58, e vjetër I 71, pastër I 25, frashër I 46, breshër II 88, vlezër I 63, metër I 57, egër II 36, i vogël I 36, tambël I 33; folëm I 84, rafëm (< rrafëm) I 58, ditën I 15, thekën I 49, gjarpën I 51, dolën I 10, dimën I 25, shitën I 87, rënj (< rrënjë) I 45 etj.

ç) Në disa raste të tjera, si në fjalët: kokës I 48, mëngjes I 19, perëndi I 12, II 5; afëroje II 144, malësia II 65, gëzum I 52, pupëz I 144, prëpjet (< përpjetë) I 17, përfundi I 38, gështenj I 47, prëcille (< përcille) I 16, kësula I 29; këthiza, pishmanllëk I 13, mëndafsh I 31 etj.

4. *Buzorëzimi i zanores [ë] në [o]*. – Te Pulevski vërejtëm këto raste buzorëzimi të [ë] > [o]: numor (< numër) I 9, pollomba (< pëllëmba) I 24, thongjill (< thëngjill) I 38, kopucar (< këpucar) I 55, fomei (< fëmijë) II 155, tono (< tonë) II 70 e 74 dhe ndonjë rast tjetër.

5. *Buzorëzimi i [a]-së hundore të mbarë gegërishtes në [o]*. – Buzorëzimi, si dukuri fonetike e këmbimit të një zanoreje të pabuzorëzuar me një tjetër të buzorëzuar shkallësh të ndryshme, hetohet në shqipen e fjalorëve në shqyrtim, dukuri mjaft e përhapur në të folmet e gegërishtes, veçmas në grupin verilindor të të folmeve.<sup>63</sup> Në fjalët si nona < nana, bojet < bahet II 87, hona < hana, bone < bane etj. [a]-ja hundore, dikur e mbarë gegërishtes, buzorëzohet aq shumë sa që në fjalorët e Pulevskit është shndërruar plotësisht në zanoren e buzorëzuar [o]. Edhe në të folmen shqipe të Kërçovës, që për disa veçori bashkëpërkon me shqipen e fjalorëve të Pulevskit, kjo dukuri është mjaft e shpeshtë, si rona < rana “rëra”; Ason < Hasan, hongra < hangra

<sup>62</sup> Shaqir Berani, *Gjuha e Josif Bagerit*, Prishtinë, 1988, f. 50.

<sup>63</sup> Imri Badallaj, *Disa veçori fonetike të së folmes së Zhurit*, Gjurmime albanologjike V-1975, Prishtinë, 1976; *Fenomene fonetike në të folmen e Hasit*, Gjurmime albanologjike (Seria e shkencave shoqërore) nr. 16, Prishtinë, 1986; *E folmja e Hasit* (disertacion doktorate në dorëshkrim, mbrojtur në Universitetin e Prishtinës, më 1986) etj.



“hëngra”, lom < la:m “lëmë”; dhom < dha:m “dhëmb”; ko:m < ka:m “këmbë”; e modhe < e madhe, jaron < jaran etj.

6. **Qiellzorëzimi i [ë]-së në [i]**. – Zanoren gjysmë të hapur të radhës së mesme [ë] në rrokje të patheksuar në disa raste e gjejmë të qiellzorëzuar në [i], si në fjalët xhimon (< gjëmon) I 34, likura (< lëkura) I 45, II 90; shindosh (< shëndosh) I 75, shindet (< shëndet) I 75, II 79; Shin Dimitri (< Shën Dimitri, Dhimitri) II 98, lishuar (< lëshuar) I 9, një (< një) II 37, ni (< një) II 85, shembulli i fundit bashkë me përngjashmim të [nj]-së në [n].

7. **Rënia e [ë]-së para sonoreve [r, l, ll, m, n, nj]**. – Përpos rasteve (që shënuam) të ruajtjes së zanores [ë] para bashkëtingëlloreve tingëluese, mjaft e shpeshtë është dukuria e rënies së kësaj zanoreje në pozitë para sonanteve. Kjo rënie e [ë]-së së patheksuar, që e kemi konstatuar nga mosshënimi i asnjë shkronje për këtë zanore, sipas gjithë gjasash është ndikim i traditës së shkrimit në gjuhët sllave, ku tingëlueset në mungesë të ndonjë zanoreje tjetër në fjalë janë rrokjeformuese. Pra, rënia e [ë]-së del mjaft e qartë në shembujt: krtollat (< kërtollat, patatet) II 66, prse (< përse) II 3, II 95; bakr (< bakër) I 19, II 27; krp (< kërp, li) I 31, pr (< për) II 6, egr (< egër, i egër) I 46, prmi (< përmi, përmbi) II 5, II 75; tambl (< tambël) I 23; aml (< amël, i ambël) I 39, mngjes (< mëngjes) I 39, natn (< natën) II 5, ditn (< ditën) II 6, 7; femn (< femën) II 9, rnja (< rënja < rrënja) II 24 etj.

8. **Diftongimi dytësor i zanoreve të theksuara [i] dhe [u]**. – Shpërbërja e [i]-së dhe e [u]-së së theksuar në paralelen shqipe të fjalorëve të Pulevskit është dukuri fonetike mjaft e shpeshtë, që është karakteristik për tërë krahinën e principatës së Kastriotëve, përkatësisht grupin e të folmeve të gegërishtes qendrore.<sup>64</sup> [I]-ja në fjalorët në shqyrtim rëndom diftongohet në [ëi], ndërsa [u]-ja në [ou]. Ja disa shembuj diftongimi të [i]-së së theksuar: tëi < ti, mëir < mirë, prëill < prill II 81; fomëi < fëmijë, jabanxhëi < jabanxhi, i huaj, i panjohur, trëi < tri II 84; sëi < si < sy II 70, 76, 78, 80, 81, 84. Megjithkëtë, ka edhe shembuj kur [i]-ja edhe pse është në rrokje të theksuar të fjalës, nuk e gjejmë të shpërbërë. Këtë e kemi vërejtur në faqet 65, 66, 67, 71 etj. të Fjalorit trigjuhësh. Ndoshta mund të ketë edhe ndonjë rast tjetër të diftongimit dytësor të [i]-së së theksuar në variantin [ai], por ne e kemi parë vetëm një rast të tillë: miqsaia (< miqësia).

[I]-ja e theksuar diftongohet në [ëi], si fëis < fis, trëim < trim, të rëi < të ri etj. në të folmen e qarkut të Zajazit të Kërçovës; ndërsa në [ei], shumë rrallë edhe në [oi] në të folmen e rrethit të Sërbicës së Kërçovës, si veiq < viç, feis < fis etj.

[U]-ja e theksuar në pjesën dërrmuese në tekstin shqip të Pulevskit është diftonguar në [ou]. Ky diftong mbizotëron sidomos te foljet dhe te emrat, por vërehet edhe te mbiemrat, ndajfoljet dhe te pjesët e tjera të ligjëratës. P.sh.: dërgoum (< dërgu:m, dërguem) II 98, baroum (< baru:m < mbaruem) II 99, pajtoum (< pajtu:m < pajtuem) II 100, shkroum (< shkru:m < shkruem) II 101, 105, 110; besoum (< besu:m <

<sup>64</sup> Bahri Beci, *Të folmet qendrore të gegërishtes*, Dialektologjia shqiptare V, Tiranë, 1987; Remzi Nesimi, *Diftongimi i i-së dhe i u-së së theksuar në të folmen e Dervenit*, Çështje gjuhësore, Shkup, 1997, f. 85-87; Haki Ymeri, *E folmja shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997; Fehim Reçani, *Të folmet shqipe të Pollogut*, Shkup, 2001; Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit* (punim doktrate në dorëshkrim), Shkup, 1999 etj.

besuem) II 109, martoum (< martu:m < martuem) I 70, gëzoum (< gëzu:m < gëzuem) I 77, mësoum (< mësu:m < mësuem) II 152, laroum (< laru:m < laruem) II 152 etj. Në shembujt e saposhënuar, së pari ka vepruar monoftongimi i togut zanor [ue] në [u:] të gjatë e të theksuar, e më pas kjo e fundit ka pësuar diftongim dytësor në [ou]. Pra, te këto fjalë kemi proceset fonetike [ue] > [u:] > [ou].

Në të folmen shqipe të Kërçovës [u]-ja e theksuar shpërbëhet në dy variante diftongjesh dytësore [ou] në qarkun e Sërbicës dhe [au] në qarkun e Zajazit, si katoun (Sërbicë), kataun (Zajaz) < katund, nouse (Sërbicë), nause (Zajaz) < nuse etj. Në tërë qarkun e Kërçovës [y]-ja e theksuar shpërbëhet në [oy]: shtoyp < shty:p “shtypë”, kroy < kry: “(është) kryer, ka përfunduar”, froy < fry: “frye” etj.

9. **Monoftongimi i grupzanorshit [ue] ose [ua] në [u:].** – Grupi vokalik [ue] është monoftonguar në [u:] të gjatë dhe si i tillë në pak raste është ruajtur në Fjalorët e Pulevskit, si du:l (< doli) I 15, II 70; bu:ll (< buell, buall) I 41, kapru:ll (< kapruell) I 47, shkru:r (< shkruar) I 61, besu: (< besue, besuar) I 68, i kullu:m (< i kulluem, i kulluar) I 90 etj. Këto janë raste të rralla ku [u]-ja e theksuar i ka përballuar risisë diftonguese.

10. **Prania jo e vogël e togut zanor [ua].** – Togun vokalik [ua] e kemi hasur në disa fjalë në shqipen e fjalorëve të Pulevskit, si grua I 70, gëzuar I 70, prua (< përrua) I 16, II 70; shtruar, prvluar (< përvëluar), gatuar I 40, axhinuar (< agjëruar) I 13, msua (< mësuar) I 59, shkuar I 56, thua I 22, pajtuar I 55 etj.

Siç po shihet edhe nga paragrafët 8, 9 dhe 10 për sa i përket grupeve të zanoreve, monoftongimit të tyre dhe diftongimit dytësor, shqipja e fjalorëve të Gjergjit është e larmishme. Aty gjejmë togjet zanore [ue] e [ua], të ruajtur ose të monoftonguar në [u:] të gjatë, shpeshherë të diftonguar në [ou]. E paraqitur në mënyrë skematike,<sup>65</sup> ky zhvillim duket kështu:

→ [ua]  
 Grupi i vjetër vokalik [ou]-[uo]  
 → [ue] → [u:] → [ou]

11. **Ka forma të rotacizuara.** – Krahas formave të fjalëve me [n] ndërzanore, kur dihet se fjalorët janë shkruar në dialektin e gegërishtes: pruna I 68, i pasun I 69, xhilpan I 88, barna II 6 etj., ka edhe një numër të konsiderueshëm fjalësh në formë të rotacizuar, si bie fjala: egërsira II 9, ature (atyre) II 13, 15; i varfër, vllazër II 67, verë (pije), diturija I 59, I 88; breshër II 88, si dhe në pjesoret toske shitur I 88, shtrirë I 72, shkurtuar, çiruar I 72; mbledhur, zbuluar, grisur I 71, gëzuar I 59, shitur I 88 etj.

Forma të rotacizuara sipas studimeve dialektore ndeshen edhe në disa të folme gege, si në të folmen e Plavës dhe Gucisë,<sup>66</sup> të Kelmendit, të Kastratit, të Hotit, të Shkrelit, të Bregut të Matës<sup>67</sup> si dhe në të folmen shqipe të Peshterit.<sup>68</sup> Mirëpo,

<sup>65</sup> Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore III*, Prishtinë, 1987, f. 123.

<sup>66</sup> Mehmet Ahmetaj, *Fenomenet fonetike në të folmen shqipe të Plavës dhe Gucisë*, Gjurmime albanologjike (SShF) 15-1985, Prishtinë, 1986, f. 243.

<sup>67</sup> Gjivalin Shkurtaç, *E folmja e Kelmendit*, Dialektologjia shqiptare II, Tiranë, 1975, f. 38.

mendohet se te trajtat e fjalëve me [r] ndërzanore kemi të bëjmë me dukurinë e shpërngjashmimit të [n]-së së dytë, pra [n] - [n] = [n] - [r] e jo me rotacizmin, i cili është një ndër veçoritë karakteristike të dialektit jugor të shqipes.

Fjalët me [r] ndërzanore, ashtu siç i gjejmë në fjalorët e Pulevskit, janë thjesht forma të rotacizuara të toskërishtes, e jo forma të përfutuara nga disimilimi i [n]-së në [r].

12. **Zhbuzorëzimi i [y]-së në [i].** – Zanorja e përparme e mbyllur [y] në të shumtën e rasteve është zhbuzorëzuar në [i]: tlin < tëlin < tëlien < tëlyen I 39, brim < brymë, fill < fyell I 57 etj.

13. **Shpërbërja dytësore e [y]-së në [ëi] dhe rrallëherë në [ei].** – Te një numër i konsiderueshëm fjalësh [y]-ja e theksuar, përveç që është zhbuzorëzuar në [i], ajo pastaj ka evoluar edhe më tej dhe, sipas rrethanave fonetike, është diftonguar në [ëi]: fëit < fit < fyt, frëim < frim < frymë, sëi < si < sy etj.

Gjatë punës sonë, në dy Fjalorët e Pulevskit kemi gjetur dy shembuj ku në vend të [y]-së është përdorur një [e] e hapur, e cila për nga shqiptimi duhet të jetë më e hapur se [e]-ja e rëndomtë, si frem (frymë) II 86 dhe fren (fryn < fryen) II 86. Kjo [e] e hapur duhet të jetë rezultat i monoftongimit të diftongut [ei], ku kemi këtë proces: frymë > frim freim > frem; fryen > frin > frein > fren.

14. **Shndërrimi i [y]-së në [u].** – [Y]-ja e mbarë shqipes në fjalorët e Pulevskit në pak raste ka evoluar në [u], si te shut < shyt I 42, çush < çysh II 71, kruqa < kryqa II 73, nrushe < ndryshe II 72 e në ndonjë fjalë tjetër.

15. **Përdorimi i një [y]-je më pak buzore se e rëndomta.** – Përveç shumë zhvillimeve të larmishme që ka pësuar zanorja [y] në shqipen e shkruar të fjalorëve të Pulevskit, na ra në sy edhe përdorimi i një [y]-je më pak buzore se ajo e rëndomta, të cilën e ndeshim të shkruar me kombinimin e shkronjave <ui>, ne do ta shënojmë me [Y]. Në shqipen e këtyre fjalorëve kjo [Y] është përdorur në nëntë raste: dY I 27, II 112; dYmadhijet I 26, II 125; drY I 34, sY I 83, bYk I 32, u frY I 36, u thY I 36 e ndoshta edhe në ndonjë fjalë tjetër që na ka shpëtuar. Edhe e folmja shqipe e Kërçovës e ka fonemën /y/, ndërsa e folmja shqipe e Dibërës këtë e ka zhbuzorëzuar në /i/.

16. **Përdorimi i grupit [vo] në fillim të fjalës.** – Në fjalorët e Pulës e kemi hasur grupin [vo] në fillim të fjalëve, që është karakteristik për dialektin verior të shqipes, në fjalët votra I 35, voji I 51 etj. Në faqen 19 të Fjalorit katërgjuhësh në mënyrë të njëpasnjëshme e gjejmë të shkruar të njëjtën fjalë në dy variante, me grupin [vo] si dhe ne ghrupin [va]: vor (< vorr) dhe var (< varr).

17. **Togzanori [ie] është monoftonguar në [i:].** – Për ta përdëftuar këtë dukuri fonetike po mjaftohemi të sjellim dy shembuj të shënuar nga dy herë: dilli (< dielli) I 91 dhe II 70; çilli (< qielli) I faqe 11 dhe faqe 14.

18. **Afrikatizimi i qiellzoreve [q, gj] në [ç, xh].** – Në punimet dialektologjike është diskutuar mjaft për çiftet e bashkëtingëlloreve mesgjuhore mbylltore e ato paragjuhore afrikate. Përgjithësisht është konstatuar se pjesa më e madhe e të folmeve

---

<sup>68</sup> Latif Mulaku – Mehdi Bardhi, *Mbi të folmen shqipe të Peshterit*, Gjurmime albanologjike (SShF) II-1972, Prishtinë, 1974, f. 104.

të gegërishtes priren që mesgjuhoret t'i nyjëtojnë si më të përparme, aq sa disa edhe plotësisht i afrikatizojnë. Me këtë shqiptim më të përparmë është humbur opozicioni fonologjik /q/ ~ /ç/ e /gj/ ~ /xh/, përkatësisht është bërë defonologjizimi i tyre në të folmet e Kosovës,<sup>69</sup> të Matit,<sup>70</sup> të Lumës,<sup>71</sup> të Shkupit,<sup>72</sup> të Tetovës,<sup>73</sup> të Kërçovës,<sup>74</sup> të Dibrës<sup>75</sup> etj. Përgjithësisht, e folmja e Zajazit të Kërçovës i afrikatizon mesgjuhoret, ndërsa e folmja e Sërbicës i shqipton ato si mesgjuhore.

Sipas gjendjes faktike, fjalorët e Pulevskit karakterizohen me praninë e dy çifteve bashkëtingëlloresh: bashkëtingëllore qiellzore ~ bashkëtingëllore afrikate, por shpeshherë dallimi i tyre nuk del i qartë, d.m.th. bëhet përzierja e tyre në të shkruar. Ja disa shembuj kur qiellzoret janë përdorur me vend: spanaq (spinaq), qelli (qielli), qelqe, sheqer, arfjendi, kollomboq, i gjat(ë), zogja (zogj), gjasht(ë) I 26, 27, 28; qind I 28, qumsht (qumësht) I 39, gjunj I 54; shqepon, shqYpe (shqiponjë, shqipe) I 45, teneqe I 20, qelqexhi I 35 etj. Por, hasen fjalë kur në vend të bashkëtingëllores qiellzore është shkruar afrikatja gjegjëse, si në shembujt xhindet (gjendet), mënxhes (mëngjes), e xhete (e gjete), xharpun (gjarpër) etj.

Shkrimi i dyzuar i këtyre çifteve të bashkëtingëlloreve mund të shihet qartas në shembujt, si faqe dhe façe I 21, çafa dhe qafa I 21, qelb – çelb I 40, qelli – çilli I 14, qen – çen I 48, qime – çime I 21, qera – çere (qerre) I 57, çethun – qethur I 41; e gjëra – ma xhan I 36, xhims – gjism I 36, gjiz – xhiz I 39 etj. Nuk përjashtohet mundësia e përpjekjes së Gjergjit që të paraqesë fjalët e shkruara në dy variante (me <q> dhe me <ç>, ose me <gj> dhe <xh>) nga se qysh në shekullin XIX në gegërishte ka filluar të hetohet një luhatje në përdorimin e këtyre çifteve të bashkëtingëlloreve.

19. **Humbja e kundërvënies fonologjike e fonemave /r/ ~ /rr/.** – Në të folmen e Dibrës si dhe në shqipen e fjalorëve të Pulevskit nga sistemi bashkëtingëllor është zhdukur shumëdridhësja /rr/ dhe vendin e saj e ka zënë dridhësja simotër /r/ në të gjitha pozicionet e fjalës, si p.sh. shara (<sharra), bur(ë) (<burrë), rena (<rrena), sor (<sorrë), çar (<çarr) I 46, rush (<rrush), ar (<arrë), fur (<furrë) II 32, bar (<barrë) II 96 etj.

20. **Ruajtja e grupeve të bashkëtingëlloreve [mb], [nd], [ng] me pak përjashtime.** – Përgjithësisht, mund të themi se në tekstin shqip të fjalorëve të Pulevskit grupet e bashkëtingëlloreve [mb, nd, ng] janë ruajtur të papërngjashmuara. Ja disa shembuj ku këto grupe ruhen të plota: mbas, mbushim, shkamb, rumbullak, mbete, mbare (<mbarre), mbrenda, mbjell; vendi, tunde, mund; nga, ngusht, kanga etj.

<sup>69</sup> Imri Badallaj, *E folmja e Hasit* (punim doktorate në dorëshkrim), Prishtinë, 1986; Dr. Idriz Ajeti, *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovcit*, Kërkime gjuhësore, Prishtinë, 1978, f. 192.

<sup>70</sup> A. V. Desnickaja, *Gjuha shqipe dhe dialektet e saj*, Prishtinë, 1972, f. 134.

<sup>71</sup> Shefqet Hoxha, *E folmja e Vilë e Kalisit të Lumës*, Dialektologjia shqiptare III, Tiranë, 1975, f. 237.

<sup>72</sup> Haki Ymeri, *E folmja e shqipe e Karshiakës*, Shkup, 1997; Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit* (punim doktorate në dorëshkrim), Shkup, 1999.

<sup>73</sup> Remzi Nesimi, *E folmja e Dervenit* (punim doktorate në dorëshkrim), Prishtinë, 1988; Fehim Reçani, *Të folmet shqipe të Pollogut*, Shkup, 2001.

<sup>74</sup> Qemal Murati, *E folmja shqipe e rrethit të Tuhinit të Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 18.

<sup>75</sup> Naim Basha, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 163.

Megjithatë, jo gjithnjë këto grupe na dalin të tilla, por ndonjëherë i gjejmë të përngjashmuara (asimiluara), si veni (< vendi) , ka sa (< nga sa), donji sen (< ndonjë send), mret (< mbret) etj. Ka raste të shpeshta kur i gjejmë të shënuara njëhën pas tjetrës dy variante fonetike të të njëjtës fjalë, edhe me grup bashkëtingëllor të ruajtur edhe me grup të asimiluar, si p.sh. në faqen 37 të Fjalorit katërgjuhësh kemi mbushe dhe mushe.

21. **Përdorimi i rrallë i mesgjuhores [j]**. – Bashkëtingëllorja mesgjuhore sonante shtegore [j] në shqipen e dy fjalorëve për të cilët jemi duke bërë fjalë përdoret mjaft rrallë, krahasuar me dendurinë e përdorimit të rëndomtë në gjuhën e sotme shqipe, po edhe me dendurinë relativisht të madhe të saj në të folmet shqipe. Ajo te Pulevski ka kufizime të mëdha në përndarje. Ne vërejtëm disa raste të tilla:

a) mospërdorimi i [j]-së epentike për të zhdukur hiatin, si në fjalët kroë (kroje), kallai (< kallaji), mui (< muji < muaji), mai (< maji), ui (< uji) e në shumë fjalë të tjera;

b) këmbimi [j] > [i] në fund të fjalës: dui (< duj, duaj), andei (< andej), pastai (< pastaj), shkoim (< shkojmë), thoin (< thojn < thojnë, thonë) etj. Këtë dukuri të ndërkëmbimit të [j]-së dhe [i]-së e vëren edhe prof. Bllazhe Koneski për maqedonishten e fjalorëve të Pulevskit dhe konstaton se kjo është veçori e të folmeve të maqedonishtes.<sup>76</sup>

22. **Grupet e vjetra konsonantike [kl], [gl] kanë evoluar në [q] e [gj]**. – Në të folmen e Dibrës, në të folmen e Krujës e të Malësisë së saj, të Matit, të Mirditës, të Lurës, të folmet e Kurveleshit, të Kërçovës, të Dervenit, të folmet shqipe të Karshiakës, të Karadakut të Shkupit etj. grupet e vjetra bashkëtingëllore [kl, gl] përmes qiellzorëzimit kanë përfunduar në qiellzore të mirëfillta [q] e [gj]. Këtë zhvillim fonetik e hasim edhe te fjalorët e Pulevskit. Krahaso shembullin [kl] > [q]: qumsht (< klumësht) II 34, 137 etj. Grupi i vjetër konsonantik [gl] në të shumtën e rasteve është qiellzorëzuar në [gj], si në fjalët gjuha (gluha) II 20, i gjat (i glatë) II 23, 37 etj. Ndërkaq, përdorimi mjaft i shpeshtë i fjalës gjuhë në formën g-juha (giuha) mund të trajtohet si formë më e vjetër ndërkaluase nga grupi [gl] në [gj]. Pra, kemi pasur [gl] [g-j] [gj], ku [g-j] është formë ndërmjetësuese e dy të tjerave, sepse nga grupi bashkëtingëllor i përbërë nga një prapagjuhore dhe një paragjuhore, ka kaluar në grupin prapagjuhore-mesgjuhore, që në fund të jetë shkrirë në një mesgjuhore të vetme.

23. **Grupet e bashkëtingëlloreve [pl, bl, fl] janë paraqitur në variante të ndryshme**. – Grupin e parë konsonantik e gjejmë të shënuar në dy forma: [pl] dhe [pj], si plumb II 27 dhe pjumb II 26, plak II 11 etj. Mirëpo, në disa raste, krahas ruajtjes së tij, grupi [pl] ka evoluar në qiellzore të mirëfilltë [q], si plep dhe qep I 46.

Grupi [bl] në fjalorët e Gjergjit del si [bj]: bjen (< blen) II 55, bjet (< bletë) I 52 etj. Edhe [fl]-ja në fjalorët në vështrim ka dhënë [fj], si fjaron (< fluturon) II 8, 34; fjori (< flori) II 26, 28, 57, 59, 61; fjok (< flokë) II 37, fjak (< flakë) II 21 etj.

24. **Qiellzorëzimi i grupeve [tj] > [q] dhe [dj] > [gj]**. – Si në shumë të folme të gegërishtes, ashtu edhe në fjalorët e Gjorgji Pulevskit grupi bashkëtingëllor [tj] ka kaluar në qiellzoren [q]. Këtë dukuri të palatalizimit të këtij grupi e vërejmë në fjalët qeter (< tjetër) II 8, 61; aqe (< atje) II 17, 18; qer (< të tjerë) II 52, qerat (< të tjerat) II 7

<sup>76</sup> Bllazhe Koneski, *Makedonskiot XIX vek*, ..., f. 214.

etj. Grupi [dj] është qiellzorëzuar në [gj], si në fjalët gjeg (< djegë) II 31, gjegun (< djegun, djegur) I 31, gjers (< djersë) I 24, gje (< dje) I 84, pargje (< pardje) I 84, gjers (< djersë) I 24, gjep (< djep) I 32, II 86 etj. [Q]-ja e [gj]-ja që janë përfutur nga grupet [tj, dj] në shqipen e fjalorëve të Pulevskit, si edhe në shumicën e të folmeve të gegërishtes qendrore, sidomos në të folmen e Dibrës e të Kërçovës, që përbëjnë bazën dialektore të shqipes së fjalorëve në shqyrtim, nuk afrikatizohen në [ç, xh].

25. *Qiellzorëzimi i [g]-së në [gj] në disa raste*. – Bashkëtingëllorja prapagjuhore mbylltore e zëshme [g] sipas fjalorëve në shqyrtim, në të shumtën e rasteve përdoret si e tillë, mirëpo në disa fjalë këtë e gjejmë të qiellzorëzuar në [gj], si p.sh. gjusht (< gusht) I 25, II 81; legjen (< legen) I 33, gjur (< gurë) I 35, magjar (< magar, gomar) I 40 etj. Dukuria e këtillë është njëra ndër katër inovacionet fonetike të gegërishtes qendrore.<sup>77</sup> Palatalizimi në pak raste hetohet edhe te kalimi i [k]-së fundore të emrit në [q], si shoq (për shok).

26. *Shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në pozitë fundore*. – Në rrokje të mbyllur fundore, që konsiderohet si pozicion i dobët fonetik i fjalës, bashkëtingëlloret e zëshme në shqipen e shkruar të fjalorëve në spikamë këmbehen me korrespondueset e tyre të shurdhëta, përkatësisht desonorizohen duke u këmbyer [b] > [p], [d] > [t], [g] > [k], [z] > [s], [dh] > [th]. Dukuria e tillë e shurdhimit të bashkëtingëlloreve të zëshme kur gjenden në pozitë fundore absolute të fjalës është tipike për të folmet e toskërishtes, por e ndeshim edhe në ndonjë të folme të gegërishtes, si në të folmen shqipe të Plavës e Gucisë (në Mal të Zi)<sup>78</sup>, në të folmen e Kërçovës<sup>79</sup> etj. Sipas prof. Shaban Demirajt, kjo kundërvënie fonetike fundore e pazëshme - fundore e zëshme e temës është zhvilluar edhe në të folmet e gegërishtes jugore.<sup>80</sup> Edhe në gjuhën maqedonase (dialektore si dhe në ligjërimin letrar të të folurit) desonorizimi është dukuri e rregullt.

Në tekstin shqip të Pulevskit dukurinë e shurdhimit të bashkëtingëlloreve fundore e hasëm në shumë fjalë, si çelp (< qelb) II 130, elp (< elb) I 49; sent (< send) II 8, çint (< qind) I 97, fllat (< fllad) II 23; zok (< zog) I 44, shtok (< shtog) I 46, lark (< larg) II 17; pras (< praz) I 50; reth (< rrjedh) etj. Na ra në sy edhe një humbje e zëshmërisë së [b]-së në grupin [mb] > [mp] te fjala mpretenija (< mbretëria) II 154 edhe kur gjendet në rrokje të parë të fjalës.

Pulevski shurdhimin nuk e paraqet me përpikëri. Kështu, në Fjalorin katërgjuhësh në f. 53 e gjejmë të shënuar fjalën beg / bek me dy variante: bashkëtingëllore e zëshme – bashkëtingëllore e shurdhët. Po kështu, në të njëjtin fjalor në faqen 139 në pozitë parafundore është ruajtur zëshmëria e bashkëtingëllores (po tundë), ndërsa në pozitë fundore te e njëjta fjalë [d]-ja është shurdhuar në [t]: po tunt. Ka edhe raste kur [d]-ja dhe [t]-ja gjenden në të njëjtin pozicion, në pozicion parafundor dhe e njëjta fjalë shënohet edhe me <d> edhe me <t>, si tonte dhe tonde II

<sup>77</sup> Bahri Beci, *Mbi katër inovacionet fonetike të të folmeve të Gegënisë së Mesme*, Konferenca e Parë e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 1965.

<sup>78</sup> Mehmet Ahmetaj, *Fenomenet fonetike në të folmen shqipe të Plavës dhe Gucisë*, Gjurmime albanologjike (SShF) 15-1985, Prishtinë, 1986, f. 236.

<sup>79</sup> Lulzim Aliu, *Gjuha në disa këngë të moçme kërçovare* (punim magjistrature në dorëshkrim), Shkup, 2005.

<sup>80</sup> Shaban Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 150-151.

140. Humbja e zëshmërisë në pozitë jofundore dëshmohet edhe në fjalën ventli (vendli, vendali, vendas, anas).

27. *Rënia e bashkëtingëllores glotale shtegore të shurdhët [h]*. – Kjo bashkëtingëllore në tekstet për të cilat po bëjmë fjalë në të shumtën e rasteve ka rënë në të gjitha pozitat, si në fillim, në mes dhe në fund. Edhe në të folmet e maqedonishtes kjo bashkëtingëllore ka prirje të mos shqiptohet fare ose ndonjëherë nyjëtohet me një frymëtim shumë të dobët që mezi dëgjohet. Ja disa shembuj të rënies së [h]-së nga fjalorët e Pulevskit: i (< hi), ambar (< hambar), e umbi (< e humbi), aje (< haje), e oll (< e hollë), ëna (< hëna), e aroi (e harroi), ije (< hije), ipa (< hipa), a (< ha); bear (< behar), Ori (< Ohri), ataer (< atëherë) etj.

Rënia e [h]-së konsiderohet si dukuri fonetike karakteristike e toskërishtes,<sup>81</sup> por që mund të hetohet edhe në disa të folme të gegërishtes qendrore, rrallë edhe në të folmet verilindore, si në të folmen e Zhurit të Prizrenit.<sup>82</sup>

28. *Ruajtja e grupit bashkëtingëllor [fsh]*. – Në dy fjalorët e Gjergj Pulës grupi konsonantik [fsh], ashtu siç e paraqet autori në pjesën shqipe të fjalorëve, është ruajtur i papërngjashmuar, i plotë. Këtë e kemi vërejtur te fjalët: të çofsha I 77, shkofsha I 85, rafsh (< rrafsh) I 16, mëndafsh I 31 etj.

29. *Shndërrimi [th] > [f]*. – Ndërdhëmborja [th] është këmbyer me buzore-dhëmboren [f] në fjalët: fell (< thell) I 36, I 86, II 91; oftull (< uthull) II 93 (në shembullin e fundit, përveç këtij alternimi, kemi edhe epentezë dhe disimilim). Kjo dukuri fonetike është e përhapur edhe në të folmen e Kërçovës.

30. *Këmbimi [f] > [v]*. – Në disa raste buzore-dhëmborja e pazëshme [f] është alternuar me korresponduesen e saj të zëshme [v]. P.sh.: vrik (< frik, shpejt) I 14, vshat (< fshat) I 17, gëzovar (< gëzofar) I 55, çvar (< çfarë) II 11, çevj (< çejf) II 32 (te fjala e fundit ka edhe metatezë).

31. *Zëvendësimi [h] > [f]*. – Në tekstin shqip të fjalorëve të Pulevskit nuk mungojnë shembujt e këmbimit të glotales [h] me buzore-dhëmboren [f], si në fjalët ftoft (< ftoht) I 90, njof (< njoh) dhe në fjalët e tjera të formuara prej tyre.

32. *Metateza*. – Kjo dukuri fonetike, e ndërrimit të tingujve ose të rrokjeve brenda fjalës, në shqipen e fjalorëve të Pulevskit është e shpeshtë. Siç dihet, ndërndërrimi i vendeve të tingujve ndeshet më së shumti në stilin bisedor e në të folmet popullore. Në fjalorët për të cilët po bëjmë fjalë, kjo dukuri është aq më e shpeshtë me faktin se autori i fjalorëve zotëronte mjaft mirë disa gjuhë sllave, gjuhë në të cilat ndërrimi i tingujve në të njëjtën fjalë është shumë i shpeshtë. Megjithkëtë, edhe shqipfolësi në mënyrë të pavetëdijshme e shqipton fjalën metatetike ose për shkaqe lehtësimi fiziologjik ose pse e ka trashëguar fjalën si të tillë nga prindërit e vet dhe rrethi ku jeton, në të cilën është e pranishme fjala përkatëse metatetike.<sup>83</sup> Po sjellim disa nga fjalët metatetike të Pulevskit: krëpesh (< kërpes) I 93, grëshan (< gërshan,

<sup>81</sup> Anastas Dodi, *Fonetika e gjuhës së sotme shqipe*, Prishtinë, 1970, f. 45.

<sup>82</sup> Imri Badallaj, *Disa veçori fonetike të së folmes së Zhurit të Prizrenit*, Gjurmime albanologjike V, 1975, Prishtinë, 1976, f. 65.

<sup>83</sup> Mehmet Halimi, *Vëzhgime mbi të folmen e Moravës së Poshtme*, Kërkime dialektologjike, Prishtinë, 1985, f. 273.

gërshërë) I 93, bedergos (< bretkosë) I 51, thojëm (< thojmë, themi) II 5, bajën (< bajnë, bëjnë) II 7, xhims (< gjysmë) I 36, prë (< për) etj.

33. **Përngjashmimi.** – Dukuria e përngjashmimit të tingujve është e shpeshtë në tekstin shqip të fjalorëve të Pulevskit. Vërehet asimilimi i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve, por më i shpeshtë është përngjashmimi i zanoreve, sidomos asimilimi i plotë në largësi. Kështu, kemi vranat (< vranët) I 15, çarapat (< çorapet) I 30, druguz (< drugëz) I 32, kollos (< kullosë) II 99 etj. Ruajtja e grupeve konsonantike [mb, nd, ng] e karakterizojnë shqipen e fjalorëve të Pulevskit, por hasen edhe raste të asimilimit të tyre, nënkuptohet në pak raste. P.sh.: mret (< mbret), krim (< krimb) I 51, garendi (< ngarendi, vrapoj) I 43, pram (< mbram, mbrëmë), veni (< vendi) I 62, granme (< ngranme, ushqim) I 15 e ndonjë rast tjetër.

34. **Përngjitja.** – Dukuria e përngjitjes ka një përhapje të madhe në shqipen e fjalorëve në shqyrtim. Për ta përdëftuar këtë dukuri gjuhësore, po sjellim këtu vetëm disa shembuj të aglutinuar: ekabarove (< e ka mbaruar) II 6, diftomu (< diftom mua, dëftom mua, mua më dëfto), nedi (< nëse e di) II 48, popretauruet (< po për t'i ruajtur) II 50, matemadh (< ma të madh, më të madh) II 11, ipamartoum (< i pa martuem, i pamartuar) I 70, venekuror (< ven, vë kurorë) I 64, mosufrik (< mos u frik, mos u friko) I 80, damimadh (< dam i madh, dëm i madh) I 82, poçillojm (< po e qëllojmë, po e shikojmë) II 75, aikurëqeshen (< ai kur qeshet) I 61, ipapasun (< i pa pasun) I 69 e shumë fjalë të tjera të përngjitura.

35. **Shtimi i tingujve.** – Në tekstin shqip për të cilin po bëjmë fjalë ka një numër fjalësh me tinguj ose fonema të shtuara, të shprehura nëpërmjet grafemave. Kemi hetuar shtimin e tingujve në fillim të fjalës, në mes dhe në fund të fjalës.

a) **Proteza.** – Me tinguj protetikë na dalin fjalët: Jevropa (Evropa) I 75, dita je meir (dita e mirë) I 75, juje (yje) II 70, vdorë (borë) II 70 etj.

b) **Epenteza.** - Shtimi i tingujve në mes të fjalës nuk është dukuri e shpeshtë në fjalorët në shqyrtim. Kemi hetuar dhe po shënojmë tre shembuj ku tingulli [v] është futur ndërmjet zanoresh në grupin vokalik [ua] si tingull antihijatizues: patkuva (< patkua) I 94, gruva (< grua) I 64 dhe ftuva (< ftua) I 46. Një rast i tillë është edhe fjala u xhikuva (< u gjykua) I 68. Këtu mund t'i sjellim edhe shembujt e vranan (< e vranë) I 73, bofni (< bani, boni, bëni) II 9, paradije (< pardje) I 84 dhe dije (< dje) I 84, në të cilët tinguj epentetikë janë [f]-ja dhe [i]-ja.

c) **Epenteza.** – Shtimi i tingujve në fund të fjalës nuk është dukuri e shpeshtë në të folmen e Dibrës. Te fjalorët e Gjorgji Pulevskit mund të hetohet ndonjë fjalë me tingull parazitator epentetik, si p.sh. rumbullakas (< rumbullak) I 17, s'mora vesht (< s'mora vesh), sotas (< sot) I 77, pemna (< pemë) II 6, ishten (< ishte) II 9 etj.

36. **Rënia e tingujve.** – Dukuria fonetike e rënies së tingujve në tekstin shqip të fjalorëve të Pulevskit është më e shpeshtë sesa shtimi i tingujve. Gjuha e këtij autori i përket stilit të bisedimit dialektor, por edhe ky stil nuk është paraqitur me besnikëri, sepse ai qe autodidakt dhe duket se nuk e ka njohur aq sa duhet strukturën e fjalëve të shqipes. Sipas vendit ku bie tingulli ose grupi i tingujve edhe këtu kemi aferezë, sinkopë dhe apokopë.



a) *Afereza*. – Rënia e tingujve në fillim të fjalës në fjalorët e Pulevskit është mjaft e shpeshtë. Një numër i konsiderueshëm fjalësh shënohen pa [h] nistore, si ambar (< hambar) I 33, ell (< hell) I 33, aje (< haje) I 87, ekur (< hekur) II 26 etj.; ose pa [j] nistore: eleku (< jeleku) I 29. Shembulli e eke (< e hjeke, e hoqe) I 68 dëshmon se ka raste kur bien dy tingujt e sapopërmendur. Ja edhe disa raste afereze: taljon (< italian) II 59, garend (< ngarendi) II 9, ishnja (< vishnja) I 47 etj. (fjala garendi mund të trajtohet edhe si shembull për asimilim, varësisht nga ajo se a është nyjëtuar bashkëtingëllorja [g] si e mirëfilltë apo me elemente në [n]-së.)

b) *Sinkopa*. – Forma fjalësh të sinkopuara kemi vërejtur shumë më tepër sesa raste të tjera të rënies së tingujve në fjalë. Kemi raste të shpeshta të rënies së zanoreve e të bashkëtingëlloreve në mes të fjalës, si pree (< preje) I 66, meshtri (< mjeshtri) I 59, marmag (< merimangë) I 52, ftere (< fultere) I 33, lelek (< lejlek) I 45, kroë (< kroje) II 16, mai (< maji) I 25, me fet (< me fjetë) I 70, kcolla (< kasolla) I 47, shru (< shkru:, shkruar) II 63, e djata (< e djathta), çillote (< qëllonte, shikonte) I 94, cla (< cila) II 17, u tet (< u tret) II 78, emin (< emnin, emrin) II 3, pse (< përse) II 5, driton (< drejtojnë) II 2, shumon (< shumohen) II 8, fjarojn (< fluturojnë) II 34. Fjalët ukan (< vullkan) II 20 dhe prcejn (< kapërcejnë) II 84 na dalin me aferezë dhe sinkopë.

Nga mosshënimi i zanores [ë], në fjalorët e shqipes së fjalorëve të Pulevskit ndeshen mjaft forma fjalësh të sinkopuara, si: mnxhes (< mëngjes), natn (< natën), rnja (< rrënja) II 24, prmi (< përmbi) II 5, pr (< për) II 6, ditn (< ditën), natn (< natën) II 6, bakr (< bakër) II 27, femn (< femën, femër) II 9, ert (< errët) II 5, dimn (< dimën) II 63 etj. Nga shembujt e dhënë, lehtë mund të konstatohet se autori në disa raste nuk e shënon [ë]-në para bashkëtingëlloreve tingëlluese [r, n, nj] ngase në gjuhët sllave rrokjeformuese përveç zanoreve janë edhe sonantet [r] e [l].

c) *Apokopa*. – Rënia e zanores [ë] në fund të fjalës, marrë në tërësi, është karakteristike e të folmeve të gegërishtes. Këtë dukuri e shpreh edhe Pulevski në shkrimin e shqipes së fjalorëve, me pak përjashtime. P.sh.: shum (< shumë) I 76, lir (< lirë) I 88, dijm (< dimë) II 3, fjal (< fjalë) II 125, tet (< tetë) I 26, mir (< mirë) I 76, miz (< mizë) I 52 etj. Veç këtyre fjalëve pa [ë] fundore, kemi vërejtur edhe disa raste të rënies së tingujve të tjerë fundorë, si a (< ah), drito (< drejtoj) I 33, gju (< gjuhë) II 115, greqish (< greqisht) II 112, te pjesëza e mohimit mos > mo I 65 etj.

## 5. TIPARET MORFOLOGJIKE

Derisa veçoritë grafike, fonetike e fonologjike i kemi shtjelluar më shtruar, tiparet morfologjike të paraleles shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit do të trajtohen më përmbledhtas.

Për këtë kapitull kemi hasur në vështirësi mjaft të mëdha, sepse siç del nga shkrimi i shqipes në fjalësit, Pulevski nuk e ka njohur mirë strukturën morfologjike të gjuhës shqipe. Zaten, mjaft vështirë e kemi pasur të nxjerrim ndonjë sistem formash dhe nga to mëpastaj të sjellim rregulla gramatikore të përdorimit të tyre. Gjendja na del e këtitillë nga arsyet e përmendura deri më tani. Një karakteristikë e përgjithshme e gjuhës shqipe të paraqitur në fjalorët nga autori në fjalë është konstatimi se ligjërimi shqip i Pulevskit është mjaft i ndikuar nga gjuhët sllave.

Format morfologjike të fjalëve në të dy fjalorët gjykojmë se nuk paraqesin ndonjë interes e as që kanë rëndësi të madhe për gramatikën e gjuhës shqipe, as për dialektologjinë historike të shqipes e as për historinë e gjuhës shqipe, përkatësisht për morfologjinë historike të shqipes. Kësaj mund t'i shtojmë edhe faktin se në përgjithësi veçoritë dalluese në rrafshin dialektor janë më të mëdha në fushën e fonetikës e të fonologjisë sesa në morfologji.

Për ta përdëftuar pohimin se Pulevski nuk ka zotëruar as njohuritë elementare teorike për morfologjinë as të shqipes e as të gjuhëve sllave, po e sjellim një tekst të transkriptuar të Fjalorit tregjuhësh nga faqja 125, ku autori bën fjalë për kategoritë gramatikore: *“Faqa jan na katr pjeç udan a) mashkum, femn, edhe medisis, edhe shumis... Çdo fjal ka: tre faqe, xhasht zan, edhe nand k-cemea, apo gjer dYmdhjet zgjatumea. E ato jan: a) vetat: mashkull, femën edhe medisis (asnjanëse – shënimi ynë), edhe shumis (shumës shënimi ynë); b) diftoshnjin (dëftore- shënimi ynë), c) tenumoroshnjin (numërues shënimi ynë), ç) faqes (vetat - shënimi ynë), d) prë na qeter ana, dh) porecitisë, e) bajenshnjin, ë) të sosshin (kohët e kryera të foljes- shënimi ynë), f) asbaishin (të pakryera - shënimi ynë), g) pastaisë (të ardhme - shënimi ynë), gj) prëthot, thiren (thirrore - shënimi ynë), h) cili u bojet nja (bashkuese) dhe i) andarojshnjin (të kujdesshme)“.*

Posa të mënjanoen gabimet e shumta e të rënda në format morfologjike të fjalëve shqipe, do të vërehet se baza morfologjike e gjuhës së tij është e folmja e vendlindjes, përkatësisht e folmja e Rekës së Dibrës.

## 5.1. EMRI

Në fjalorët e Pulevskit janë përdorur një sasi e madhe emrash. Vërehet përpjekja për përshtatjen e emrave vetjakë, varësisht nga gjuha në të cilën e shkruan po të njëjtin emër. Kështu, bie fjala, në ballinën e Fjalorit trigjuhësh, të shkruar në tri shtylla, në maqedonisht emrin e mbiemrin e vet e shkruan Gjorgji Pulevski, në shqip Gjorgji Pules, ndërsa në turqisht Gjorgji Puleoglu. Në brendinë e Fjalorit katërgjuhësh kemi:

sllavisht (maqedonisht) ose siç e emërton autori srpsko-albanski “serbishto-shqip”	shqip	turqisht
Spase Jovanovski	Spase Jovanisë	Spasoja Jovanoglu
Riste Kuzmanovski	Riste Kuzmanisë	Hristo Kuzmanoglu
Andon Trimovski	Andoni Trimës	Andon Trimoglu
Stojan Angjellovski	Stojani Angjellkos	Stojan Angjelkoglu
Koste Nikollovski	Kosta Nikollës	Kosta Nikolloglu
Jovan Popovski	Jovan Priftisë	Jovan Papazogluje
Vllkan Karaxhovski	Uko Karaxhisë	Eilen Karakurta

Siç mund të vërehet nga shembujt e mësipërm, varësisht nga gjuha në të cilën i shkroi, mbiemrave Pulevski u vuri mbaresa shqipe ose turke. Rëndom në turqisht *-oglu*, ndërsa në shqip mbiemrat i përdori në rasën gjinore pa nyjë të përparme, duke iu prapavënë mbaresat rasore *-isë*, *-ës*, *-os*. Disa emra vetjakë autori i ka përshtatur ose përkthyer, si p.sh. sllav. *Vllkan* (Vuk) – shq. *Uko* (Ujk) – turq. Eilen; sllav. *Popovski* – shq. *Priftisë* - turq. *Papazogluje* etj.

Është interesante dukuria e emërtimit të shteteve me mbaresën *-isë*, si p.sh. *Danisë* (Danimarka), *Frengisë* (Franca), *Bellgisë* (Belgjika), *Hollandisë* (Hollanda) etj., të cilat në gjuhën shqipe përdoren në rasën emërore, por që autori i jep në rasën gjinore pa nyjën e përparme *i* apo *e*, por që sipas trajtës përkojnë me rasën dhanore.<sup>84</sup>

Muajt e vitit i shënon kështu: *kallnor* ose *mui gjat* (për janar), *fror* ose *shkurt*, *mars*, *prëill* (për prill), *maj*, *qarshor* (për qershor), *korik* (për korrik), *gjusht* (për gusht), *muji te para* (për shtator), *muji i diti* (për tetor), *muji i treti* (për nëntor) dhe *shindreja* (për dhjetor). Siç po shihet, disa emra të mujave janë të njëjtë ose të ngjashëm me emërtesën e sotme të tyre (me disa ndryshime fonetiko-fonologjike), ndërsa disa fare nuk përkojnë me emërtimin e sotëm.

**Gjinia e emrit.** – Duke u mbështetur në gjuhën e fjalorëve në spikamë si dhe në punimet e botuara për të folmen e Dibrës ose për të folme të tjera të përafërta me të, kemi ardhur në përfundim se këtu i gjejmë vetëm dy gjini gramatikore të emrave:

<sup>84</sup> Shembujt e sjellë si dhe disa emra të tjerë Pulevski i regjistroi në faqen 59 të Fjalorit tregjuhësh.

mashkullore dhe femërore. Gjinia asnjëse është inkuadruar në dy gjinitë e tjera, më shpesh në gjininë mashkullore, si *mishi, gjathi, tlini, ujt, mjalti, brumi* etj.

Në mënyrë të parregullt Pulevski e bën mocionin, d.m.th. emrin femëror që emërton femrën e mashkullit, si *gomari ~ gomareja* I 40; ndërsa në mënyrë të rregullt *ari* (mashk.) ~ *arushë* (fem.) I 48, *qen ~ bushtër* I 48 etj. Ndonjëherë emrat që përgjithësisht në shqipen janë të gjinisë femërore, në shkrimet shqipe të Pulës i gjejmë të përdorura në gjininë mashkullore dhe anasjelltas, si p.sh. *Diti edhe nati ...* (Dita edhe nata...) II 6 etj.

**Numri i emrit.** – Emrat në shqipen e fjalorëve të Pulevskit na dalin në njëjës dhe në shumës. Shumësi i emrave, sidomos ai i gjinisë mashkullore, na del i shumëllojshëm. Do t'i vëmë në pah disa mënyra të formimit të shumësit të emrave, ashtu siç i gjejmë të shkruar në fjalorët për të cilët jemi duke bërë fjalë:

a) Shumë emra të gjinisë femërore që temën e rasës emërore të trajtës së pashquar njëjës e mbarojnë me zanoren *-ë* të patheksuar, këtë formë e ruajnë edhe në shumës. Kështu, numri i emrave të këtillë mund të hetohet vetëm në kontekst, si (një) *javë* – (disa) *javë*.

b) Mbaresa më e përhapur për të formuar shumësin e pashquar në këta fjalorë është mbaresa *-a*, të cilët në shumësin e trajtës së shquar marrin edhe mbaresën shquese *-t(ë)*: *qen – qena*, *lum – luma*, *dhandër – dhandr-a-t* II 133; *qelb – qelb-a-t* I 30, *pul-a-t* II 136, *buk-a-t* II 137, *qumsht-a-t* II 137, *dhëmb-a-t* I 22, *gur-a-t* I 19, *gisht-a-t* I 22, *zemër – zemra-t* II 152, *udh-a-t* II 144; *shkumb-a-t*, *pllug-a-t*, *dushk-a-t* II 132, *zog – zog-a-t* II 8, *peshk – peshk-a-t* II 95, *thes – thes-a-t* etj.

c) Është tipike formimi mjaft i shpeshtë i shumësit duke ia shtuar formës së njëjësit ndajfoljen e sasisë *shumë*, si p.sh. (njëjës) *pela* – (shumës) *pela shum*, *kal – kalë shum*, *udh – udh shum*, *kran* (krehër) – *kran shum*, *kopil – kopil shum* etj.

ç) Në të dy fjalorët e Pulevskit ka edhe forma shumësi të formuara me ndërrime morfonologjike, si me metafori: *dash ~ desh* I 41, me qiellzorëzim: *mik ~ miq* I 64; me qiellzorëzim dhe metafori: *ka ~ qe* II 129, me metafori dhe formantin e shumësit *-ër*: *vlla ~ vëllezër*; forma supletive *dele ~ dhen* I 41 etj.

**Shquarsia.** – Në shqipen e Pulevskit, përgjithësisht trajta e shquar e emrave formohet nga ajo e pashquara në dy mënyra: a) me mbaresa shquese (si edhe mbarë shqipja) dhe b) me mjete të tjera të jashtme, përkatësisht me fjalë përcaktuese.

a) Një numër i madh emrash trajtën e shquar edhe në këta fjalorë e formojnë duke ia bashkangjitur apo prapavendosur trajtës së pashquar të emrave mashkullorë mbaresat shquese *-i* ose *-u*, ndërsa mbaresën *-a* (ja) emrave të gjinisë femërore. P.sh.: *langua – langoi* I 48, *çelik-i* II 26, *ka-u* I 41, *dushk-u* I 46, *mi-u* I 47, 48; *elek-u* (jeleku) I 29, *kapak-u* I 37, *drishk-u* (dryshku) I 52, *borixhi-u* I 58, *dhe-u* I 62; *kësul-a* I 29, *gun-*

a, *kamish-a* (këmisha) I 29, *vorb-a* I 33, *lug-a* I 33, *mash-a* I 33, *kaci-ja* I 33, *der-a* I 34, *moll-a* I 46, *dardh-a* I 46 etj.<sup>85</sup>

b) Në shkrimet shqipe të Pulevskit shumë e shpesh të është mënyra e formimit të shquarsisë së emrave me anë të mjeteve të jashtme, në mënyrë analitike, pra me fjalë përcaktuese, si me përemra dëftorë: *ki* (< *ky*), *kjo*, *ai*, *ajo*; *ata*, *ato* etj. Kjo mënyrë e ndërtimit të shquarsisë përdoret mjaft dendur edhe në maqedonishte.

Në shqipen si dhe në maqedonishten nyja shquese është e prapavendosur.<sup>86</sup> Detyra që ta përcaktojë emrin si të njohur është funksioni i përgjithshëm i nyjës. Mirëpo, në maqedonishten me nyjën e prapavendosur përcaktohet edhe se sa afër apo larg gjendet folësi nga sendi i përcaktuar. Le të marrim një shembull: Ne në shqipen kemi vetëm një formë shquese me nyjë të prapavendosur, pa marrë parasysh largësinë e folësit nga sendi i përcaktuar: *libri* (i historisë që e kam në dorë), *libri* (i historisë që gjendet në dhomën tjetër) ose *libri* (i historisë që gjendet në librari); ndërsa në gjuhën maqedonase vendi i tij përcaktohet: *knigava* < *ovaa kniga* – *ky libër këtu*, *knigata* < *taa kniga* – *ai libër aty* ose *diku larg folësit*, *knigana* < *onaa kniga* – *ai libër atje*. Megjithë ekzistencën e tri formave përcaktuese hapësinore të sendeve, objekteve e frymorëve në gjuhën maqedonase, format me mbaresën shquese *-ta* (*knigata* “libri”) për gjininë femërore, *-ot* (*moliv-ot* “lapsi”) për gjininë mashkullore dhe *-to* (për gjërat e vogla dhe gjininë asnjësore: *pileto*, *gluvçeto*, *sitoto*, *koritoto* “zogu, miu, sita, korita”) janë përgjithësuar dhe përdoren shumë më shpesh se dy format e tjera. Mbaresat shquese në maqedonishten janë përfutur nga përemrat dëftorë *ovaa*, *taa*, *onaa*; *toj*, *taa*, *toa*, *ona* “*ky*, *kjo*, *ai*, *ajo*, *ajo*” etj. si *ovoj moliv* – *molivov* (*ky laps*); *toj moliv* – *molivot* (*ai laps*); *onoj moliv* – *molivon* (*ai laps atje*).

Pra, përveç me mbaresa shquese, nën ndikimin e maqedonishtes shumë shpesh në tekstin shqip të fjalorëve në fjalë me mjete të jashtme bëhet edhe përcaktimi hapësinor i sendeve edhe shquarsia. P.sh. *buk*, *kji buk*, *buka* (në paralelen *sllave le*, *lebov*, *lebovi*); *lug*, *kji lug*, *luga* (*sllav. llozhica*, *llozhicava*, *llozhici*) II 137; *çen*, *kji çen*, *çena*, *te çeni*, *te çenat* (*sllav. kuçe*, *kuçevo*, *kuçinja*, *kuçeno*, *kuçeto*, *kuçinjata*) II 136; *shkumb*, *kji shkumb*, *kaka shkumba*, *te shkumb*, *ajo shkumb*, *ata shkumba* (*sllav. oena*, *penava*, *penive*, *penana*, *penata*, *penite*) II 143; *viç*, *kji viç*, *kata viça*, *ajo viçi*, *te viçi*, *te viçat* (*sllav. tele*, *televo*, *telinjata*, *teleno*, *teletto*, *telinjata*) II 151 etj. Siç po shihet nga format e sjella të pashquarsisë – shquarsisë në njëjës e në shumës të tre emrave të fundit, përveç përemrave dëftorë, shpeshherë Pulevski përdor edhe parafjalën *te*, për të treguar vendin e gjësë së përcaktuar në analogji me përcaktimin hapësinor në maqedonishte.

Kemi parë raste kur autori, përveç mbaresës shquese, përemrave dëftorë të paravënë, parafjalës *te*, përdor edhe pasthirrma urdhërore që shprehin thirrje, përkatësisht *or*, *more* për të formuar rasën thirrrore. P.sh. *njerji*, *kji njerji*, *kata njerjitë*, *or njerji*, *mor njerji*, *njerjitë* (*sllav. çovek*, *çovekov*, *çoveci*, *çoveku*, *çoveçe*, *ludi*) II 155; *femn*, *femn jan*, *femni*, *femna*, *kjo femni*, *kija femni*, *kata femni*, *te femn*, *te femna*;

<sup>85</sup> Emrat mashkulorë që mbarojnë me *-k*, *-g* e *-h* dhe *-i* të theksuar në të folmen e Kërçovës marrin mbaresën shquese *-u*, si *Veli-u*, *Sali-u* etj. Lulzim Aliu, *Gjuha në disa këngë të moçme kërçovare* (punim magjistrature në dorëshkrim), Fakulteti Filologjik “Bllazhe Koneski”, Shkup, 2005.

<sup>86</sup> Besim Bokshi, *Prapavendosja e nyjës në gjuhët ballkanike*, Prishtinë, 1984.

or *gruva, gruva, gruvat, kji gruva, ajo gruva, ata gruva*; që mund të krahasohen me format e gjuhës maqedonase të dhëna në faqen 132 në Fjalorin tregjuhësh.

Një gabim tjetër në lidhje me trajtat e emrit Pulevski e bën me përdorimin e pavend të trajtës së shquar apo të pashquar, përkatësisht ma përdorimin e njëres në vend të tjetrës. Si bie fjala, *tha zot* (do të duhej *tha Zoti*) II 8, *si asht ekur* (si është hekuri?) II 26, *çish asht plumb* (çështë plumbi?) II 27, *si asht zhiv* (si është zhiva?) II 28, *si po baronte mill* (si bëhet mielli?) etj. Edhe kjo shmangie është bërë nën ndikimin e maqedonishtes (që mund të shihet në: reçe gospod, kakvo je zhelezde, shto je olovo etj.), sepse në paralelen e asaj gjuhe janë dhënë në trajtën e pashquar, por edhe tani në rastet e tilla përdoren në po atë trajtë.

**Format rasore.** – Në lidhje me format rasore mund të themi se përdorimi i rasave në shqipen e fjalorëve në vështrim është shumë i pavend, saqë nuk kemi mundur të nxjerrim ndonjë sistem apo rregull për të parë mënyrën e përdorimit të tyre. Shpeshherë se në çfarë rase është pjesa emërore, kemi mundur ta hetojmë jo përmes mbaresave rasore të emrave, por në bazë të funksionit sintaksor të pjesës emërore. Rrjedhimisht, jemi të mendimit se kjo çështje as që meriton ndonjë vështrim më të hollësishëm. Një gjendje e këtillë, sipas gjithë gjasash, është pasojë e asaj se maqedonishtja e ka humbur kategorinë gramatikore të rasës. Prej atëherë kur në maqedonishten u humb deklinacioni, parafjalët në masë të madhe i morën funksionet që i kishin rasat.<sup>87</sup>

Gjatë analizës filologjike të fjalorëve të Pulevskit, vërejtëm se na paraqiten gjashtë rase të shqipes: emërorja, gjinorja, dhanorja, kallëzorja, rrjedhorja dhe thirrorja. Siç dihet, rase thirrore tani më nuk konsiderohet si rasë më vete, por trajtë e emërores, me të cilën përputhet nga forma si në trajtë të pashquar, ashtu edhe në të shquarën. Thirrorja dallohet nga emërorja vetëm për nga pjesëza thirrmore *o*, që mund të përdoret para ose pas emrit (o Ilir – Iliro).<sup>88</sup>

Në vazhdim po paraqesim disa shembuj me emra të përdorur në rase të ndryshme, ku edhe do të shihet mospërdorimi i duhur i tyre. **Rasa emërore:** *Perëndi asht gjikunde* (në vend të Perëndia është gjithkund) II 5, ku emri - kryefjala është dashur të përdoret në trajtën e shquar. *Afrik ashtë ...* (Afrika është ...) II 60. Me vend është përdorur emri në fjalinë e anasjellë *Po mësohen njerëzit* (Njerëzit po mësohen) II 60 etj. **Rasa gjinore:** *Edhe gjoha te nonas* (edhe gjuhën e nënës) II 5, *liberta kishas* (librat e kishës, librat kishtarë) II 3, *peshka detis* (peshqit e detit) II 9, *guri shkrepës* (guri i shkrepsës) I 19, *krebi mishit* (krimbi i mishit) I 52, *veni frengut* (vendi i frengut, i francezëve) I 62, *brezi eras* (brezi i erës) II 22, *ara orizit* (ara e orizit) I 16, *brinja samarit* (brinja e samarit) I 42 etj., ku nuk do komentuar mospërdorimi i trajtës së rasës gjinore pa një të përparme ose përdorimi i rrallë i tyre, por i gabueshëm (shembulli i parë). **Rasa dhanore:** po japim një shembull të pavend *zotis* (Zotit) II 5. **Rasa kallëzore:** *Ndë liberti paras* (në librin e parë) II 3; *Ma të para e ka barova zot qelli edhe trolli* (Më së pari Zoti e ka krijuar qiellin dhe tokën) II 5; *ndë ditin* (në ditën) II 6,

<sup>87</sup> Krume Kepeski, *Gramatika na makedonskiot literaturni jazik*, Shkup, 1983, f. 137.

<sup>88</sup> A. Dhrimo, E. Angoni, E. Hysa, E. Lafe, E. Likaj, F. Agalliu, Sh. Demiraj, *Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe (morfologjia)*, Prishtinë, 1989, f. 66.

*ndë uji* (në ujë) II 8; *ma trolli* (në truall) II 8 etj. **Rasa rrjedhore:** *mish pe kau* (mish kau) I 39, *mish pe lopa* (mish lope), *mish te viçi* (mish viçi), *mish te kau* (mish kau) I 39, *mish pre dele* (mish deleje), *mish pre kinxhe* (mish qengji) I 39 etj.

Në faqen 156 të Fjalorit tregjuhësh, Pulevski ka shënuar disa forma të emrave vetjakë nga të cilët mund të nxirret një pasqyrë e lakimit të emrit. Ne do të përpiqemi ta rikonstruojmë paradigmën e këtyre emrave:

E.	Gjuro	Gjorgji	Gjurqin	Gjino
Gj.	Gjurës	Gjorgjit	Gjurqinit	Gjinos
Dh.	Gjurës	Gjorgjit	Gjurqinit	Gjinos
K.	Gjurën	Gjorgjin	Gjurqinin	Gjinon
Rr.	Gjurisë	Gjorgjisë	Gjurqisë	Gjinisë

## 5.2. MBIEMRI

Për mbiemrat pothuajse nuk shihen dallime dialektore në gjuhën tonë. I vetmi dallim jo shumë i rëndësishëm është ky: në të folmet e toskërishtes mbiemrat cilësorë të ardhur nga pjesorja e foljes (nga ato folje që mbarojnë me -r(ë), veç nyjave të përparme, nuk kanë ndonjë shenjë tjetër dalluese për dallimin e gjinisë: *i larë - e larë*, ndërsa në Veri *i la:m - e lame*. Edhe gegërishtja qendrore është konvergjente në këtë pikëpamje.<sup>89</sup>

Në fjalorët e Pulevskit mbiemrat janë mjaft të larmishëm. Autori në të shumtën e rasteve nuk i përdor nyjat e përparme të mbiemrat e nyjshëm, por ndonjëherë edhe kur i përdor, na dalin me gabime në gjini e në numër, d.m.th. nuk i përshtaten si duhet me gjininë dhe numrin e emrit. Ja disa shembuj të këtillë: *madh* (i madh) – *madhe* (e madhe) II 130, *bardh* (i bardhë) – *bardhë* (e bardhë) II 129, *vogël* II 138 për të dy gjinitë, *mjer* (i mjerë) – *mjera* (e mjerë) II 147, *varfur* (i, e varfër) II 142, *meir* (i mirë) – *meira* (e mirë) II 153, *zez* (i zi) – *zezë* (e zezë) II 154 etj.

Në faqen 155 të Fjalorit tregjuhësh kemi shembuj kur e përdor vetëm nyjën e mashkullores *i* si për gjininë mashkullore, ashtu edhe për femëroren në njëjës e në shumës: *i larme*, *i larme*, *i larme jan*; që në paralelen maqedonase kemi sharen, sharena, shareni.

Nyjën e përparme e përdor drejt në rastet: *mish i that* I 40, *dallga e detit* I 16, *sofra e ndreçme* I 63, *e shtrembër* I 68, *e verdhë* I 86, *i paçelur* I 94, *vend të that* II 6,

<sup>89</sup> Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Tiranë, 1988, f. 129.

*shtëpi të fort* II 54, *vendin e nalt* II 64, *ma të trash* II 67, *trupa të çillis* (trupa të qiellit, trupa qiellorë) II 68 e ndonjë tjetër.

Mbiemra të nyjshëm për nga sasia edhe në këta fjalorë ka më shumë sesa mbiemra të panyjshëm. Për të nyjshëm i kemi konsideruar edhe ata mbiemra të cilët duhet të jenë të nyjshëm, por që Pulevski i shënon pa një të përparme. P.sh. *kripër*, *kripun* (i, e kripur) I 40; *prvluar*, *gatuar* (i, e përvëluar; i, e gatuar) I 40; *lidhur*, *pastër*, *mallkomun* (i, e lidhur; i, e pastër; i, e mallkuar) I 73; *bardhë* (i, e bardhë) I 86, *dritin madhe*, *dritin vogl* (drita të mëdha, drita të vogla) II 7 etj.

Edhe në togfjalëshat e përbërë nga një emër dhe një mbiemër i nyjshëm, Pulevski nuk e përdor njëjën: *shpirta zhall* (shpirtëra të gjallë) II 8, *njeraz egri* (njerëzit e egër) II 36, *vapa madhe* (vapa e madhe) II 54, *jan shum madh* (janë shumë të mëdhenj) II 70, *brezi ftoht* (brezi i ftohtë) II 23, *brezi ngroft* (brezi i ngrohtë) II 23, *mbreti mir* (mbreti i mirë) II 50, *vera shkurt* (vera e shkurtër) II 23, *vapa madhe* (vapa e madhe) etj.

Me veprimin e haplologjisë<sup>90</sup> brenda togfjalëshit shpjegohen rastet e shpeshta të rënies së njëjës së përparme të emrave të rasës gjinore apo dhanore ose të mbiemrave të nyjshëm, kur ka përbërje të njëjtë me njëjën e prapme shquese. Edhe tani në ligjërimin tonë është mjaft e shpeshtë dukuria e haplologjisë. Krahaso *djali mirë* (< djali i mirë), *njeri mirë* (< njeri i mirë), *njerit mirë* (< njeriut të mirë), *vajzës vogël* (< vajzës së vogël), *kalit zi* (< kalit të zi), *Hani Elezit* (Hani i Elezit) etj. Kjo dukuri, e gjallë edhe në ditët tona në të folurit e përditshëm jonormativ nuk është pasqyruar në drejtshkrim, për hirë të ruajtjes së formës gramatikore. Edhe në ngërthim të fjalisë ka fjalë që shpjegohen me veprimin e haplologjisë. Khs. *ndjezot* (ndjeje Zot), *mazallah* (mos Zot Allah), *dorasi* (dorë vrasësi) etj.

Shembujt e dhënë më sipër bëjnë të qartë se prirja për të thjeshtuar fjalët, me anë të haplologjisë ka vepruar gjithnjë në gjuhë dhe kjo shprehet fuqishëm në ligjërimin shqip të Pulevskit. Në të gjitha rastet, rrokja që ka rënë ka qenë e patheksuar, gjë që lidhet me dinamizmin e theksit të gjuhës shqipe. Krahas kësaj, me zhdukjen disimilatore të njëjës prej rrokjeve të njëjta, haplologjia merr edhe karakter eufonik, duke shmangur kakofoninë që krijon shqiptimi i dy rrokjeve me përbërje të njëjtë fonetike.<sup>91</sup>

Mbiemra të panyjshëm kemi vërejtur më pak, si p.sh. *gur pushke* I 19, *brezare argjendi* I 31, *lule bjeshkit* (lule bjeshke) I 49 e ndonjë tjetër. Në tekstin shqip të këtyre fjalorëve gjemë edhe ndonjë formë të vjetër mbiemrash prejfoljorë, si kashti ta arzujet (kashta e rrëzuar) II 31.

**Shkallët e mbiemrit.** – Për sa i përket shkallëve të mbiemrit mund të themi se në tekstet në shqyrtim pothuajse të gjithë mbiemrat i kemi gjetur në shkallën pohore. Në të vërtetë, kemi mundur t'i hetojmë vetëm 3-4 raste të mbiemrit në shkallën krahasore: *madhe* (i, e madhe) në shkallën pohore dhe *ma madhe* (më e madhe) në

<sup>90</sup> Haplologjia është dukuri fonetike e rënies së njëjës nga rrokjet e njëjta brenda fjalës ose në kuadrin e një togfjalëshi.

<sup>91</sup> Koleç Topalli, *Theksi në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1995, f. 309-313.



shkallën krahasore të lartësisë; nalt – *ma nalt*. Në shkallën krahasore të ultësisë i kemi parë dy shembuj: *vogël – ma vogël* dhe *keq – ma keq*. Formën *ma shum msuur* të lexuar në faqen 58 të Fjalorit tregjuhësh mund ta konsiderojmë të shkallës sipërore të lartësisë, ngaqë në gjuhën e sotme standarde shqipe është e barasvlershme me formën “më të arsimuarit”, duke u mbështetur edhe në paralelen gjuhësore përkatëse të maqedonishtes e të turqishtes.

### 5.3. PËREMRI

Përemrat nëpër të folmet shqipe na dalin mjaft unik, me pak përjashtime të natyrës fonetike dhe faktit se gegërishtja ka përemra vetvetorë (i vet, e vet, vetja, vetvetja), ndërsa toskërishtja nuk i ka këta, por në vend të tyre përdor përemra pronorë (i tij, e tij, i saj, e saj). Për përemrat në fjalorët e Gjorgji Pulevskit mund të thuhet se janë po ata të të folmes së Dibrës dhe qarkut të saj, nëse mënjanohen gabimet e autorit.

Në fjalorët e këtij autori i ndeshim të gjitha llojet e përemrave të shqipes: përemrat vetvetorë, përemrat vetorë, dëftorët, pronorët, përemrat pyetës, përemrat lidhorë dhe përemrat e pacaktuar.

a) **Përemrat vetvetorë.** – Përemri vetvetor është ai lloj përemri që tregon personin, i cili në një fjali të caktuar përfaqëson njëkohësisht atë që e kryen dhe atë që e pëson një veprim.<sup>92</sup> Ky lloj përemri gjen zbatim në shqipen e fjalorëve në shqyrtim. Siç dihet, vetvetori nuk ka forma të veçanta në shqipen për të dalluar gjininë dhe numrin, ndërsa në maqedonishten përemri vetvetor dallohet në gjini dhe në numër. Nën ndikimin e gjuhës maqedonase, Pulevski krijoi përemra vetvetor që janë në kundërshtim me natyrën e shqipes. Kështu, kemi *vet* (“sam”, që përdoret për gjininë mashkullore), *veta* (“sama”, që përdoret për gjininë femërore) dhe *vete* (“sami”, që përdoret për të dy gjinitë në numrin shumës) II 149. Ose: *te veti* (nga maq. “samoto”, për gjininë asnjane), *kija teveti* (nga maq. “samata” - për gjininë femërore), *ata te vetat* (nga maq. “samite” – për gjininë mashkullore të numrit shumës) II 149.

Në faqen 8 të Fjalorit tregjuhësh kemi parë të shkruar: *let lishoe ka vetvete shpirta zhall mbas a radha të vet* (le të lëshojë nga vetvetja gjallesa sipas radhës së vet).

b) **Përemrat vetorë.** – Përemrat vetorë që i përdor autori i dy fjalorëve në spikamë janë:

---

<sup>92</sup> A. Dhrimo, E. Angoni, E. Hysa, E. Lafe, E. Likaj, F. Agalliu, Sh. Demiraj, *Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe (morfologjia)*, Prishtinë, 1989, f. 161.

	njëjës	shumës
veta I	<i>un</i>	<i>na, neve</i> <sup>93</sup>
veta II	<i>tëi</i>	<i>ju, juve</i>
veta III	<i>ai, ajo</i>	<i>ata, ato</i>

Siç po shihet, përdorimi i formave *neve* krahas *na* dhe *juve* krahas *ju* është i shpeshhtë dhe gati në tërë tekstin e fjalorëve kanë denduri të njëjtë. Po e rikujtojmë shpjegimin e dhënë në tekstin e morfologjisë historike se format e dhanores *neve* duhet shpjeguar ashtu që veçohen *ne + ve*, ku *-v-*ja është antihijatizuese, siç na del në sistemin e lakimit emëror dhe në foljet e kohës së kryer të thjeshtë (*shko-v-a*) ... Forma në shqyrtim e gjinore-dhanores, me kohë ka kaluar në rasi të tjera, në emërore dhe në kallëzore.<sup>94</sup>

Ja disa shembuj të përdorimit të gabueshëm rasor të përemrit vetor ne: ... *qeter njeraz cili jan ma plak ka neve* (... njerëzit e tjerë që janë më të moshuar se ne) II 11; *prse neve jemi ...* (pse ne jemi ...) II 15; *neve na duhet ...* (ne na duhet ...) II 30 etj.

Në bazë të formave rasore të hetuara në tekstin shqip të fjalorëve të Pulevskit e kemi konstruktuar paradigmen e lakimit të përemrave vetorë, që duket kështu:

numri	rasat	veta e parë	veta e dytë	veta e tretë	
				mashkullore	femërore
	E.	un	tëj	aj (aji)	ajo
	Gj.	-	-	ati	asëj
	Dh.	mu, mue	tëj	ati	asëj
	K.	mu, mue	tëj	at	at
	Rr.	mu, meje	teje	ati	asëj
	E.	na, neve	ju, juve	ata	ato
	Gj.	-	-	atine, ature	atine, ature
	Dh.	na, neve	ju, juve	atine, ature	atine, ature
	K.	na, neve	ju, juve	ata	ato
	Rr.	neve	juve	atine, ature	atine, ature

Përdoren edhe trajtat e shkurtra të përemrave vetorë, si *mu* (mua më) II 95 në fjalinë *Sot mu ka ardhë* (sot më ka ardhë) ose *diftomu* (diftom mua) në fjalinë *Diftomu ta dji un* (më dëfto ta di unë) II 124; *m-tha, t-tha, i tha* (më tha, të tha, atij i tha) II 138 etj.

c) **Përemrat pronorë.** - Në vështrimin tonë filologjik kemi vërejtur se në tekstin shqip të Pulevskit përemrat pronorë kanë denduri të madhe. Në përgjithësi mund të themi se përdoren po të njëjtit përemra pronorë si në të folmen e Dibrës, po t'ua heqim disa gabime të bëra nga autori si shkak i mosnjohjes së mjaftueshme të natyrës së shqipes. Në vazhdim do t'i paraqesim disa nga pronorët që na kanë rënë në sy, pa

<sup>93</sup> Në Fjalorin tregjuhësh e kemi vërejtur formën **ne**.

<sup>94</sup> Idriz Ajeti, *Historia e gjuhës shqipe (morfologjia historike)*, Prishtinë, 1969, f. 43.

dhënë ndonjë shpjegim: *im, imi, imi jan* (të mitë) II 138 për gjininë mashkullore; *tono, tona, tona jan* (tonë, tona, tonat) II 140; *tonte, jot, jota, jote, it, ite, ime, time, teme, tem, e mija* I 79; *joti* (yti) II 151, *k-tis* (këtij dhe asaj), *këtis jan* (të tyre) II 10, *tont* (tanë) II 11, *ature* (atyre) II 15, *tonte* (tonat) II 55 etj.

Pronorët në fjalorët në analizë janë vendosur gjithnjë prapa emrit. Ka raste kur përemrat dëftorë i gjejmë në bashkëvajtje me pronorët, ku përemri dëftor shkon para pronorit, si bie fjala *ki jim* (ky imi), *kija im* (kjo imja), *kata imi* (këta të mitë); *ajo të im* (ai imi), *ajo të im* (ajo imja), *ata të imi* (ata të mitë) II 138. Nga shembujt e sjellë mund të shihet se ndonjëherë përemrat pronorë janë përdorur në formë të emëruar.

ç) **Përemrat pyetës.** - Si përemra pyetës në fjalorët e Pulës i kemi ndeshur këta: *kush?, çish?, pse?, përse?, cili?, cila?, cilat?, ç' (çvar?), sa?, si?, kujt? dhe shka?* Të shënojmë disa shembuj: *kush* II 166, II 135, I 79; *kush çeter njerji* II 126, *kush ashtë* I 79; *çish asht g-juha?* II 30, *çish asht deti?* II 19, *çish asht besa?* II 13, *diftomu çish asht jeshil?* II 92, *çish ka agje* I 78, *çish s'kije?* I 78; *anza po si çish ...* II 79, *çish asht rei edhe si po bojet?* II 86; *pse mreti ...* II 50, *prse bojet ...?* II 22, *prse s'ka kanga ... ?* II 67, *prse diftomu?* II 122; *prse ishte mir?* II 124, *cili?* II 67, *cili jan ata?* II 24, *nka cili fis jemi?* II 38, *cili qeshen?* II 135, *cili ashtë?* I 79, *çvar fuqija ...* II 7, *na çvar g-juha kuvendoim?* II 41, *çvar* II 135, *si* II 135, *si u dajet trolli?* II 23, *si asht ekur?* II 26, *si duhet ta folim?* II 108, *sa java kishte ...?* II 73, *ka sa dit bojen ...?* II 81, *sa jan latinise shtilsa?* II 112, *me kuit shtilsa ...?* II 112, *shka* I 78 etj.

d) **Përemrat e pacaktuar.** - Këto lloje përemrash, që janë quajtur edhe përemra të pakufishëm, në fjalorët e Pulevskit janë përdorur për të treguar frymorë a sende në mënyrë të pacaktuar ose sasi të pacaktuar frymorësh a sendesh. Të tillë janë përemrat: *asgja, kurgja* I 78; *asnjani, kurkund* I 93; *njicili* (dikush), *njicila* (dikush për gjininë femërore) dhe *njicili shum* (dikush për numrin shumë) II 140 sipas modelit të maqedonishtes “nekoj, nekoja, nekoji”. Përveç këtyre, kemi edhe disa përemra të pacaktuar të krijuar në mënyrë artificiale sipas modelit të maqedonishtes, si *n-njikush* (dikujt) : maq. nekomu; *n-njikusha* : maq. nekoize dhe *n-njicilit* : maq. nekoima II 140; *pas cëll* (çdonjëri), *pas cëlla* (çdonjëra), *pas cillat* (çdonjëret) II 149; *gjit se si* (gjithçfarë) sipas paraleles sllave “sekakov” për gjininë mashkullore; *gjit se sija* (gjithçfarë) sipas sllav. “sekakva” për gjininë femërore dhe *gjit çvar* (gjithçfarë) për të dy gjinitë në numrin shumë, sipas modelit të sllavishtes “sekakvi” II 149.

Për përemra të pacaktuar i kemi llogaritur edhe format *gjikunde, krkunde* II 18, 70; *donjikush* II 132, *shumvet* II 132, *njicili* II 140 etj.

dh) **Përemrat lidhorë.** - Pulevski në shqipen e fjalorëve të vet përdor edhe përemra lidhorë. Është interesant fakti se përemrin lidhor të ngurosur **që** nuk e kemi vërejtur gjëkund, edhe pse përdoret shumë dendur në gjuhën popullore. Në vend të tij përdoret mjaft dendur përemri lidhor *i cili, e cila ...* që është karakteristik për gjuhën letrare, si p.sh. *Bas çish u njofet ata faqe, i cili jan na likura njerazes josi si?* (në bazë të cilave veti dallohen njerëzit, të cilët janë me ngjyrëra lëkure jo të njëjta?) II 37. *Çijell i thoin ajo i cili po duket ...* (Qiell i thonë atij i cili ...) II 68. *Sheqer po u leen makalem, cili po vjen ...* II 33. *Xhitha jan trupa cilj po u xhindet ...* II 25. *U vshatumun po thoin ata ana, cili poroin shum njeraz ...* II 22. *Trolli that mbas cili przijet ...* II 20. *A radha, cili po shkon ...* II 3 e shumë shembuj të tjerë.

## 5.4. FOLJA

Sistemi foljor paraqet një nga çështjet më të ndërlikuara të morfologjisë së gjuhës shqipe, qoftë në aspektin diakronik, qoftë në aspektin sinkronik. Në gjuhën e shkruar shqipe të Pulevskit kjo kategori morfologjike aq më tepër na del e koklavitur, meqë autori nuk e ka njohur në thelb sistemin morfologjik të shqipes. Në punimin tonë do të përpiqemi t'i paraqesim veçoritë themelore të trajtave foljore, por me plot gabime të bëra nga ana e Pulës. Gabime janë bërë si në vetë, numër, kohë, diatezë, zgjedhim etj. Prandaj, jemi të mendimit se sistemi foljor i tekstit shqip të fjalorëve të Pulevskit nuk meriton ndonjë vështrim të hollësishëm. Përgjithësisht, fjalorët janë shkruar në mënyrën dëftore. Përdorim më të madh gjejnë koha e tashme, koha e pakryer, e kryera e thjeshtë, e kryera, më se e kryera dhe koha e ardhme.

**1. Koha e tashme.** - Foljet që dalin me temë në bashkëtingëllore, me përjashtim të foljeve apofonike dhe atyre metafonike, në vetën e parë të njëjësit e zgjerojnë temën me mbaresën *-i* (ato me *-k*, *-g* marrin mbaresën *-u*): *qepi, derdhi, prëjshi, shkeli, veshi; iku, preku* etj. Ndërkaq veta e dytë dhe e tretë njëjës del pa mbaresa vetore: tëi *qep*, ai *qep*. Në numrin shumës këto folje zakonisht marrin mbaresat *-im*, *-ni*, *-in*: *qep-im, qep-ni, qep-in*.

Foljet apofonike, metafonike, me pak përjashtime, në numrin njëjës në të tri vetat nuk marrin mbaresa: un *dal*, tëi *del*, aj *del*; un *sjell*, tëi *sjell*, aj *sjell*; *mar, mer, mer*.

Po japim paradigmën e zgjedhimit të foljeve ndihmëse kam dhe jam në kohën e tashme të mënyrës dëftore:

<i>kam</i>		<i>jam</i>	
kam	kimi	jam	jemi
ke	kini	je	jeni
ka	kan	asht	jan

Foljet e zgjedhimit të parë, që në të folmet shqipe dhe në gjuhën standarde në vetën e parë njëjës marrin mbaresën *-j* (puno-j), në të dy fjalorët e Pulevskit në të tri vetat e njëjësit rëndom dalin pa mbaresa; ndërsa në numrin shumës dalin me po ato mbaresa që kanë përhapje në mbarë gegërishten. Pra kemi:

<i>punoj</i>		<i>shkoj</i>	
puno	puno-jm	shko	shko-jm
puno	puno-ni	shko	shko-ni
puno	puno-jn	shko	shko-jn

Me forma të njëjta përdoren edhe në të folmen e Grykës së Madhe të Dibrës, por me një dallim se në vetën e parë të njëjësit marrin mbaresën foljore –j: puno-j, puno, puno.<sup>95</sup> Arsyetimin se pse Pulevski nuk e ka shënuar mbaresën –j duhet kërkuar në faktin se [j]-ja fundore gjendet në pozitë të dobët fonetike, prandaj në nyjëtim ajo mund të mos dëgjohet sa duhet, ose së paku ai nuk e ka dëgjuar bindshëm nga shqipfolësit e vendlindjes së tij.

Zgjedhimi i foljes së parregullt supletive vi (erdha) në fjalorët e Pulës na del me gabime, si: un *vi*, tëi *vje*, aj *vjen* (në vend që të shkruante vij, vjen, vjen) ku shihet se në vetën e parë nuk e shënon <j>-në si mbaresë vetore dhe në vetën e dytë <n>-në. Në shumës Pulevski përdor format *vimi*, *vini*, *vinë* (vijmë, vini, vijnë).

Vlen të theksohet se autori shumë shpesh përdor kohën e tashme me pjesëzën *po* të vendosur para formës së kohës së tashme. Lidhur me këtë prof. Shaban Demiraj thotë: “Për sa i takon kohës së tashme, gjuha shqipe ka ndjerë nevojën që të dallojë përdorimin e saj për të emërtuar një veprim të caktuar, të individualizuar, nga rastet kur ajo përdoret me një kuptim të pacaktuar. Për rastin e parë shqipja ka shfrytëzuar dy mjete gjuhësore – pjesëzën *po* të vendosur para formës së kohës së tashme, përkatësisht formën analitike të ndërtuar me anë të kohës së tashme të ndihmëses *jam* dhe të ashtuquajturës përcjellore të foljes themelore. Kështu është krijuar kundërvënia formale dhe kuptimore midis formës sintetike të tipit *punoj*, nga njëra anë, dhe formave analitike të tipit *po punoj*, përkatësisht *jam duke punuar*,<sup>96</sup> nga ana tjetër. Nga dy formimet e fundit e para ka një denduri dhe shtrirje gjeografike më të madhe, prandaj edhe është përgjithësuar më shumë në shqipen letrare”.<sup>97</sup>

Me pjesëzën *po* Pulevski është përpjekur të zëvendësojë aspektin kohor (vidin) që e kanë gjuhët sllave. Me aspektin kohor në gjuhët sllave nënkuptohet veprimi i pakryer (imperfektiviteti) ose i kryer (perfektiviteti) i veprimit të shprehur nga folja. Foljet e tipit të parë tregojnë veprim që është duke u kryer në momentin kur flasim, që vazhdon dhe që nuk ka përfunduar. Foljet e tipit të dytë emërtojnë një veprim që plotësisht ka përfunduar.<sup>98</sup>

Format analitike të kohës së tashme (po punoj) Pulevski i ka përdorur për të treguar një veprim që është duke u zhvilluar në çastin kur folësi flet, ndërkaq me formën analitike pa pjesëzën po (punoj) ka shprehur një veprim të përfunduar. P.sh.:

<i>forma analitike</i>		<i>forma sintetike</i>	
laro un	larojm	po laro un	po larojm
laro tëi	laroni	po laro tëi	po laroni
laro aj	larojn	po laro aj	po larojn

<sup>95</sup> Bahri Beci, *E folmja e Grykës së Madhe të Dibrës*, Studime filologjike nr. 3, Tiranë, 1972, f. 100.

<sup>96</sup> Tipi *po punoj* është më i hershëm se tipi *jam duke punuar*.

<sup>97</sup> Prof. Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, pjesa I dhe II, Prishtinë, 1980, f. 192-198.

<sup>98</sup> Круме Кепески, *Грамајика на македонскиот литературен јазик*, Shkup, 1992, f. 113-114.

Nganjëherë në vend të formës *laro aj* e gjejmë trajtën *po laroje* (në vetën e dytë të kohës së pakryer). Hetohet edhe një gjë: për shkak të mungesës së mbaresave foljore për të tri vetat e njëjësit, Pulevski shpeshherë pas foljes përdor përemrin vector.

Kundërvënia e mësipërme: *larojm* dhe *po larojm* është shtrirë edhe në kohën e kryer në fjalorët në shqyrtim. Në gjuhën standarde shqipe kundërvënia pa pjesëzën dhe me pjesëzën *po* është shtrirë në kohën e tashme dhe në të pakryerën (punoj – po punoj; punoja – po punoja).

Se pjesëza *po* është shtrirë edhe në kohën e kryer në gjuhën e fjalorëve të Pulevskit, mund ta përdëftojmë me shembullin që vijon:

<i>koha e tashme</i>		<i>koha e kryer</i>	
po vi	po vimi	kam po vi	kimi po vje
po vje	po vini	ke po vji	kini po vin
po vjen	po vi:n	ka po vi	kan po vje

**2. Koha e pakryer.** - Në të folmen e qytetit të Dibrës kjo është koha më karakteristike në mbarë sistemin foljor të kësaj të folmeje. Në numrin njëjës ruan mbaresat e vjetra të shqipes, ato që sot janë tipike për shumicën e të folmeve toske, ndërsa në numrin shumës del me mbaresat që përgjithësisht karakterizojnë të folmet e gegërishtes qendrore.<sup>99</sup>

Koha e pakryer përdoret rrallë në gjuhën e këtij autori. Pos shembujve *punoje* II 147, *punojin* II 147, *shkoje* II 141, 136; *laroje* II 141, *punonte* II 131, *kulloje* II 154; *kujtoshin* II 138, *thoshnjin* II 157, *ishnjen* II 9, *kishnjen* II 37, 134 forma të tjera foljesh në këtë kohë nuk vërejtëm.

Nëse mund të nxirren përfundime të drejta në bazë të shembujve që i shënuam, mund të konstatojmë se mbaresat vector të foljeve në kohën e pakryer në diatezën veprore janë: *-je, -je, -te* ose *-nte* (për njëjësin) dhe *-nim, -nit, -nin* (për shumësin). Mirëpo, tri format foljore të shënuara më lart (thoshnjin, ishnjen, kishnjen) na japin të drejtë të pohojmë se krahas formave me *-j-*, paralelisht janë përdorur edhe mbaresat foljore me *-nj-*: *-nje, -nje, -nte* (për njëjësin) dhe *-njim, -njit* dhe *-njin* (për shumësin). Ky konstatim gjen mbështetje edhe te vepra e Josif Bagerit,<sup>100</sup> punimi i Sefedin Harunit,<sup>101</sup> Fehim Reçanit,<sup>102</sup> Bahri Becit,<sup>103</sup> Qemal Muratit<sup>104</sup> etj. Në shqipen e Gjergjit veta e parë njëjës del si veta e dytë njëjës. Kështu është edhe në të folmen e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës, në të folmen e Grykës së Madhe të Dibrës etj.

<sup>99</sup> Naim Basha, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 186.

<sup>100</sup> Shaqir Berani, *Gjuha e Josif Bagerit*, Prishtinë, 1988, f. 136-137.

<sup>101</sup> Sefedin Haruni, *E folmja shqipe e Rekës së Epërme*,

<sup>102</sup> Fehim Reçani, *Të folmet shqipe të Pollogut*, Shkup, 2001, f. 286.

<sup>103</sup> Bahri Beci, *E folmja e Grykës së Madhe të Dibrës*, Studime filologjike nr. 3, Tiranë, 1972, f. 100-101.

<sup>104</sup> Qemal Murati, *E folmja shqipe e rrethinës së Tuhinit të Kërçovës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 40.

Në fjalorët në shqyrtim forma foljesh në kohën e pakryer në diatezën joveprore nuk kemi hetuar, andaj për këtë nuk do të themi gjë.

**3. Koha e kryer e thjeshtë.** – Kjo kohë në fjalorët e Pulevskit përdoret dendur, andaj kemi edhe mjaft të dhëna për format e tilla foljore. Format foljore të të kryerës së thjeshtë (aoristit) që i shkroi Pulevski nuk dallohen nga të folmet e gegërishtes qendrore e as nga shqipja e përgjithshme. Kështu, foljet që mbarojnë me bashkëtingëllore dalin me këto mbaresa: *-a, -e, -i (u ose zero)* në numrin njëjës dhe *-ëm, -ët, -ën* në numrin shumës. P.sh. *gjat-a, gjet-e, gjet; gjet-ëm, gjet-ët, gjet-ën*.

Foljet që mbarojnë me zanore aoristin e formojnë duke i marrë mbarestat *-a, -e, -i* për njëjësin (në dy vetat e para të njëjësit me paravënie të një *-v*-je antihijatizuese), ndërsa për shumësin *-ëm, -ët, -ën*. Në faqet 144 dhe 145 të Fjalorit tregjuhësh kemi parë tri forma të foljeve shkoj dhe mbjell. Në bazë të analogjisë mund ta ndërtojmë paradigmen e zgjedhimit të këtyre dy foljeve në kohën e kryer të thjeshtë:

<i>koha e kryer e thjeshtë</i>			
shkova	shkomi	mbjella	mbjellëm
shkove	shkoni	mbjelle	mbjellët
shkoj	shkojn	mbjelli	mbjellën

**4. Koha e kryer.** - Edhe kjo kohë është përdorur mjaft shpesh në tekstet që po i analizojmë. Si rëndom, format foljore të kohës së kryer në veprore ndërtohen me ndihmësen *kam* e shoqëruar me pjesoren e foljes që shfaq veprim. P.sh. *kam laro, ka laro, ka laro; kimi laro, kini laro, kan laro*. Pjesorja e foljes *laro* besojmë se do të ishte shqiptuar si *larau*, që do të duhej të ishte përfutur nga diftongimi i zanores /u/ të theksuar: *lavrú > larú > larau*, por që Pulevski nuk ka gjetur ndonjë mënyrë tjetër më të përshtatshme për ta regjistruar më besnikërisht këtë diftong. Nga zgjedhimi i foljes *lëvroj* shihet se folja ndihmëse *kam* nganjëherë përdoret në një formë të njëjtë, pra *ka* si për vetën e dytë, ashtu edhe për vetën e tretë njëjës. Ja edhe disa shembuj të kohës së kryer të gjetur në fjalorët: *kam kuvendova, kam kullova* II 154, ku në vend të pjesores së foljes *kuvendoj* (kuvenduar, kuvendu ose kuvendumun) është përdorur forma e të kryerës së thjeshtë (kuvendova), gabim ky i cili nuk dëgjohet te asnjë shqiptar. Ja edhe disa folje të tjera, të cilat hetohen mjaft përdorime të gabueshme, si *kam tha* (kam thënë), *ka shkru:* II 61, *ka ep(ë)* (ka dhënë) II 3, *ka bove* (ka bae ku [v]-ja është antihijatizuese) II 8, *kam shit* I 72 etj.

Trajta e foljes *ka ep(ë)* përdëfton se Pulevski nuk i ka njohur format e parregullta të foljeve supletive. Kështu, në faqen 131 të Fjalorit tregjuhësh kemi: *ep, ka ep, kan ep, kam ep, ke ap, kini ap* etj. (për formën e drejtë dhënë), ose në faqen 150 të po të njëjtit fjalor: *kam rji, po rim na, kan rji, ka rji* (kam ndejtur, po rrimë ne, kanë ndejtur, ka ndejtur). Gjithashtu në faqen 88 II kemi regjistruar formën: *na pajem* (në vend të formës së drejtë *ne shikojmë* ose *ne shohim*).

Lexuesi i kujdesshëm mund të hetojë se në shqipen e fjalorëve në spikamë forma joveprore formohet me foljen ndihmëse *jam* dhe pjesoren e foljes: *jam la, je la, asht la; jimi la, jini la, jan la* etj., por kjo formë rrallë është përdorur. Kemi vërejtur se

Pulevski e ngatërron edhe përdorimin e foljeve ndihmëse *kam* dhe *jam*, duke e përdorë njëherë në vend të tjetrës, si *asht barumun* II 30, 32 (në vend të formës së mbarë gegërishtes “ka mbaru:” ose të shqipes standarde “ka mbaruar”).

**5. Koha më se e kryer dhe e kryera e tejshkuar.**- Sipas pohimeve të Naim Bashës, në të folmen e Dibrës koha më se e kryer kryen funksion të dyfishtë, ngaqë ajo ia ka zënë vendin edhe të kryerës së tejshkuar.<sup>105</sup> Një gjendje të këtillë e kemi hetuar edhe në fjalorët në shqyrtim. Mirëpo, edhe pse në të folmen e Dibrës koha më se e kryer ka përdorim të dendur, në fjalorët e Pulevskit kemi mundur të vërejmë vetëm një rast të përdorimit të saj, përkatësisht *kishte bije* (kishte ble) II 3. Nëse do të lejohem të bënim konstruimin e kësaj forme kohore me anë të analogjisë, do të kishim: *kisha bije, kishe bije, kishte bije; kishim bije, kishi bije dhe kishin bije*.

**6. Koha e ardhme.** – Në fjalorët e Pulës kjo kohë realizon vetëm një veprim ose të qenë që do të kryhet në një të ardhme të afërt. E kemi hasur të ndërtuar me pjesëzën do + lidhoren e foljes kryesore (me disa ndërrime fonetike), si *ma mir do t'baroje* II 123, *do t'msojm, do t'dritojn* II 4, *do t'shkoni* II 136 etj. Në faqen 141 të Fjalorit tregjuhësh kemi parë dy forma të kohës së ardhme në vetën e parë e në të dytë të formës veprare: *do t'laro un dhe do t'laro tëi*. Gjithashtu, po në të njëjtin fjalor kemi lexuar: *do t'jam, do t'je, do t'jemi; do t'them, do t'thash dhe do t'themi*.

Siç mund të vërehet nga shembujt e sjellë, zanorja [ë] është eliduar te pjesëza të e mënyrës lidhore dhe e kohës së ardhme, rrjedhimisht ka mbetur vetëm forma *t'*. Gjatë punës sonë kemi parë dy raste të mospërdorimit të pjesëzës të: *do shkoin* I 66, *do shkoish* I 78, dukuri mjaft e shpeshtë në të folmet e gegërishtes qendrore.

**5.4.1. Mënyrat e tjera të foljes.** – Përgjithësisht, mënyra dëftore e përshkon tekstin shqip të fjalorëve të Pulevskit, ajo zë vend qendror. Shumë rrallë mund të lexohen mënyra të tjera të foljes. Ndër to kemi hetuar se ndonjëherë gjen zbatim mënyra lidhore, urdhërorja dhe dëshirorja.

- **Mënyra lidhore.**- Koha e tashme e mënyrës lidhore është formë reprezentative e kësaj mënyre kohore. Këtu, si në mbarë shqipen, kjo kohë ndërtohet me pjesëzën *të* dhe formën deri diku të ngjashme me kohën e tashme të mënyrës dëftore. P.sh. *ta dajen* II 6; *ta kandoim, ta shkruim, ta barojn* II 36, *të u çillonte* II 6, *ta mu diftojsh* II 30, *tat dritoje* II 50 etj., ku me shkrirjen e zanoreve [ë] + [e] te trajta e bashkuar e përemrit vetor *të + e* është përfutur [a]-ja (ta).

Siç dihet, vlerën e fjalive lejore-kushtore kanë edhe disa ndërtime me mënyrën lidhore të prira nga pjesëza *le*, që i jep fjalisë kuptimin e lejimit.<sup>106</sup> Këto forma përdoren mjaft dendur në fjalorët e Pulevskit, si *le t'bijet* II 7, *le t'ffaron zogat* II 8, *le të shikon* II 33 etj.

<sup>105</sup> Naim Basha, *E folmja e qytetit të Dibrës*, Studime gjuhësore II (Dialektologji), Prishtinë, 1989, f. 190.

<sup>106</sup> Mehmet Çeliku, Mahir Domi, Spiro Floqi, Seit Mansaku, Remzi Përnaska, Stefan Prifti, Menella Totoni, *Gramatika e gjuhës shqipe, vëllimi II, Sintaksa*, Tiranë, 1996, f. 602.



Në fjalorët e Pulës gjejmë edhe disa raste kur në vend të pjesëzës *të* të përdoret *në*-ja (sigurisht me etimologji nga nëse), si p.sh. *po n'dji* (po të dish) II 75, *po n'jam* (po të jem), *po n'jami* (po të jemi) II 128 etj.

Përgjithësisht, në mbarë shqipen me lidhëzën *në* ndërtohet periudha me fjali të varur kushtore. Por, sipas bindjes sonë, edhe këtë formë me *në* Pulevski e ka përdorë për të ndërtuar mënyrën lidhore.<sup>107</sup>

- **Mënyra urdhërore.** – Dihet se kjo mënyrë ka vetëm format gramatikore të kohës së tashme të vetës së dytë njëjës dhe shumës. Sa për ilustrim po shënojmë disa nga format e urdhërores së shqipes së Pulevskit: *mendohu* I 79, *u leeni edhe shumoni edhe mbushni trolli* II 8; *luaje, luajeni* II 138; *mile* II 138, *bjeri me shuplak* II 143; *afroje, afrojni* II 144, *mbjelle* II 145, *porocite* II 145; *shpëne, shpëne këta* II 130 etj.

- **Mënyra dëshirore.** – Mënyra dëshirore ka përdorim të pakët në tekstin shqip të fjalorëve të Pulevskit. Ne kemi arritur të shënojmë disa shembuj, si *shkofsha* I 85; *pafshin, pavsha* II 54, *u baft* II 6; *të paq, të paqa* II 153.

Rastet e përdorimit të mënyrave të tjera të shtjelluara të foljeve në paralelen shqipe të këtyre fjalorëve janë shumë të rralla.

#### 5.4.1. MËNYRAT E PASHTJELLUARA

a) **Pjesorja.** – Pjesoret në fjalorët e Gjergjit na dalin mjaft të nduarduarshme:

- **Me mbaresën -un:** *derdhun* II 27, *ngroftun* II 26, *sosun* I 84, *shkelun* I 89, *mbitun* (mbytun, mbytur) I 73, 84; *zgjidhun* I 74, *thurun* II 60 etj. Sipas prof. Shaban Demirajt te ndonjë shkrimtar verior i shekullit të kaluar e aty-këtu edhe në të folmet popullore veriore ndeshen edhe trajta pjesorësh me prapashtesën *-nun*, si *ke-n-un* (= qenë), *la-n-un*, *za-n-un* etj.<sup>108</sup>

- **Me prapashtesën më të hershme -m:** *martoum* I 71, *bardhum* I 72, *dërgoum* II 98, *baroum* II 99, *pajtoum* II 100, *shkroum* II 101, 105, 110; *besoum* II 109, *gëzoum* I 77, *laroum* II 152, *pajtoum* II 154 (ku diftongu [ou] është përfutur nga diftongimi i /u/-së së theksuar).

---

<sup>107</sup> Dihet se fjalitë kushtore me lidhëzën *në* shprehin një kusht të mundshëm, të dëshirueshëm ose thjesht një supozim. Ato janë të mbarë gjuhës të të gjitha stileve, por mbizotërojnë në stilin e letërsisë artistike. Në stilin publicistik-shkencor janë të rralla. Janë fjalitë më të rëndomta në poezi, sepse vetë folja në mënyrën dëshirore është më e përshtatshme për të shprehur ngjyime emocionale; nga ana tjetër, struktura njërrrokëshe e lidhëzës e bën atë më koncize dhe më të volitshme për t'u përdorur. Shih: *Gramatika e gjuhës shqipe, vëllimi II, Sintaksa*, Tiranë, 1996, f. 583.

<sup>108</sup> Shaban Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 945.

- Sasinë më të madhe të pjesoreve e hasim me mbaresën e zgjeruar -m-un, si p.sh. *bomun* II 29, *laroumun* II 30, *barumun* II 30, *msumun* II 13, 14; *damun* II 18, *gatumun* II 23, *przimun* II 26; *gjikumun*, *vshatumun* (banuar) II 22, *çillomun* I 95, *malkomun* I 84, *rzomun* I 84, etj.

Në lidhje me këtë pjesore kanë shkruar prof. Shaban Demiraj, Jorgji Gjinari etj. Prof. Gjinari shprehet se në disa të folme, si në atë të Matit, Dumresë e ndonjë tjetër në mënyrë sporadike e gjejmë edhe me mbaresë pjesoren te trajta foljore (me mbaresat -un: lidhun dhe -m: *bam*, këtë të fundit edhe me mbaresë të dyfishuar -mun: *bamun*).<sup>109</sup> Ndërkaq, Demiraj thotë se tek disa shkrimtarë gegë të shekujve XVIII-XIX<sup>110</sup> dhe në ndonjë të folme gege<sup>111</sup> ndeshen edhe forma pjesorësh me prapashtesën e zgjeruar -m-un, e cila ka dalë nga bashkimi i prapashtesës -m me prapashtesën -un ...<sup>112</sup> Formanti -m-un nuk është i vjetër në gjuhën shqipe, ai nuk del as te autorët e vjetër gegë dhe ka pasur vetëm një përhapje të kufizuar si në kohë edhe në hapësirë.<sup>113</sup>

- Me formantin -r(ë): *gëzuar* II 147; *shkuar*, *axhinuar* I 13, *pajtuar* I 55; *shtrirë*, *shkurtuar*, *çiruar* I 72, *zbuluar* I 71 etj.

- Me -ur: *shitur* I 88, *grisur* I 71, *mbledhur* I 71 etj.

- Pjesore pa mbaresë ose me mbaresë zero: *kam shit* I 72, *ka shkru*: II 61 etj.

b) **Paskajorja**. – Në fjalorët e Pulës si dhe në të folmen e Dibrës,<sup>114</sup> të Kërçovës<sup>115</sup> etj. paskajorja perifrastike e ndërtuar ma pjesëzën parafjalore *me* dhe me pjesoren nuk ka përdorim të shpeshtë. Si në të gjitha të folmet e toskërishtes dhe në disa të folme të gegërishtes jugore, ku kemi përdorim paralel të të dy formave, ajo është zëvendësuar me lidhoren: *me punue / të punoj* ose me paskajoren e ashtuquajtur toske për të punuar (me pjesoren *punu*:, pra për të punu > për t'punu:). Në të vërtetë në gegërishten jugore, siç dihet, kemi përdorim paralel të paskajores gege dhe të lidhores: sa më në jug që shtrihen të folmet e gegërishtes, denduria e përdorimit të lidhores shtohet, ndërsa zvogëlohet forma e paskajores dhe anasjelltas. Bie fjala, në të folmen shqipe të Karadakut të Shkupit<sup>116</sup> paskajorja gege dhe lidhorja kanë denduri të njëjtë përdorimi, ndërsa në të folmen e Karshiakës dhe të Dervenit lidhorja përdoret më shpesh sesa paskajorja.

Te Pulevski kemi ndeshur shpesh forma të lidhores e rrallë forma të paskajores, si *t'msoim* (të mësojmë) II 3, *ta rrapshojë* (ta rrafshojë) II 7 etj. Ja një fjali të

<sup>109</sup> Jorgji Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Prishtinë, 1970, f. 67.

<sup>110</sup> Si p.sh. te Theodor Haxhifilipi gjejmë: *me i mallëngjy-m-un*, *për të punu-m-un*, *me çu-m-un*, *me kthye-m-un* etj. Po kështu te Pashko Vasa gjejmë: *pri-m-un*. Te “Kopësht malsori” të Josif Bagerit gjejmë një formë *nda-m-un*, por më tepër format me -un: *lind-un*, *njft-un*, *çpik-un*, *mbet-un* etj.

<sup>111</sup> Si p.sh. në të folmen e Elbasanit, Polisit (për këtë të fundit shih në “Dialektologjia shqiptare V”, Tiranë, 1987 në punimin e Qemal Haxhihasanit *Vëzhgime rreth të folmes së Polisit*, f. 113.

<sup>112</sup> Prof. Shaban Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* (pjesa I dhe II), Prishtinë, 1980, f. 365.

<sup>113</sup> Shaban Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 945.

<sup>114</sup> Naim Basha, pun. i cit., f. 193.

<sup>115</sup> Qemal Murati, pun. i cit., f. 44.

<sup>116</sup> Asllan Hamiti, *E folmja shqipe e Karadakut të Shkupit* (disertacion doktorate në dorëshkrim), Shkup, 1999.

transliteruar ku do të na paraqiten disa forma të lidhore: “*Jemi fajtor vet tat njoftim, tat dhimsen, tat i boim temane, edhe ajuit shente urdhunumeja ta ta sosim” (në kuptimin: “Jemi të obliguar ta njohim perëndinë, ta respektojmë, t’i lutemi dhe t’i zbatojmë urdhërat e tij) II 10.*

c) **Përcjellorja**. – Trajta e pashtjelluar e përcjellores te Pulevski është ndërtuar me pjesëzën *tue / tu + pjesoren*, si në shumë të folme të tjera gege. P.sh. *jam tue shku*: II 134, *jam tu je shet pre olla* (jam tue e shit për të holla, jam duke e shitur për të holla) II 55, *jam toj mbjell* (jam tuj mbjell) etj. Në rastin e fundit kemi disa ndryshime fonetike: *tu > tu i > tui > tuj > toj*.

## 5.5. NDAJFOLJA

Gjatë përdorimit të ndajfoljeve, siç është e njohur, në pikëpamje morfologjike ndërmjet të folmeve shqipe nuk hasim ndryshime të mëdha. në shqipen e fjalorëve në spikamë na dalin po ato ndajfolje, të cilat kryesisht i dëgjojmë në grupin e të folmeve të gegërishtes qendrore, me disa ndryshime të karakterit fonetik e gabime individuale të autorit. Me interse më të madh gjuhësor në fjalorët na dalin ndajfoljet e kohës dhe ndajfoljet e vendit. Pa u thelluar në ndonjë shpjegim të tyre, po i japim disa nga to: *tashti*, *pares*, *pastaj*, *nka mëngjes*, *mesdit*, *sot*, *mram*, *gje*, *njesër*, *simvjet*, *vjet*, *ndë motimot*; *agje* (atje), *katu* (këtu), *ka*: (kha:, këtu), *andej* etj. Ja një periudhë në përbërjen e së cilës ka disa ndajfolje kohe: “*Pastaji laje krtollat, ta u pastrojn trolli nka ajo, mbasandaj zije dash pjeke, ataer edhe ndë vendi buk rugdojn*” (Pastaj laj patatet që të pastrohen nga dheu, ato mandej ziej ose pjeki dhe mund t’i përdorish (t’i hash) në vend të bukës) II 66.

## 5.6. PARAFJALA

Në lidhje me parafjalët kemi vërejtur disa gjëra karakteristike që do të ishin me interes për dialektologjinë shqiptare dhe për historinë e gjuhës. Këtu do t’i numëronim:

a) **Përdorimin e parafjalës *prë*** < për (këtë parafjalë Pula e shënën në formën *pre*, por kur dihet se ai nuk pati grafemë për ta shënuar /ë/-në e shqipes, mund të pohojmë se kjo parafjalë do të ishte shqiptuar në formën metatetike *prë*), si p.sh. *prë njerazi tona* (për njerëzit tanë), *prë olla* (për të holla) II 55, *prë farë* (për farë) II 67, *prë ushqemea* (për ushqim) II 53 etj.

b) **Përdorimi i parafjalës *ndë*** (në vend të formës *në*): *ndë moti sotis* (në kohën e sotme) II 3, *ndë libërti paras* (në librin e parë) II 3, *ndë ditin të pesit* (në ditën e pestë) II 7, *ndë kijo porumea tonte* (në këtë jetën tënde) II 11, *ndë uji* (në ujë) II 8 etj. Në faqen 124 të Fjalorit tregjuhësh kemi një varg shembujsh të tillë, si *ndë mu*, *ndë tu* (*ty*), *ndë neve*, *ndë ai*, *ndë aja*, *ndë ata* etj.

c) Parafjala nga përdoret në formën nka ose ka. Afër mendsh se te forma e parë (nka) kemi dukurinë fonetike të shurdhimit të [g]-së në [k], ndërsa te forma e dytë (ka) kemi aferezën e [n]-së apo edhe përngjashmimin e togut bashkëtingëllor [ng] në [k]. Pra kemi *nga > nka > ka*. Mirëpo, meqë e kemi të pranishme edhe trajtën *nka*, më i mundshëm shtë zhvillimi fonetik *nga > nka > ka*. Sido që të jetë, ne do t'i shënojmë disa shembuj të këtillë të nxjerrë nga fjalorët: *nga ma të nalti* (nga më i larti) II 3; *nka ftoft*, *nka vapa madhe edhe nka qeter keqmea* (nga të ftohtit, nga vapa e madhe edhe nga të këqijat e tjera) II 54; *nka dilli*, *nka neve* (nga ne) II 77, *nka trolli ndë dilli* (nga toka në diell) II 80 etj.

ç) Përdorimi i parafjalës ke, që rëndom në vend të saj shkon parafjala *te*, si p.sh. *ke aja* (te ajo) II 76, *ke kushi* (te kush) II 104 etj.

d) Përdorimi i rrallë i parafjalës më me elizion të [ë]-së > m: *m'tash jet* (në jetën e sotme, të tashme) II 12, *na po rojm m trolli ...* (ne po jetojmë në tokën...) II 16, *m'qeter vendi* (në një vend tjetër) II 24 etj.

## 5.7. LIDHËZAT

Për të lidhur dy gjymtyrë të një fjalie ose dy fjali ndërmjet veti, autori i fjalorëve përdor lidhëza bashkërenditëse dhe lidhëza nënrenditëse. Mirëpo, numri i tyre është mjaft i vogël krahasuar me pasurinë e madhe të lidhëzave që ka shqipja, Sa kemi hetuar, përdorim më të shpeshtë kanë lidhëzat bashkërenditëse. Nga to më dendur ndeshen lidhëzat këpujore, veçuese, kundërshtore, përmbyllëse, lidhëzat kohore, vendore, krahasore dhe kushtore:

a) **Lidhëzat këpujore**. – Lidhëzat *e, dhe* Pulevski i përdor shumë rrallë, ndërsa shumë shpesh lidhëzën **edhe**, si p.sh.: “*Clla ana u thon vshatumun edhe clla pa vshatumun edhe clla shkret diftomu*” (Cilave vende u thonë të banuara (të populluara), cilave të pabanuara dhe cilave shkret “në kuptimin pa gjallesa në to” dëftom mua) II 22. *Edhe ashtu* II 55. *Edhe reshper bojet edhe mjeshtër edhe vishillojtar* (Edhe tregtar bëhet edhe punëdrejtues edhe muzikant) II 55 etj.

Kemi gjetur edhe fraza me lidhëzat **as ... as**: *as du:l as perëndon* (në kuptimin as nuk lind as nuk perëndon dielli) II 71; *as opet nuk ritet as nuk vdesin* (as përsëri nuk rritet as nuk vdes) II 25. *Na kur u lëndim edhe vjem ndë ditin, nuk dijm asxha, as ta kuvendojm, as ta kndojm, as ta shkrujm, as ta shkojm* (ne kur lindim dhe vijmë në dritë, nuk dimë agjë: as të flasim, as të lexojmë, as të shkruajmë, as të ecim) II 14 etj.

b) **Lidhëzat veçuese**.- Nga ky lloj lidhëzash në paralelen shqipe të fjalorëve të Pulevskit përdoren: **a ... a, ja ... ja, apo ... apo**: *a vjet a muj; ja dit ja saat* II 80; *apo likura murg apo nka fisi të zezë* (apo lëkurë zeshkane apo nga fisi i zezakëve) II 37, 38 etj.

c) **Lidhëzat kundërshtore.** – Përdoren lidhëzat **por, po, veç**. Si p.sh. *por edhe granme* (por edhe ushqimi) II 15; *por, fforji të pastr rall gjindet* (por flori i pastër rrallë gjendet) II 28; *por na çish jemi fajtor* (por ne për çka jemi shkaktar) II 10; *por besa ...* II 14; *por kishte një ...* (por kishte një) II 54; *po për aja* (po për atë) II 50; *po si u thon* (po si u thonë) II 7, *po ajo asht* (po ajo është) II 11 etj.

ç) **Lidhëzat përmbyllëse.** – Për lidhëza përmbyllëse mund t'i marrim *preajo* (kalk nga maqedonishtja *zatova*) me kuptim e vlerë të lidhëzës *prandaj* II 77; formën *çe pre ajo* (ja prandaj) II 77; *po pre ajo* (po prandaj) II 79 etj.

d) **Lidhëzat nënrenditëse.** - Gjatë analizës gjuhësore, në idiolektin e Pulevskit, kemi hasur edhe disa lidhëza nënrenditëse, si

- lidhëza qëllimore **qi** (që) të afrikatizuar në **çi**: *çi ma shum ...* (që më shumë) II 40 etj.;

- lidhëza shkakore: **pse, prse** (përse), si në fjalitë *pse ashtu pas mend* (sepse ashtu ia ka marrë mendja) II 3, *prse ndë kji skaj po u maret vesht giuha të bugarisë* (sepse në këto anë nuk kuptohet gjuha bullgare) II 3; *pse vocat ...* (sepse fëmijët) II 4; *prse zhallurat ...* (sepse gjallesat) II 24; *prse po i pagojn ...* (sepse po i paguajnë) II 50 etj.;

- lidhëza kohore **kur**: *kur shajen njan me qeter* (kur shahen njëri me tjetrin) II 49, *kur ashtë shum ftoft* (kur është shumë ftohtë) II 29, *kur ta vje ajo moti* (kur të vijë koha) II 52 etj.

- lidhëza vendore: *agje ku s'ka mret* (atje ku s'ka mbret) II 52 etj.

- lidhëza krahasore **si**: *ata po rojn si egërsira* (ata po jetojnë si egërsira) II 36, si të mongolis (si të Mongolisë) II 98, *si verdhkuqa* II 38, *si drasa* (si dërrasa) II 54 etj.

- lidhëza kushtore **në > n**: *në kishte ndonjisen* (nëse kishte ndonjë send) II 52, *po n'di* (po nëse di) II 66, 67, 68; *edhe në po vjen* (edhe nëse vjen) II 37 etj.

## 5.8. PJESËZA

Në fjalorët e Pulës, me sa kemi hetuar, përdorim më të shpeshtë ka pjesëza **po**, që shërben:

a) Për të shprehur se veprimi i shprehur nga folja nuk ka përfunduar, por është duke u kryer ose është duke u zhvilluar në momentin kur flitet. Me këtë autori është përpjekur ta shprehë kategorinë morfologjike të aspektit kohor apo siç emërtohet “vidin” e foljeve që e ka maqedonishtja. Përdorimi i pjesëzës *po* para foljeve të kohës së tashme dhe të të pakryerës është i rëndomtë në shqipen (punoj – po punoj, punoja –

po punoja), ndërkaq në fjalorët e Pulevskit kjo pjesëz është shtrirë edhe në perfekt.<sup>117</sup> P.sh. *po rojn* (po rrojnë, po jetojnë) II 61, 62; *po ushqeen* (po ushqehen) II 65, *po na msuje* (po na mëson) II 68, *po shikojm* II 68, *po bajet* (po bahet, po bëhet) II 81, *po thojm* (po themi) II 87, *po kuvendojm* (po kuvendojmë, po bisedojmë) II 91, *po vjen* II 93, *po shkrunte* (po shkruente, po shkruante) II 93, 99 etj.

b) Pjesëza *po* në fjalorët e Pulës shërben edhe për të ndërtuar foljet njëvetore: *po thoin* (po thonë, ata thonë) II 13, 19, 81, 84, 86 etj. Por, në të shumtën e rasteve te foljet e këtilla autori pas pjesëzës *po* vë pjesëzën *u*, si p.sh. *po u dajen* (ndahen) II 80, *po u maret vesht* (merret vesh, kuptohet) II 89, *po u kthejet* (rrotullohet) II 72 etj.

Nga pjesëzat, përdorim shumë të dendur këtu ka edhe pjesëza **u** që u paravijet si foljeve për të sajuar format joveprore të foljeve, ashtu edhe formave veprare të foljeve, që këtë të fundit mund ta konsiderojmë si gabim të Pulës, si bie fjala: *u barojet* (mbarohet, kryhet, përfundon) II 29, *u njoftet* (njihet) II 37, *u punojet* (punohet) II 66 etj.

Nga pjesëzat e mohimit më shpesh përdoren format **nuk**, **s'**, **jo**, **mos** (përgjithësisht në formë të apokopuar *mo*): *nuk po çillojn dilli* (nuk po e shohin diellin) II 80, *njeraz egri nuk njoftin ...* (njerëzit e egër “e pacivilizuar” nuk njohin ...) II 36; *s'është mir* (s'është mirë) I 24, *z'boet* (s'bahet, s'bëhet) I 83, *s'mora vesht* (s'mora vesh, nuk kuptova), *s'e mar vesh* (nuk e mar vesh, nuk e kuptoj) I 95; *jo s'është* I 96; *mo bshtai* (mos pështyj), *mo ma mer* (mos ma merr) I 65, *mo vënë re* (mos e vërej) I 95, *mo shif* (mos shiko) I 95 etj. Kemi lexuar dy raste të pacunguar të pjesëzës së mohimit **mos**: *mos tut*, *mos u frik* I 90. Ja një periudhë me disa pjesëza: “*Po njerji kishte jo veç shtat, por edhe shpirt, clla s'ka vdekmea edhe nuk vdiqe jo, po prë ato mbas moti kur ta urdhnoje perëndi ...*” (Po njeriu ka jo vetëm shtat, por edhe shpirt që nuk ka të vdekur pa urdhëruar perëndia...) II 11.

I kemi vërejtur edhe disa pjesëza të tjera, të cilat shërbejnë për të krijuar forma të përbëra foljore, që u përmendën në shtjellimin e foljeve.<sup>118</sup> Me këtë rast, do t'i përmendim vetëm pjesëzën **të** (**t**), që shërben për të ndërtuar mënyrën lidhore të foljeve: *të shkikon* II 33; *ta kandojn*, *ta shkrujn* (të lexojnë, të shkruajnë) II 36, *le t'bojet* (le të bëhet) II 7 etj., pjesëzën **do**, me të cilën formohet koha e ardhme e mënyrës dëftore: *do t'mbarojë* II 123, *do t'msojm*, *do t'dritojn* (do të mësojmë, do të drejtojnë) II 4, *do t'u nxhallim* (do t'u ngjallim) II 11 etj.

## 5.9. PASTHIRRMA

Pjesa më e madhe e pasthirmave të gjithmbarshme që i gjejmë të përdorura në dy fjalorët e Pulës, janë të shkruara në Fjalorin katërgjuhësh nga faqja 75 deri në faqen 77, me titullin “Pozdravi” (Përsëndetje). Sipas numërimit tonë, këtu ka mbi 50 pasthirrma, nga të cilat shumica janë pasthirrma përsëndetjeje e falënderimi. P.sh. *Puna mbar!* (Puna e mbarë!), *Ullambar!* (Udha e mbarë), *Mbar paç!*, *Bomun shindet!*

<sup>117</sup> Për këtë më gjerësisht kemi bërë fjalë në kapitullin 1.4. Folja.

<sup>118</sup> Po aty, 1.4. Folja.

(Të fala), *Mirë mëngjes!*, *Mëngjesi i mirë!*, *Dita e mirë!*, *Mirë mrama!* (Mirë mbrëma) etj.

Përveç pasthirmave përsëndetëse e falënderimi, në tri faqet e përmendura të Fjalorit katërgjuhësh janë shkruar edhe disa pasthirma të tjera që shprehin ndjenja gëzimi e aprovimi, si *Të boftë mëjr!* (Të bëftë mirë!), *Me shindet!* (Me shëndet!), *Shyqyr zoti që u pam!* (në formën Shukur!), *Shum ti jem gëzoum!* (Shumë të jem gëzuar, shumë jam gëzuar!) etj.

## 6. VËZHGIME PËR PËRKTHIMIN, SINTAKSËN DHE LEKSIKUN E PARALELES SHQIPE TË KËTYRE FJALORËVE

U tha edhe më parë se Fjalori katërgjuhësh i Pulevskit është fjalor fjalësh, ku është shënuar fjala në shtyllën e sllavishtes (tani mund të themi e maqedonishtes) e pastaj në kolonën tjetër është dhënë përkthimi i saj në gjuhën shqipe, gjegjësisht në gjuhën greke e turke. Karakteristikë e këtij fjalori është se fjalët nuk janë shoqëruar me asnjë shënim tjetër përcjellës për përkatësinë gramatikore të fjalës, fushën e përdorimit, stilin e përdorimit etj., siç bëhet tani rëndom në fjalorët e këtyre shumëgjuhësh ose në fjalorët shpjegues.

Fjalori tregjuhësh, siç është thënë edhe më herët, është me pyetje e përgjigje të tëra, pra i tipit të fjalorit bisedues. Në sajë të mënyrës së tillë të hartimit të këtij fjalori, me fjali e periudha të tëra, kemi mundësi që, përveç çështjes së përkthimit e të leksikut, të vështrojmë edhe lidhjen sintaksore të fjalëve si dhe të fjalive në periudha.

Përkthimi, sintaksa dhe leksiku i fjalësve të Pulës mund të jetë edhe temë shqyrtimi më vete, ngase siç dihet, autori ka qenë njohës i disa gjuhëve sllave e josllave dhe nuk ka mundur t'i ruajë të paprekura kodet gjuhësore të gjuhëve që i ka ditur, por përkundrazi te ky na del shumë qartë në shesh dukuria e ndikimit ndërghjuhësor. Prandaj, kjo temë sociolinguistike është me interes të trajtohet. Dukuria e interferencës gjuhësore te individët shumëgjuhësorë është e njohur në gjuhësinë e zbatuar. Ne me këtë rast do të përpiqemi t'i vijëzojmë veçoritë themelore të përkthimit, sintaksës si dhe të leksikut të idiolektit shqip të Pulevskit.

Marrë në tërësi, fjalitë shqipe janë përkthim nga paralelja e tekstit në gjuhën sllave. Ka raste kur ky përkthim, çoftë në Fjalorin katërgjuhësh, çoftë në Fjalorin tregjuhësh, është i qëlluar, kuptohet me bazë gjuhësore të të folmes së Dibrës me rrethinë, nëse ua heqim këtyre gabimet e shumta gjuhësore të natyrës grafike, fonetike, fonologjike e morfologjike, të cilat u trajtuan në krerët përkatës. Në fjalorin e fjalëve, përkatësisht në Fjalorin katërgjuhësh përkthimin e kemi më të mirë. P.sh.: sllavisht *reka, reku* – shq. *lumi*, sll. *potok* – shq. *prua, proa* I 16; sll. *mostovi* – shq. *urat* I 18, sll. *jazovi* – shq. *vijat* I 18; por kur Pulevski ka krijuar tekst, kuptohet në Fjalorin tregjuhësh, ai aty është më pak i suksesshëm: sll. *znanja na mnogu jezika* – shq. *ma shum giuha ta dijm* (njohja e shumë gjuhëve) II 3 etj.

Por, megjithkëtë, fund e krye fjalorët i karakterizon përkthimi “robërisht besnik” (ad literam), që e dëmtoi shumë tekstin shqip të fjalorëve. Kështu, Pulevski krijoi trajta e konstrakte të pamundshme në shqipe. Kjo mund të vërehet gjithkund në tekstin e Fjalorit tregjuhësh. Krahaso: paralelen në gjuhën sllave “*Za tova treba da se zbered od svi napred rečeni narodnosti po 4-5 ludi učeni, koji go poznavajed jezikod majčin čisto.*” me atë në idiolektin e tij shqip “*Prë ajo duhet ta u mbledhim nka njerazisë shkipinisht nka xhithë fisat nka 4-5 njerji msoum, cili poenjofin giuha te nonas pastër*” II 124. Ose: “*No, kako biduvad den i noç, koga je taka kako çto velish, kazhi mi*” – “*Apo si bojet dit edhe natn, kur ashtë ashtu si çush e tha, diftom mu*” II 71. “*Drugi biduvajed lovxhiji i lovad zhivotinje i ribi, pak ji prodavajed i za parite si*



*kupuvajed zhito i drugi potrebi za da se ranad i oblekuvajed*". - "Qetër u bojet gjotar edhe gjonte zhallura edhe peshka, opet po e shesin edhe prë ollat bjen drith edhe qetër çish po e duhet po prë ta ushqeen edhe ta veshin". II 55 etj. etj.

Për mosnjohjen e natyrës së shqipes si dhe bastardimin e saj nga ana e autorit dëshmojnë mjaft qartë edhe përkthimi i disa përshtatjeve dhe i shprehjeve përshtatëse në faqet 75-78 të Fjalorit katërgjuhësh, si bie fjala: "E ka kallzova shindet me të gjith" (për: Keni të fala nga të gjithë, të gjithë iu kanë përshtetur.). *Kija ka bone shindet* (për: Ai të ka përshtetur). *Prune shindet, bone shindet* (për: I bën të fala). *To boftë mir fituum* (p.sh. si kalkim: Të bëftë mirë fjetja, gjumi; përkatësisht sipas natyrës së shqipes: Gjum të rehatshëm). *Moti shkofsha* (për: vjet, vitin e kaluar) etj.

Ka fjali ku edhe kuptimi (semantika) i tyre është mjaft i errët, si p.sh.: "Të thati gjikunde edhe xhithi apo gjith se si ashtë nuk" II 20; Pyetje: "Prse bojet ndë venden edhe po nuk ashtë pemna sesi gjikunde?", Përgjigje: "Nka ato bojet nja nka trolli prse nuk ashtë gjikunde se si qeter nka brezi eras" II 22 etj., etj.

Në këtë shqipe të çoroditur, përkatësisht në këtë idiolekti të çoroditur të Pulevskit, ndodh që edhe fjalët të përkthehen gabimisht, dhe për pasojë të ketë humbjen e mesazhit të tërë fjalisë, si "Cilj madem, jan mashum marunvesht edhe mashum të duhet prë neve" II 26 ... Për të kuptuar domethënien e fjalive të këtilla, lexuesi do të detyrohet ta lexojë fjalinë gjegjëse edhe në gjuhë të tjera të përfaqësuara në fjalorë. Me këtë rrugë, kuptuam se fjalia e saposhënuar ka këtë mesazh: *Cilat xehe janë më të përhapura* (gjenden në sasi më të mëdha në tokë) dhe më të nevojshme?

Sasia e çrrgullimeve të këtilla semantike, përveç pështjellimeve të tjera të shumta gjuhësore (fonetike, fonologjike, morfologjike, sintaksore) është shumë e madhe, zaten e kanë përfshirë tërë idiolektin shqip të Pulevskit. Ja edhe disa përkthime fjalësh pa përputhshmëri semantike: sll. *najposle* – shq. *ma posht vend* (do të duhej: më në fund) I 88; sll. *Bllagovec* – shq. *amëlzani dita* (kalk nga "bllago" – ëmbël) I 13; sll. *bllagodarim* – shq. *të çofsha, të paça* (për: falënderit) I 77; sll. *jug* – shq. *mesdit* (për: jug); *rugdoni* (për shërbehuni, merrni diçka për të ngrënë ose për të pirë); *bjemun* (për: përkthyer); *besoshin ashtë* (për: beson se..., i bindur është) II 153; *navoi* (për: fatkeqësi, pafatësi) II 12 etj.

Përveç ngatërtimeve të shumta që u përmendën deri më tani, në faqen 92 të Fjalorit tregjuhësh kemi hetuar një përpjekje të vogël të autorit për t'iu shmangur përkthimit të fjalëpërfjalshëm dhe për të bërë njëfarë përshtatje tematike ose të mbajë një origjinalitet tematik, varësisht nga gjuha në të cilën shkruan. Kështu, kur bën fjalë për huazimet leksikore në të tri gjuhët (në gjuhën maqedonase, shqipe e turke) shënon leksema krejtësisht të tjera. P.sh. në kolonën e maqedonishtes shkruan: "Tugji zborovi se ami, frishko, onomad, par i priçija". Në kolonën e shqipes shkruan: "Vetmi fjal jan jeshil, kapacina, profet edhe kallo". Pastaj vazhdon më tutje, duke i shpjeguar këto huazime, varësisht nga gjuha dhe fjalët që i ka shënuar për të huaja, si maq. *ami* – thotë se është fjalë greke, ndërsa në shqipen: "jeshil ashtë fjal turqisht, apo na thom verdh" dhe kështu vazhdon më tutje.

Si njohës i përciptë i disa gjuhëve, si duket, Pulevski me belbëzimin e tij në shqipe është shembull tipik i përzierjes gjuhësore. Në këtë pikëpamje, shumë gjurmë të

gjuhëve sllave shihen në gjuhën e shkruar shqipe të këtij autori; gjurmë të shqipes në idiolektin e sllavishtes së tij, por edhe gjurmë të greqishtes e të turqishtes në dy gjuhët e përmendura. Praktikiisht, gjuha e Pulës është **një amalgamë gjuhësore sllave - shqipe - greke - turke**. Kjo përzierje gjuhësore vërehet në të gjitha rrafshet, si në fonetikë e fonologji, morfologji, leksik e sintaksë. krahaso paralelen sllave me atë shqipe: “*Starite ludi napred ubivale zhivotinje i od mesoto zhivotinjsko se ranile a so kozhite od zhivotinjeto se oblekale*” – *Njerazi të vjetër nka para e u vravan zhallura edhe nka mishin zhallurisë e ushqeshin*” II 57. Në këtë periudhë të togfjalëshi “*mesoto zhivotinjsko*” hetohet ndikimi i shqipes në sintaksën e maqedonishtes, sepse në maqedonisht mbiemri – përcaktori përdoret para emrit të përcaktuar, pra sipas natyrës së maqedonishtes do të kishim “*zhivotinsko meso*” e në shqip “*mish gjedhash, mish kafshësh*”. Për ndikim leksikor mund ta marrim përkthimin “*njerazi të vjetër*” si kalk nga maqedonishtja “*starite ljudi*”, ngaqë në shqipen duhej të ishte “*njerëzit e egër a të pacivilizuar*”. “*Faqe, të trollis, krkunde ashtë grijtun, edhe nalt, apo krkunde, ashtë, u hoq, agje, ku ashtë, u ngritun, trolli, that, ashtë, sëi thatsira, apo kuashtë, uhoq, plot, ashtë, menji*” e në paralelen maqedonase “*Liceto, od zemjave, nekade je, izdignato, suva zemlja je, ili, suvota, a kade je, zgrofnato, plno je so roda*” II 18 etj.

Ndikimi i maqedonishtes në sintaksën e shqipes së fjalorëve në shqyrtim vërehet më së shumti në vendin e përcaktorit dhe gjymtyrës së përcaktuar. Kështu, sipas natyrës së gjuhës shqipe në ligjërimin asnjans përcaktori (cilësori, mbiemri, atributi) vihet rregullisht pas fjalës së përcaktuar, përveç në disa raste kur cilësori do të vihet në spikamë ose për qëllime stilistike në letërsinë artistike (zog i shkretë – i shkreti zog). Në konstrukte të këtilla disa herë kemi hetuar përdorimin e përcaktorit para gjymtyrës së përcaktuar, të cilën e konsiderojmë për analogjike me të maqedonishtes. P.sh. *vogl zhallura – sitni zhivotinje* (për gjallesat e imta) II 18, *thati trollis – suvota zemlja* (për: tokë e thatë) II 20, *qetër shumë – mnogu drugi* (për: shumë të tjera) II 25, 32, 35, 56 etj.; *ran mademi – teshka ruda* (për: xehe e rëndë) II 27, 54, 56; *ma fort enten – najaki sudovi* (për: enë më të qëndrueshme) II 28; *ma madhe peshka – pogolemi ribi* (për: peshq më të mëdhenj) II 35; *fort shtëpija – jaki kuqi* (për: shtëpi të forta, shtëpi të ndërhuara me material të fortë) II 54, 55 etj.

Nuk është i vogël edhe ndikimi sintaksor i shqipes në paralelen e shkruar të maqedonishtes. Në maqedonishte, siç u theksua, rëndom përcaktori përdoret para gjymtyrës së përcaktuar, e në gjuhën shqipe topika e tyre është e anasjelltë. Nisur nga kjo, konstruktet si: *svetila mali* (dritin vogël, drita të vogla) II 7, *svetilata nebesni* (dritin të çillas, dritat e çielit; përkatësisht dielli, hëna dhe yjet) II 7, *kitovi morski* (balenat e detit) II 8; *ribite morski* (peshqit e detit) II 9; *pilcite nebesni* (zogjtë e qiellit) II 9; *dushi nashji* (shpirtërat tanë) II 10, *rodninjeto nashi* (fiset tona) II 14; *ruda bela* (xehe e bardhë) II 28 e shumë shembuj të tjerë.

Në faqen 33 të Fjalorit tregjuhësh në maqedonisht kemi lexuar: “*Çaji je bilka od niski rastenija ...*”, ku emri *çaji* në rolin e kryefjalës ka një shquese **-i** të gjuhës shqipe. Në maqedonishten, sipas rregullave ky emër në trajtën e pashquar është në formën *çaj*, ndërsa në të shquarën *çajot*. Në fjalinë në shqyrtim ky emër duhej përdorur në trajtën e shquar *çajot*. Trajtën *çaji* në maqedonishte e kemi parë edhe në II 34, të cilën e kemi marrë për ndikim të shqipes në një shquese.

Në bazë të studimeve gjuhësore është përdëftuar se forma më e shpejtë dhe më masive e ndikimit ndërgjuhësor është huazimi leksikor.<sup>119</sup> Kështu, edhe në fjalorët e Gjergjit, në ndikimet ndërgjuhësore që janë pasojë e plurilinguizmit individual të autorit, në të gjitha rrafshet, padyshim leksiku zë një vend mjaft të rëndësishëm. Aty do të gjejmë një numër të madh fjalësh që janë të përbashkëta për shqipen, maqedonishten, turqishten e greqishten si dhe për gjuhët e tjera ballkanike; pastaj huazime leksikore sllave në gjuhën shqipe, albanizma në paralelen e maqedonishtes, orientalizma e greqizma në shqipen e sllavishten etj. Me këtë rast nuk do të shtjellojmë këtë çështje në mënyrë të shtruar, por do të mjaftohemi vetëm me paraqitjen e disa huazimeve leksikore të vëna re në fjalorët e Pulevskit.

Ja disa huazime leksikore sllave në shqipen e fjalorëve të Pulevskit: *srma* (argjend) II 28; *madem, maden, ruda* (xehe) II 25, 28; *opet* (përsëri, rishtas) II 18, *kipat* (balenat) II 8, *allat* (mjet, vegël) II 26, *korav* (i egër, i thyeshëm, joelastik) II 26, *kozhok, kozhuf* (gëzof) I 30, *bivlic* (buallicë) I 41, *zhab* (bretkosë) I 51, *kral* (mbret), *ogradar* (punues i rrethojave kopshtare) I 56; *tërkall* (rrotë) I 57, *çasha* (gotë) I 87, *komshi* (fqj) II 103 etj. Mirëpo, vlen të theksohet se në paralelen shqipe të fjalorëve të Pulës ndeshim më pak sllavizma sesa në gjendjen e sotme të të folmes shqipe të Dibrës dhe të qarkut të saj. Kjo do të thotë se përgjithësisht sasia e sllavizmave në të folmet shqipe në Maqedoni dikur (në rastin tonë në shekullin XIX) ka qenë më i vogël sesa sot dhe se numri i tyre është shtuar proporcionalisht me rrjedhën e kohës.

Në gjuhën shqipe të fjalorëve të Pulevskit ka një numër të konsiderueshëm huazimesh leksikore orientale, si p.sh. *ikram* (kujdes, përkujdesje) II 11, *tamin, tahmin* (kuturu, jo saktësisht) II 14; *ise, hise* (pjesë, pjesëmarrje në diçka), *ada* (ishull) II 20; *azar, hazër* (gati) I 87, II 30; *jeshil* (i, e gjelbër) II 31, *teneqe* (llamarinë) I 20, *terzi* (rrobaqepës) I 20, *penxhere* (dritare) I 34, *saatçi* (orëndreqës), *eqim* (mjek) I 56, *shart* (rregull, ligj, parim) I 58, *nishan* (shenjë) I 61, *zengin* (i pasur) I 69, *xhenaze* (kufomë) I 74, *jabanxhi* (i huaj) I 74, *dakik* (minut) I 85, *imza* (nënshkrim) II 101, *sheherli* (qytetar) II 107, *zehër* (helm) II 27, *asker* (ushtar) I 56; *haps, aps* (burg) I 56 etj. Përgjithësisht, mund të thuhet se pjesa më e madhe e këtyre orientalizmave edhe sot e kësaj dite përdoren në të folmen e Dibrës e më gjerë, por këta dy fjalorë nuk janë shumë të vërsuar me orientalizma. Ndonjë prej tyre tani më ka kaluar në leksikun pasiv të shqipes dhe janë historizma, si fjalët *eqim, imza* etj.

Ndikimet ndërgjuhësore të gjuhëve në kontakt nuk bëhet vetëm në njërën kahje. Nga kjo rrjedh se edhe shqipja ka ndikuar në leksikun e sllavishtes së Pulevskit. Do t'i regjistrojmë disa albanizma që kemi mundur t'i hetojmë në paralelen e maqedonishtes së fjalorëve të Pulevskit: *farosh* (enë ku ruhen farat) I 34; *specare* (enë ku ruhet biberi i specave) I 35, *brek, breg* I 17; *musteqi, mustaqi* I 21, *vatra* I 38, *lopar* (bari lopësh), *plluk, pllug* I 57; *leshta, lesha, leshi* I 49, *përç* II 93, *buzi, buzët* II 37, *kokar* (ndoshta nga kokërr ose kokë, meqë qepujka del në kokë, në krye të qepës, qepujkë) etj.

Edhe greqishtja merr pjesë në interferencën gjuhësore të gjuhëve të përfaqësuara në fjalorët e Gjergjit. Për greqizma i kemi konsideruar fjalët *metron* (matë, peshon) II 16, *gjoll* (liqen) II 18, *as, aspër* (para, monedhë) II 28, *kallogjer* I 25; *pras, praz* I 50, *daskall* (mësues) I 59 etj.

<sup>119</sup> Vejsel Nuhiu, *Ndikimet ndërgjuhësore*, Prishtinë, 1990.

Pas gjithë kësaj që u tha, do përmendur se huazimet leksikore përbëjnë një nga veçoritë leksikore të gjuhës së fjalorëve të Pulevskit. Megjithkëtë, karakteristikë kryesore e leksikut të shqipes së fjalorëve të tij është ajo se autori për nevojat e përkthimit më tepër krijoi fjalë të reja (neologjizma) sesa që huazoi.

Edhe përkundër faktit se fondi leksikor i fjalësve të këtij autori është mjaft i varfër, Pulevski nuk diti të shfrytëzojë pasurinë e madhe e të pashterrshme të fjalëve shqipe. Ai për nevojat e përkthimit ndonjë fjalë e ka përdorur me vend, por shpeshherë krijoi edhe shumë fjalë të tjera në mënyrë artificiale: disa nga to janë kalke, disa krijim i paqëlluar i autorit me brum të shqipes, shpeshherë emërzoj folje etj. Sasia e fjalëve të këtilla është shumë e madhe, por ne do t'i shënojmë vetëm disa nga to që na u dukën më interesante, si *thatiuis* (ujëtokësorët) II 35, *çerrexhi* (qerrepunues), *bukatar* (bukëpjekës) I 56; *dhentar*, *delar* (delmer) I 55, 93; *fjorar* (artar, argjendar) I 56, *peshkëzintar* (peshkatar) I 56, *kart çoar* (kolporter, postier); *ka kor*, *ka korr* (korrës), *eshkatar* (qymyrxhi), *derrar* (bari derrash); *vorxhi*, *vorrxi* (mihës i varreve, varrgërryes, varrmihës) I 56, *çamena* (ankesa) I 68, *në gjims moti* (njeri në moshë mesatare, në gjysmë të jetës së tij, 30-40 vjeç) I 70, *bjevar* (blerës, konsumator) I 88; *shkrujtar*, *libërtar* (shkrimtar, autor librash) II 56, *shkruitar kanga* (shkrimtar këngësh, poet) II 121, *vishillontar* (fishkëllues, muzikant), *ritetun* (bimët) II 59; *pamarvesht* (i paarsimuar, i paditur) II 60, *pajtoshar* (kontratues, palët që lidhin kontratë) II 101; *kuvisor*, *thoishtor* (kontratë) I 96; *shkruitar* (sekretar) II 109, *shkronjisora* (alfabeti) II 110, *msujesori* (shkencë, dije) II 122, *çelznica* (çelësndreqëse, punëtori për ndreqjen e çelësave) I 33, *liberti vrtetun çashtus* (libri i verifikimit të gjërave, i konfirmimit të të vërtetave, pra libri i historisë) II 33; *kaurat*, *kaurrat* (gaforret) II 35; *lentor*, *pçellme* (pjellore, frytdhënëse) II 22, 61; *pajtomea* (çmimi) II 28, *paradiftoshin* (profet) II 32, *kartë kallzumea të fala* (letër përshëndetëse, kartë postale) II 94, *telin shkronja* (telegram) II 96, *fajtor vet* (dorëzan, zhirant) II 100, *fajtorvet* (borxhli), *dhimsetar* (të mëshirshëm, mëshirues) II 37, *gojas amle* (gojëmbël) II 37, *shokunismet* (shoqërimet) II 49, *mishishitme* (mishtore) I 19, *shesmuntar* (shitës) I 88, *endejtmeja* (foleja, çerdhja), *voci mretit* (biri i mbretit, princi) I 53, *koka askerit* (vojvoda, prijësi, komandanti) I 53, *bomun faq* (dyfytirësi) I 81, *faqe* (personalitet), *granmea* (ushqimi), *ipmea* (kalurimi) II 156, *besoshin ashtë* (i bindur është) II 153, *gjizar* (njeri që ka për profesion përpunimin ose shitjen e gjizës) II 152, *vetzani* (zanore) II 116, *emin edhe prmi emin* (emrin dhe mbiemrin) II 109, *shkelmea* (shkallët), *deshur* (rrobat), *murar* (murator) I 99, *krtolla* (patate), *pashmea* (drita) II 76, *ujtor* (enëlarëse, orendi shtëpiake ku lahen enët) II 92, *brinjiundas* (rinoqer) II 60, *zhallishkrujtor* (jetëshkrues, biograf) II 58, *ulindmeja* (fruti), *drejtumea* (të drejtuarit, qeverisja, jurisipodenca), *epmea* (tatimi), *tufalshin* (shkathtësi, prirje, aftësi e lindur) II 36, *pou gjeg* (piqet) II 31, *pektun* (lëgurë metalesh, bashkëshkrirje) II 29, *trullin shkrumea* (gjeografia), *larojtar* (lavrues, bujk), *rugdoni* (shërbehuni) etj.

Përgjithësisht, edhe fusha e leksikut, si edhe e rrafshëve të tjera gjuhësore pasqyrojnë gjuhën e një individi. Ajo nuk e paraqet me besnikëri shqipen e folur të shekullit XIX në anët e Maqedonisë perëndimore. Megjithë shumë pështjellime, gabime e paqartësi që ka gjuha e këtij autori, ajo mbështetet në të folmen e Dibrës dhe të qarkut të saj.

Tipar tjetër i leksikut të shqipes së fjalorëve të Pulës është edhe përdorimi i herëpashershëm i sinonimeve për të shpjeguar e qartësuar më mirë fjalët. Kjo mund të konsiderohet edhe si përpjekje e autorit për t'i kapërcyer kufijtë vendorë dhe vepra të ketë karakter më të përgjithshëm e përdorim më të gjerë. Ja disa sinonime të shënuara në Fjalorin katërgjuhësh e në Fjalorin tregjuhësh: *koka, krea, kaptina* I 21; *qime, flok* I 21; *tamlë, qumsht* I 39; *gati asht, azër* I 40; *gomar, magjar* I 40; *petrit, skifter* I 45; *livoshka, likura* I 45; *kaprull, dree* I 47; *dhelbun, skile* I 48; *dac, maçurek* I 48; *xhamxhi, qelqexhi* I 55; *rafme, liftome* I 58; *kartë, letra* I 60; *tat, ati, baba* I 63; *kumri, gugushka* I 44; *cuc, çup, gac* I 70; *djal, çun, voc* I 70; *mos u frik, mos u tut* I 80; *vështro, çillo* I 34; *punc, bunar* II 16; *gropa, vrima* II 16; *prëpjet, tërma* I 17; *katund, vshat* I 17; *robe, petka* I 29; *fjal, kuvend, llaf* I 81 etj.

## 7. LARMIA DIALEKTORE E SHQIPES SË FJALORËVE

Gjatë shtjellimit të grafisë si dhe veçorive fonologjike e fonetike të paraleles shqipe të dy fjalorëve shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit na dolën në shesh një numër i madh veçorish gjuhësore që e karakterizojnë tekstin shqip në spikamë. Që të mos përsëritemi me çështjet që u thanë deri më tani, ose me gjërat që do t'i themi në kapitujt vijues për veçoritë morfologjike e leksikore të shqipes së këtyre fjalorëve, do të mjaftohemi vetëm në përcaktimin e bazës dialektore të kësaj gjuhe. Renditja e tipareve dialektore të shqipes së këtij autori do të na shtynte vetëm në një përsëritje të shumë dukurive gjuhësore që u përmendën deri më tani, andaj, asaj që është thënë deri më tani mund t'i shtojmë vetëm përcaktimin dialektor të shqipes së fjalorëve në studim.

Për të nxjerrë përfundime të drejta vlejné të përmenden disa fakte nga jeta dhe veprimtaria e Gjergjit. Kështu, nga shkrimet shqipe që ka lënë trashëgim, mund të konstatohet se Pulevski nuk e ka njohur mirë as edhe ligjërimin dialektor të shqipes. Ishte autodidakt dhe sipas gjithë gjasash pa njohuri për traditën e shkrimit të letrave shqipe. U end mjaft dhe nuk qëndroi për një kohë të gjatë as në vendlindje e as në ndonjë vendbanim tjetër. I ati e mori me vete në Rumani qysh kur Gjergji kishte vetëm shtatë vjet. Pati kontakt me shumë individë, pjesëtarë të të folmeve të ndryshme të shqipes. Njohu disa gjuhë ballkanike dhe tek ai u reflektua dukuria e ndërndikimit gjuhësor.

Nga jetëshkrimi për Pulevskin gjetëm mbështetje dhe arsyetim të tipareve dialektore të gjuhës së tij. Përgjithësisht, gjuha e Pulevskit është mjaft e larmishme nga aspekti dialektor. Duke e krahasuar shqipen e shkruar në Fjalorin Katërgjuhësh si dhe në Fjalorin Trigjuhësh me studimet dialektore për disa të folme shqipe, të përafërta me gjuhën e fjalorëve në shqyrtim, kemi ardhur në përfundim se:

a) Bazën dialektore të gjuhës së Pulevskit e përbën e folmja e vendlindjes së tij (e folmja e Rekës së Dibrës). Këtë e dëshmojnë, si bie fjala, mospërdorimi i fonemës /y/, përkatësisht zhbuzorëzimi i saj në /i/ dhe diftongimi dytësor i saj; shpërbërja dytësore e zanores së theksuar [i] në [ëi] dhe e [u]-së në [ou]; mosshqiptimi i ndër hundshëm i zanoreve që gjenden ose janë gjetur pranë bashkëtingëlloreve hundore; dallimi i gjatësisë së zanoreve: në zanore të shkurtra e të mesme kundrejt zanoreve të gjata; rënia e faringales [h] në të gjitha pozitat e fjalës; defonologjizimi i kundërvënies ndërmjet çiftit të tingëllueseve dridhëse /r/ e /rr/; mosafrikatizimi i qielzoreve [q, gj]; ruajtja e grupeve të bashkëtingëlloreve [mb, nd, ng] përgjithësisht të parrëgjua; qiellzorëzimi i shpeshtë i prapagjuhores [g] në [gj]; mbizotërimi i zhvillimit të grupeve [pl, bl, fl] në [pj, bj, fj]; qiellzorëzimi i grupeve të vjetra konsonantike [kl, gl] në [q, gj] dhe mosafrikatizimi i tyre; etj.

b) Prania e një numri të konsiderueshëm veçorish gjuhësore tipike për toskërishten, si: përdorimi i /ë/-së në rrokje të theksuar; rotacizmi, shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në pozitë fundore të fjalës; shquarsia e emrave të gjinisë mashkullore që mbarojnë me temë në bashkëtingëlloret [k, g, h] me mbaresën -u; e pakryera asigmatike e foljeve në formën veprorë; përdorimi i lidhores e jo i paskajores gege, përdorimi i pjesoreve të toskërishtes si dhe shumë veçori të tjera.

c) në tekstet shqip të fjalorëve të Pulevskit aty-këtu hetohen edhe disa tipare të folmeve të tjera të gegërishtes (e jo të të folmes së qarkut të Dibrës), veçmas të të folmeve të rrethit të Gostivarit e të Kërçovës, të cilat për nga sasia janë më të pakta. Zaten, shpeshherë vërehen veçori që janë karakteristike për grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore si dhe për disa grupe të tjera të folmesh, si p.sh. buzorëzimi i [a]-së hundore të mbarë gegërishtes në [o]; monoftongimi i grupit [ue] në [u:], afrikatizimi i bashkëtingëlloreve mesgjuhore [q, gj] në [ç, xh]; përngjashmimi i rrallë i grupeve [mb, nd, ng] në [m, n, g e k]; qiellzorëzimi i grupeve të bashkëtingëlloreve [tj] > [q] e [dj] > [gj] etj.

Në bazë të vëzhgimit filologjik, përmbledhtas, mund të themi se shqipen e fjalësve të Pulevskit e karakterizojnë:

a) tipare fonetike e fonologjike, morfologjike e leksikore të të folmes së qarkut të Dibrës, të cilat mbizotërojnë;

b) tipare dialektore të të folmeve të tjera gege, që bashkëpërkojnë veçmas me të folmen e Gostivarit e të Kërçovës;

c) veçori dialektore të toskërishtes, dhe

ç) kalke, huazime e krijime fjalësh artificiale që nuk përkojnë me asnjë të folme shqipe.

## PËRFUNDIM

Objekt shqyrtimi i këtij punimi është ligjërimi shqip, më saktësisht idiolekti shqip i Gjorgji Pulevskit në dy fjalorët shumëgjuhësh: I. Fjalorit katërgjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht-greqisht, Beograd, 1873; dhe II. Fjalorit bisedimor trigjuhësh: maqedonisht-shqip-turqisht, Beograd, 1875. Vëzhgimin tonë filologjik të paraleles shqipe të fjalorëve të Pulevskit e kemi mbështetur mbi botimin në origjinal të të dy fjalorëve.

Në analizën gjuhësore të shqipes së dy fjalorëve të Pulevskit kemi zbatuar metodën klasike filologjike, veçmas metodën e analizës, të sintezës, metodën krahasimtare, metodën statistike etj.

Vepra “Paralelja shqipe në dy fjalorët shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit” përmban një pasqyrë të të dhënave bio-bibliografike për autorin, pasqyrën e punimeve më të rëndësishme për jetën dhe veprimtarinë e Pulevskit, një vështrim për strukturën e fjalorëve dhe rëndësinë e tyre, dhe më pas shqyrtohen tiparet grafike, dukuritë fonetike e fonologjike të shqipes së fjalorëve, çështje të përgjithshme për përkthimin, sintaksën dhe veçoritë leksikore të gjuhës së Pulevskit. Pastaj e kemi parë shqipen e fjalorëve nga aspekti dialektor dhe në fund në mënyrë të përmbledhur kemi bërë një përmbyllje (rezyme). Meqë Pulevski dhe dy fjalorët e tij janë pak të njohur në opinionin shqiptar, punimit si material ilustrues ia kemi bashkangjitur disa faqe nga të dy fjalorët.

Gjorgji, emrin e të cilit e gjejmë të shënuar në disa variante: Gjorgjo, Gjorgjija, Gjorgje, Gjergj; dhe me mbiemrin Pulevski e Pula ishte leksikograf, poet, historian, mbledhës i folklorit, gramatikan dhe luftëtar i dalluar kundër perandorisë Osmane për çlirimin e popujve të robëruar. Pulevski qe autodidakt, me profesion murator, ose siç parapëlqente t'i thoshte vetes – arkitekt.

Lindi në Galiçnik më vitin 1838, katund i Rekës së Vogël në qarkun e Dibrës. Viti i lindjes së Pulevskit vihet në dyshim, me supozim se ai duhet të ketë lindur së paku 15 deri më 20 vjet më parë. Sido që të jetë, lindi dhe vetëm fëmijërinë e hershme (shtatë vjet) e kaloi në qarkun e Dibrës, ndërsa pjesën më të madhe të jetës e kaloi në Beograd e Sofje, mori pjesë aktive në luftën e bullgarëve dhe të rusëve kundër turqve. Nga tiparet gjuhësore hetohet se pati kontakte të shpeshta me shumë shqiptarë visesh të ndryshme.

Gjorgji Pulevski shkroi dy fjalorë shumëgjuhësh: I. Fjalor katërgjuhësh: sllavisht-shqip-greqisht-turqisht, Beograd 1872 dhe II. Fjalor Tregjuhësh: sllavisht-shqip-turqisht, Beograd, 1874. Fjalorët në shqyrtim dallohen mjaft njëri nga tjetri si në strukturë, ashtu edhe në metodën e mbarështrimit, në grafi etj. Fjalorin katërgjuhësh mund ta quajmë në një mënyrë si fjalor të mirëfilltë. Në kolonën e parë janë shënuar fjalët në maqedonisht e pastaj në kolonat gjegjëse për gjuhët e tjera është dhënë fjala e përkthyer. Këtu nuk kemi fare të dhëna për përkatësinë gramatikore të fjalës, as për shumkuptimësinë e fjalëve, figurshmërinë e tyre, fushat e përdorimit etj., por janë dhënë vetëm fjalët pa shënuar asgjë pas tyre.



Fjalori katërgjuhësh ka afërsisht 2.560 fjalë e shprehje shqipe, por duke marrë parasysh se ka raste kur një fjalë e vetme na paraqitet me forma të ndryshme, ky fond fjalësh është më i vogël. Ky fjalor ka 98 faqe të formatit 14 x 17 cm. Fjalori është i ndarë në 74 qerdhe fjalësh, me sfera leksikore të ndryshme. Fjalori trigjuhësh (Fjalor nka tre g-juha) është i formatit 14 x 20 cm me gjithsej 162 faqe tekst të shkruar me pyetje-përgjigje në tri kolona: maqedonisht, shqip dhe turqisht me fjali e periudha të tëra.

Dy fjalorët shumëgjuhësh të Pulevskit, vështruar në tërësinë e trashëgimisë tonë leksikografike, edhe pse nuk meritojnë të zënë ndonjë vend qendror, por për periudhën kohore në të cilën u botuan, meritojnë të përmenden në kuadrin e fjalorëve shumëgjuhësh të kohës dhe përgjithësisht të shënohen në historinë e leksikografisë shqiptare. Të dy fjalorët e Pulevskit, vështruar në retrospektivën kohore, patën rëndësi relativisht të madhe, ashtu si edhe çdo fjalor tjetër shumëgjuhësh. Këta Fjalorë, gjithashtu na sigurojnë një material të vlefshëm (por jo autentik) për të parë ndikimet ndërgjuhësore në shekullin XIX ndërmjet disa gjuhëve ballkanike. Dy fjalorët kanë edhe njëfarë vlere historike për shkencën albanologjike, veçmas për gjuhët dhe kulturat ballkanike në përgjithësi.

Alfabeti që e përdori Pulevski qe fonematik i plotësuar me alfabetin rrokjesor. Përgjithësisht mund të thuhet se fjalët i shkroi sipas parimit fonetik, sipas të cilit fjalët shkruhet ashtu siç shqiptohen dhe lexohen ashtu siç shkruhen. Në shkrim, siç dihet, fonemën e përfaqëson grafema, andaj në këtë vëzhgim gjuhësor do të flitet për grafinë e Pulevskit. Përgjithësisht, me një shkronjë Pulevski ka shkruar një fonemë, ka edhe dyshkronjësha si dhe ndonjëherë me një shkronjë ka paraqitur një rrokje (sipas rusishtes e bullgarishtes). Meqë gjatë përfaqësimit grafik të disa fonemave hetohet mospërputhje ndërmjet grafemës e fonemës, do të bëhet fjalë edhe për këtë mospërputhje.

Sistemi grafik i teksteve të Pulevskit, si edhe gjuha e tij, dallohet nga teksti në tekst dhe nuk është i njëjtë. Grafia e dy Fjalorëve të botuar në Beograd dallon nga grafia e teksteve të tjera të botuara në Sofje. Edhe dy fjalorët e Pulevskit botuar në Beograd në dallim kohor vetëm për dy vjet (Fjalori I më 1873, ndërsa Fjalori II më 1875) dallohen mjaft edhe në grafi. Fjalori katërgjuhësh është shtypur me alfabetin cirilik tradicional (me shkronja serbe-ruse-sllave), ndërsa në Fjalorin trigjuhësh është përdorur alfabeti cirilik i reformuar i Vuk Karaxhiqit.

Për sistemin grafik të Pulevskit kanë bërë fjalë disa gjuhëtarë maqedonas, ndër ta Trajko Stamatovski, Blazhe Koneski, Blazhe Ristovski, Tome Sazdov etj. Për shkrimin e të gjitha paraleleve gjuhësore të fjalorëve, d.m.th. në maqedonisht, shqip, greqisht e turqisht është përdorur i njëjti alfabet. Në këtë punim kemi parë se me çfarë vlere është përdorur ky sistem grafik për të shënuar fonemat e idiolektit shqip të Pulevskit.

Për të pasur një pasqyrë më të qartë për grafinë e Pulevskit, më poshtë po shënojmë dy alfabetet, të fjalorit I dhe të Fjalorit II:

Alfabeti i Fjalorit katërgjuhësh:

Alfabet fonetik							
A a	Б б	Ц ц	Ч ч	Д д	Е е	Ь (ь)	Ф ф

Г г	Ђ ђ	Х х	И и	Ј ј	К к	Л л	Лл л
М м	Н н	О о	П п	Ђ ђ	Р р	С с	Ѓ ғ
Т т	Ө ө	У у	В в	Ц ц	З з	Ж ж	
Alfabet rrokjesor							
Ѓ	Ј ја	Ју ју	Ы ы				

Alfabeti i Fjalorit trigjuhësh:

Alfabet fonetik							
А а	Б б	Ц ц	Ч ч	Д д	Е е	-	Ф ф
Г г	Ђ ђ	Х х	И и	Ј ј	К к	Љ љ	Л л
М м	Н н	О о	П п	Ђ ђ	Р р	С с	Ш ш
Т т	Ө ө	У у	В в	Ц ц	З з	Ж ж	
Alfabet rrokjesor							
Је је	Ја ја	Ју ју	Ји ји				

Nga këto dy tabela të alfabeteve, mund të shihet se pjesa më e madhe e shkronjave është e njëjtë në të dy Fjalorët. Numri i shkronjave në paralelen shqipe në të dy Fjalorët është i njëjtë – 35 shkonja, me dallim që në Fjalorin I përdor edhe një shkronjë më tepër, siç e quajnë në gjuhët sllave “erin e madh” <ѣ>, por pa ndonjë vlerë fonematike.

**Pasqyrë e grafisë së fjalorëve të Pulevskit krahasuar me alfabetin e sotëm të shqipes.** - Edhe gjatë përpunimit të sistemit grafik të tekstit shqip të të dy fjalorëve të Pulevskit i kemi krahasuar grafemat që na dalin këtu me shkronjat e alfabetit të gjuhës shqipe. Mirëpo për të përfutur një ide sa më të qartë të alfabetit të Pulevskit, po japim edhe një pasqyrë që dëfton vlerën kryesore fonematike të shkronjave, duke shënuar majtas shkronjat e alfabetit të sotëm të shqipes e djathtas shkronjat e përdorura në fjalorët në shqyrtim:

Abëcëja e shqipes	Alfabeti i Pulevskit	Shembuj
<b>a</b>	а	вла, влаа, авул, машкул, кока, калаа
<b>b</b>	б	барка, барна, букур, брум, бјешка, мбас
<b>c</b>	ц	цопа, гац, маца, циљи, цопаџоп, копуц
<b>ç</b>	ч	чаји, че кач, чепъ, те пача, чиш
<b>d</b>	д	дита, дега, перенди, дии, дамъ, вдесин
	д	еде, и мад, у збард, у дерд, ден, верд, уда
	ј	ји
	л	ул, ултар
	лл	улла, уллтар
	е	пела, деле, беса, рее, тетъ, леш
	ѣ	нѣсеръ, мѣс
	-	з-м-р, з-м-рат
	е	катеръ, ка веше, аште
	ь	катъръ, вогълъ, мьзъ, с’ьштъ, кьмбъ

	ъ	ъштъ, къпуцатъ
	-	т-и, з-м-р, вог-лъ, к-та, м-нцес, данд-р
<b>f</b>	ф	фара, фрор, фтохт, фич, нофула
<b>g</b>	г	гуръ, гропа, гомари, гаць, груа
<b>gj</b>	ђ	ђат, џашт, џиџ, џит, џуђи
<b>h</b>	х	ханат, фтохт, духет, џуха, у хођ
	и	мишин, кии, шии, миир, зотнии, дети
	ы	дылли бые, фаы, ны, сыи, сыт, џумшты
<b>j</b>	ј	јан, јет, маји, уји, вјети, бије, кусија
	я	вия, зона, гоа, яка, фяли, мялти, бия
	ѣ	бринѣ, џунѣт
<b>je</b>	ѣ	мѣкра, вѣра, пѣшт, пѣргулл, нѣрс
<b>ju</b>	ю	юве, пјуте, јю, јюве, фјютуръ
<b>k</b>	к	кам, нук, кафе, кур, калнор, ка
	лъ	лъуље, фольим, џуми, џопа, пельа, делье
	л	лелек
	л	бал, троли, Анадол, славјан, коломбођ
	лл	ветулла, молла, каллнор, даллга
<b>m</b>	м	мбас, муји, манастир, земра, шум
<b>n</b>	н	нук, на, натан, вендин, јан, анза
	њ	њи, џом, џофе, џерии, доњи, нањи
	ня	дуња, зона, няни, куняа
<b>o</b>	о	ода, зот, нофула, пошта, вдор, мос бон
<b>p</b>	п	перенди, пор, па, апо, паша, пруа, прсе
<b>q</b>	ћ	ћелћеџи, дућан, ћора, шећер, шћепон
<b>r</b>	р	кур, мир, лепуръ, грош, корба, кумри
<b>s</b>	с	соръ, беса, роса, прсе
<b>sh</b>	ш	шкалль, дашъ, деш, душк, шкиле, шкип
<b>t</b>	т	трупа, пует, сахат, дит, труп, те мрети
	џ	џаш, џон, џоште, дриџ
	т	тире, тошин, тесат, рет, џита, тес, ктес
	с	суа, дрисъ, сартъ, џисъ, мбасуръ, сатъ
<b>u</b>	у	дул, пруа, фуш, унда, гуша, кумбулла
<b>v</b>	в	венди, вера, вии, вдор, ветулла, јава
<b>xh</b>	џ	џал, џепат, џамиит, миџъ, џеваир
<b>Y</b>	уи	дуи, друи, суи, дуимадијет, дуизет
<b>z</b>	з	зине, забель, збразе, брез, шкозъ
<b>zh</b>	ж	жаба, жив, аждер

Veçoritë kryesorer fonologjike e fonetike të tekstit shqip të fjalorëve të Pulevskit janë:

1. *Dallimi fonologjik i gjatësisë së zanoreve.* Zanoret e shkurtra dhe të mesmet i regjistron vetëm me një shkronjë, ndërsa të gjatat, marrë në tërësi, me dyzimin e po të njëjtave shkronja.

2. *Inventar fonemash pa zanore hundore.* - Duke u mbështetur në kundërvëniet me vlerë fonologjike të shkallës së gjatësisë së fonemave zanore (të shkurtra ~ të gjata), pa serinë e fonemave hundore (nga se nuk i ka), mund të pohojmë se shqipja e Fjalorëve të Pulevskit në rrokje të theksuar ka gjithsej 12 fonema zanore: /a/, /a:/, /u/, /u:/, /e/, /e:/, /o/, /o:/, /i/, /i:/, /Y/ dhe /ë/.

Analiza e tekstit shqip të këtyre Fjalorëve na nxori 26 fonema bashkëtingëllore. Në krahasim me shqipen standarde këtu mungojnë paragjuhlorja afrikate e zhurmët [x], sonorja shumëdridhëse [rr] dhe laringalja [h].

3. *Zanorja [ë].* - Siç dihet në të folmet e gegërishtes [ë]-ja është e paqëndrueshme: ajo nuk përdoret asnjëherë në rrokje të theksuar dhe nuk bën pjesë në inventarin e fonemave zanore, d.m.th. në të folmet geqe ka statusin e tingullit, por jo edhe të fonemës. Mirëpo, te shkrimi i shqipes në fjalorët për të cilët po bëjmë fjalë jemi të mendimit se ekzistojnë pak shembuj të ruajtjes së kësaj zanoreje edhe në pozitë fundore.

4. *Buzorëzimi i zanores [ë] në [o].* - Te Pulevski vërejtëm këto raste buzorëzimi të [ë] > [o]: numor (< numër) I 9, pollomba (< pëllëmba) I 24, thongjill (< thëngjill) I 38, kopucar (< këpucar) I 55, fomei (< fëmijë) II 155, tono (< tonë) II 70 e 74 dhe ndonjë rast tjetër.

5. *Buzorëzimi i [a]-së hundore të mbarë gegërishtes në [o].* - Në fjalët si nona < nana, bojet < bahet II 87, hona < hana, bone < bane etj. [a]-ja hundore, dikur e mbarë gegërishtes, buzorëzohet aq shumë sa që në fjalorët e Pulevskit është shndërruar plotësisht në zanoren e buzorëzuar [o].

6. *Qiellzorëzimi i [ë]-së në [i].* - Zanoren gjysmë të hapur të radhës së mesme [ë] në rrokje të patheksuar në disa raste e gjejmë të qiellzorëzuar.

7. *Rënia e [ë]-së para sonoreve [r, l, ll, m, n, nj].* - Përpos rasteve (që shënuam) të ruajtjes së zanores [ë] para bashkëtingëlloreve tingëlluese, mjaft e shpeshtë është dukuria e rënies së kësaj zanoreje në pozitë para sonanteve.

8. *Diftongimi dytësor i zanoreve të theksuara [i] dhe [u].* - Shpërbërja e [i]-së dhe e [u]-së së theksuar në paralelen shqipe të fjalorëve të Pulevskit është dukuri fonetike mjaft e shpeshtë, që është karakteristik për tërë krahinën e principatës së Kastriotëve, përkatësisht grupin e të folmeve të gegërishtes qendrore.

9. *Monoftongimi i grupzanorshit [ue] ose [ua] në [u:].* - Grupi vokalik [ue] është monoftonguar në [u:] të gjatë dhe si i tillë në pak raste është ruajtur në Fjalorët e Pulevskit., si du:l (< doli) I 15, II 70; bu:ll (< buell, buall) I 41, kapru:ll (< kapruell) I 47, shkru:r (< shkruar) I 61, besu: (< besue, besuar) I 68, i kullu:m (< i kulluem, i kulluar) I 90 etj. Këto janë raste të rralla ku [u]-ja e theksuar i ka përballuar risisë diftonguese.

10. *Prania jo e vogël e togut zanor [ua].* - Togun vokalik [ua] e kemi hasur në disa fjalë në shqipen e fjalorëve të Pulevskit.

11. *Ka forma të rotacizuara.* - Krahas formave të fjalëve me [n] ndërzanore, kur dihet se fjalorët janë shkruar në dialektin e gegërishtes: pruna I 68, i pasun I 69, xhilpan

I 88, barna II 6 etj., ka edhe një numër të konsiderueshëm fjalësh në formë të rotacizuar, si bie fjala: egërsira II 9, ature (atyre) II 13, 15; i varfër, vllazër II 67, verë (pije), diturija I 59, I 88; breshër II 88, si dhe në pjesoret toske shitur I 88, shtrirë I 72, shkurtuar, çiruar I 72; mbledhur, zbuluar, grisur I 71, gëzuar I 59, shitur I 88 etj.

12. *Zhbuzorëzimi i [y]-së në [i].* – Zanorja e përparme e mbyllur [y] në të shumtën e rasteve është zhbuzorëzuar në [i]: tlin < tëlin < tëlien < tëlyen I 39, brim < brymë, fill < fyell I 57 etj.

13. *Shpërbërja dytësore e [y]-së në [ëi] dhe rrallëherë në [ei].* – Te një numër i konsiderueshëm fjalësh [y]-ja e theksuar, përveç që është zhbuzorëzuar në [i], ajo pastaj ka evoluar edhe më tej dhe, sipas rrethanave fonetike, është diftonguar në [ëi]: fëit < fit < fyt, frëim < frim < frymë, sëi < si < sy etj.

14. *Shndërrimi i [y]-së në [u].* – [Y]-ja e mbarë shqipes në fjalorët e Pulevskit në pak raste ka evoluar në [u], si te shut < shyt I 42, çush < çysh II 71, kruqa < kryqa II 73, nrushe < ndryshe II 72 e në ndonjë fjalë tjetër.

15. *Përdorimi i një [y]-je më pak buzore se e rëndomta.* – Përveç shumë zhvillimeve të larmishme që ka pësuar zanorja [y] në shqipen e shkruar të fjalorëve të Pulevskit, na ra në sy edhe përdorimi i një [y]-je më pak buzore se ajo e rëndomta, të cilën e ndeshim të shkruar me kombinimin e shkronjave <ui>, ne do ta shënojmë me [Y].

16. *Përdorimi i grupit [vo] në fillim të fjalës.* – Në fjalorët e Pulës e kemi hasur grupin [vo] në fillim të fjalëve, që është karakteristik për dialektin verior të shqipes.

17. *Togzanori [ie] është monoftonguar në [i:].* – Për ta përdëftuar këtë dukuri fonetike po mjaftohemi të sjellim dy shembuj të shënuar nga dy herë: dilli (< dielli) I 91 dhe II 70; çilli (< qielli) I faqe 11 dhe faqe 14.

18. *Afrikatizimi i qiellzoreve [q, gj] në [ç, xh].* – Sipas gjendjes faktike, fjalorët e Pulevskit karakterizohen me praninë e dy çifteve bashkëtingëlloresh: bashkëtingëllore qiellzore ~ bashkëtingëllore afrikate, por shpeshherë dallimi i tyre nuk del i qartë, d.m.th. bëhet përzierja e tyre në të shkruar.

19. *Humbja e kundërvënies fonologjike e fonemave /r/ ~ /rr/. – Në të folmen e Dibrës si dhe në shqipen e fjalorëve të Pulevskit nga sistemi bashkëtingëllor është zhdukur shumëdridhësja /rr/ dhe vendin e saj e ka zënë dridhësja simotër /r/ në të gjitha pozicionet e fjalës*

20. *Ruajtja e grupeve të bashkëtingëlloreve [mb], [nd], [ng] me pak përjashtime.* – Përgjithësisht, mund të themi se në tekstin shqip të fjalorëve të Pulevskit grupet e bashkëtingëlloreve [mb, nd, ng] janë ruajtur të papërngjashmuara.

21. *Përdorimi i rrallë i mesgjuhores [j].* – Bashkëtingëllorja mesgjuhore sonante shtegore [j] në shqipen e dy fjalorëve për të cilët jemi duke bërë fjalë përdoret mjaft rrallë, krahasuar me dendurinë e përdorimit të rëndomtë në gjuhën e sotme shqipe, po edhe me dendurinë relativisht të madhe të saj në të folmet shqipe.

22. *Grupet e vjetra konsonantike [kl], [gl] kanë evoluar në [q] e [gj].*

23. *Grupet e bashkëtingëlloreve [pl, bl, fl] janë paraqitur në variante të ndryshme.* – Grupin e parë konsonantik e gjejmë të shënuar në dy forma: [pl] dhe [pj], ndërsa grupi [bl] në fjalorët e Gjergjit del si [bj]. Edhe [fl]-ja në fjalorët në vështrim ka dhënë [fj].

24. *Qiellzorëzimi i grupeve [tj] > [q] dhe [dj] > [gj].*

25. *Qiellzorëzimi i [g]-së në [gj] në disa raste.*

26. *Shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në pozitë fundore.*

27. *Rënia e bashkëtingëllores glotale shtegore të shurdhët [h].*

28. *Ruajtja e grupit bashkëtingëllor [fsh].* 29. *Shndërrimi [th] > [f].-*

30. *Këmbimi [f] > [v].*

31. *Zëvendësimi [h] > [f].*

32. *Metateza.* – Kjo dukuri fonetike, e ndërrimit të tingujve ose të rrokjeve brenda fjalës, në shqipen e fjalorëve të Pulevskit është e shpeshtë.

33. *Përngjashmimi.* – Dukuria e përngjashmimit të tingujve është e shpeshtë në tekstin shqip të fjalorëve të Pulevskit. Vërehet asimilimi i zanoreve dhe i bashkëtingëlloreve, por më i shpeshtë është përngjashmimi i zanoreve, sidomos asimilimi i plotë në largësi.

34. *Përngjitja.* – Dukuria e përngjitjes ka një përhapje të madhe në shqipen e fjalorëve në shqyrtim.

35. *Shtimi i tingujve.* – Në tekstin shqip për të cilin po bëjmë fjalë ka një numër fjalësh me tinguj ose fonema të shtuara, të shprehura nëpërmjet grafemave. Kemi hetuar shtimin e tingujve në fillim të fjalës, në mes dhe në fund të fjalës.

36. *Rënia e tingujve.* – Dukuria fonetike e rënies së tingujve në tekstin shqip të fjalorëve të Pulevskit është më e shpeshtë sesa shtimi i tingujve. Gjuha e këtij autori i përket stilit të bisedimit dialektor, por edhe ky stil nuk është paraqitur me besnikëri, sepse ai qe autodidakt dhe duket se nuk e ka njohur aq sa duhet strukturën e fjalëve të shqipes. Sipas vendit ku bie tingulli ose grupi i tingujve edhe këtu kemi aferezë, sinkopë dhe apokopë.

**Larmi dialektore e shqipes së fjalorëve.** - Gjatë shtjellimit të grafisë si dhe veçorive fonologjike e fonetike të paraleles shqipe të dy fjalorëve shumëgjuhësh të Gjorgji Pulevskit na dolën në shesh një numër i madh veçorish gjuhësore që e karakterizojnë tekstin shqip në spikamë.

Për të nxjerrë përfundime të drejta vlejné të përmenden disa fakte nga jeta dhe veprimtaria e Gjergjit. Kështu, nga shkrimet shqipe që ka lënë trashëgim, mund të konstatohet se Pulevski nuk e ka njohur mirë as edhe ligjërimin dialektor të shqipes. Ishte autodidakt dhe sipas gjithë gjasash pa njohuri për traditën e shkrimit të letrave shqipe. U end mjaft dhe nuk qëndroi për një kohë të gjatë as në vendlindje e as në ndonjë vendbanim tjetër. I ati e mori me vete në Rumani qysh kur Gjergji kishte vetëm shtatë vjet. Pati kontakt me shumë individë, pjesëtarë të të folmeve të ndryshme të

shqipes. Njohu disa gjuhë ballkanike dhe tek ai u reflektua dukuria e ndërndikimit gjuhësor.

Nga jetëshkrimi për Pulevskin gjetëm mbështetje dhe arsyetim të tipareve dialektore të gjuhës së tij. Përgjithësisht, gjuha e Pulevskit është mjaft e larmishme nga aspekti dialektor. Duke e krahasuar shqipen e shkruar në Fjalorin Katërgjuhësh si dhe në Fjalorin Trigjuhësh me studimet dialektore për disa të folme shqipe, të përafërta me gjuhën e fjalorëve në shqyrtim, kemi arritur në përfundim se:

a) Bazën dialektore të gjuhës së Pulevskit e përbën e folmja e vendlindjes së tij (e folmja e Rekës së Dibrës). Këtë e dëshmojnë, si bie fjala, mospërdorimi i fonemës /y/, përkatësisht zhburorëzimi i saj në /i/ dhe diftongimi dytësor i saj; shpërbërja dytësore e zanores së theksuar [i] në [ëi] dhe e [u]-së në [ou]; mosshqiptimi i ndërhundshëm i zanoreve që gjenden ose janë gjetur pranë bashkëtingëlloreve hundore; dallimi i gjatësisë së zanoreve: në zanore të shkurtra e të mesme kundrejt zanoreve të gjata; rënia e faringales [h] në të gjitha pozitat e fjalës; defonologjizimi i kundërvënies ndërmjet çiftit të tingëllueseve dridhëse /r/ e /rr/; mosafrikatizimi i qielzoreve [q, gj]; ruajtja e grupeve të bashkëtingëlloreve [mb, nd, ng] përgjithësisht të parrëgjua; qiellzorëzimi i shpeshtë i prapagjuhores [g] në [gj]; mbizotërimi i zhvillimit të grupeve [pl, bl, fl] në [pj, bj, fj]; qiellzorëzimi i grupeve të vjetra konsonantike [kl, gl] në [q, gj] dhe mosafrikatizimi i tyre; etj.

b) Prania e një numri të konsiderueshëm veçorish gjuhësore tipike për toskërishten, si: përdorimi i /ë/-së në rrokje të theksuar; rotacizmi, shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në pozitë fundore të fjalës; shquarsia e emrave të gjinisë mashkullore që mbarojnë me temë në bashkëtingëlloret [k, g, h] me mbaresën –u; e pakryera asigmatike e foljeve në formën veprore; përdorimi i lidhores e jo i paskajores gege, përdorimi i pjesoreve të toskërishtes si dhe shumë veçori të tjera.

c) në tekstet shqip të fjalorëve të Pulevskit aty-këtu hetohen edhe disa tipare të të folmeve të tjera të gegërishtes (e jo të të folmes së qarkut të Dibrës), veçmas të të folmeve të rrethit të Gostivarit e të Kërçovës, të cilat për nga sasia janë më të pakta. Zaten, shpeshherë vërehen veçori që janë karakteristike për grupin e të folmeve të gegërishtes verilindore si dhe për disa grupe të tjera të folmesh, si p.sh. burorëzimi i [a]-së hundore të mbarë gegërishtes në [o]; monoftongimi i grupit [ue] në [u:]; afrikatizimi i bashkëtingëlloreve mesgjuhere [q, gj] në [ç, xh]; përngjashmimi i rrallë i grupeve [mb, nd, ng] në [m, n, g e k]; qiellzorëzimi i grupeve të bashkëtingëlloreve [tj] > [q] e [dj] > [gj] etj.

Në bazë të vëzhgimit filologjik, përmbledhtas, mund të themi se shqipen e fjalësve të Pulevskit e karakterizojnë:

a) tipare fonetike e fonologjike, morfologjike e leksikore të të folmes së qarkut të Dibrës, të cilat mbizotërojnë;

b) tipare dialektore të të folmeve të tjera gege, që bashkëpërkojnë veçmas me të folmen e Gostivarit e të Kërçovës;

c) veçori dialektore të toskërishtes, dhe

ç) kalke, huazime e krijime fjalësh artificiale që nuk përkojnë me asnjë të folme shqipe.

Një karakteristikë e përgjithshme e gjuhës shqipe të paraqitur në fjalorët nga autori në fjalë është konstatimi se ligjërimi shqip i Pulevskit është mjaft i ndikuar nga gjuhët sllave.

Format morfologjike të fjalëve në të dy fjalorët gjykojmë se nuk paraqesin ndonjë interes e as që kanë rëndësi të madhe për gramatikën e gjuhës shqipe, as për dialektologjinë historike të shqipes e as për historinë e gjuhës shqipe, përkatësisht për morfologjinë historike të shqipes. Kësaj mund t'i shtojmë edhe faktin se në përgjithësi veçoritë dalluese në rrafshin dialektor janë më të mëdha në fushën e fonetikës e të fonologjisë sesa në morfologji.

Posa të mënjanoen gabimet e shumta e të rënda në format morfologjike të fjalëve shqipe, do të vërehet se baza morfologjike e gjuhës së tij është e folmja e vendlindjes, përkatësisht e folmja e Rekës së Dibrës.

Në lidhje me format rasore mund të themi se përdorimi i rasave në shqipen e fjalorëve në vështrim është shumë i pavend, saqë nuk kemi mundur të nxjerrim ndonjë sistem apo rregull për të parë mënyrën e përdorimit të tyre.

Në gjuhën e shkruar shqipe të Pulevskit kjo kategoria morfologjike e foljes na del e koklavitur, meqë autori nuk e ka njohur në thelb sistemin morfologjik të shqipes. Gabime janë bërë si në vetë, numër, kohë, diatezë, zgjedhim etj. Përgjithësisht, fjalorët janë shkruar në mënyrën dëftore. Përdorim më të madh gjejnë koha e tashme, koha e pakryer, e kryera e thjeshtë, e kryera, më se e kryera dhe koha e ardhme.

Përgjithësisht mund të thuhet se shqipja e fjalorëve të Pulevskit është një “amalgamë gjuhësore artificiale”: një gjuhë popullore joautentike, një stil që dëshmon nivelin e ulët të njohjes së natyrës së shqipes, me përzjerje të shqipes territoriale, me shumë ndikime të huaja joreale, pa ndarje morfologjike në shkrimin e fjalëve, përplot me kalke e krijime artificiale të autorit etj.

Duke pasur para vetes një përfaqësim të tillë të dobët të shqipes së një autodidakti, me grafi jokonsekuente e pa kritere të caktuara gjuhësore, kuptohet se e kishim mjaft të vështirë të gjejmë rregulla të përgjithshme për tërë sistemin gjuhësor të shqipes së fjalorëve. Megjithatë, jemi përpjekur të nxjerrim dhe t'i njoftojmë të interesuarit shqiptarë me tiparet kryesore të variantit shqip të të dy Fjalorëve.

Përktimi, sintaksa dhe leksiku i fjalësve të Pulës mund të jetë edhe temë shqyrtimi më vete, ngase siç dihet, autori ka qenë njohës i disa gjuhëve sllave e josllave dhe nuk ka mundur t'i ruajë të paprekura kodet gjuhësore të gjuhëve që i ka ditur, por përkundrazi te ky na del shumë qartë në shesh dukuria e ndikimit ndërgjuhësor. Prandaj, kjo temë sociolinguistike është me interes të trajtohet. Dukuria e interferencës gjuhësore te individët shumëgjuhësorë është e njohur në gjuhësinë e zbatuar. Ne me



këtë rast do të përpiqemi t'i vijëzojmë veçoritë themelore të përkthimit, sintaksës si dhe të leksikut të idiolektit shqip të Pulevskit.

Marrë në tërësi, fjalitë shqipe janë përkthim nga paralelja e tekstit në gjuhën sllave. Por, megjithkëtë, fund e krye fjalorët i karakterizon përkthimi “robërisht besnik” (ad literam), që e dëmtoi shumë tekstin shqip të fjalorëve. Kështu, Pulevski krijoi trajta e konstrukte të pamundshme në shqipe. Për mosnjohjen e natyrës së shqipes si dhe bastardimin e saj nga ana e autorit dëshmojnë mjaft qartë edhe përkthimi i disa përhëndetjeve dhe i shprehjeve përhëndetëse në faqet 75-78 të Fjalorit katërgjuhësh. Ka fjali ku edhe kuptimi (semantika) i tyre është mjaft i errët. Sasia e çrrugllimeve semantike, përveç pështjellimeve të tjera të shumta gjuhësore (fonetike, fonologjike, morfologjike, sintaksore) është shumë e madhe, zaten e kanë përfshirë tërë idiolektin shqip të Pulevskit.

Si njohës i përciptë i disa gjuhëve, si duket, Pulevski me belbëzimin e tij në shqipe është shembull tipik i përzjerjes gjuhësore. Në këtë pikëpamje, shumë gjurmë të gjuhëve sllave shihen në gjuhën e shkruar shqipe të këtij autori; gjurmë të shqipes në idiolektin e sllavishtes së tij, por edhe gjurmë të greqishtes e të turqishtes në dy gjuhët e përmendura. Praktikisht, gjuha e Pulës është **një amalgamë gjuhësore sllave - shqipe - greke - turke**. Kjo përzjerje gjuhësore vërehet në të gjitha rrafshet, si në fonetikë e fonologji, morfologji, leksik e sintaksë.

Nuk është i vogël edhe ndikimi sintaksor i shqipes në paralelen e shkruar të maqedonishtes.

Në bazë të studimeve gjuhësore është përdëftuar se forma më e shpejtë dhe më masive e ndikimit ndër-gjuhësor është huazimi leksikor. Kështu, edhe në fjalorët e Gjergjit, në ndikimet ndër-gjuhësore që janë pasojë e plurilinguizmit individual të autorit, në të gjitha rrafshet, padyshim leksiku zë një vend mjaft të rëndësishëm. Aty do të gjejmë një numër të madh fjalësh që janë të përbashkëta për shqipen, maqedonishten, turqishten e greqishten si dhe për gjuhët e tjera ballkanike; pastaj huazime leksikore sllave në gjuhën shqipe, albanizma në paralelen e maqedonishtes, orientalizma e greqizma në shqipen e sllavishten etj. Në gjuhën shqipe të fjalorëve të Pulevskit ka një numër të konsiderueshëm huazimesh leksikore orientale. Përgjithësisht, mund të thuhet se pjesa më e madhe e këtyre orientalizmeve edhe sot e kësaj dite përdoren në të folmen e Dibrës e më gjerë, por këta dy fjalorë nuk janë shumë të vërsuar me orientalizma. Ndonjë prej tyre tani më ka kaluar në leksikun pasiv të shqipes dhe janë historizma, si fjalët *eqim*, *imza* etj.

Ndikimet ndër-gjuhësore të gjuhëve në kontakt nuk bëhet vetëm në njërin kahje. Nga kjo rrjedh se edhe shqipja ka ndikuar në leksikun e sllavishtes së Pulevskit. Do t'i regjistrojmë disa albanizma që kemi mundur t'i hetojmë në paralelen e maqedonishtes së fjalorëve të Pulevskit: *farosh* (enë ku ruhen farat) I 34; *specare* (enë ku ruhet biberi i specave) I 35, *brek*, *breg* I 17; *musteqi*, *mustaqi* I 21, *vatra* I 38, *lopar* (bari lopësh), *plluk*, *pllug* I 57; *leshta*, *lesha*, *leshi* I 49, *përç* II 93, *buzi*, *buzët* II 37, *kokar* (ndoshta nga kokërr ose kokë, meqë qepujka del në kokë, në krye të qepës, qepujkë) etj.

Edhe greqishtja merr pjesë në interferencën gjuhësore të gjuhëve të përfaqësuara në fjalorët e Gjergjit. Për greqizma i kemi konsideruar fjalët *metron* (matë,

peshon) II 16, *gjoll* (liqen) II 18, *as, aspër* (para, monedhë) II 28, *kallogjer* I 25; *pras, praz* I 50, *daskall* (mësues) I 59 etj.

Do përmendur se huazimet leksikore përbëjnë një nga veçoritë leksikore të gjuhës së fjalorëve të Pulevskit. Megjithkëtë, karakteristikë kryesore e leksikut të shqipes së fjalorëve të tij është ajo se autori për nevojat e përkthimit më tepër krijoi fjalë të reja (neologjizma) sesa që huazoi.

Edhe përkundër faktit se fondi leksikor i fjalësve të këtij autori është mjaft i varfër, Pulevski nuk diti të shfrytëzojë pasurinë e madhe e të pashterrshme të fjalëve shqipe. Ai për nevojat e përkthimit ndonjë fjalë e ka përdorur me vend, por shpeshherë krijoi edhe shumë fjalë të tjera në mënyrë artificiale: disa nga to janë kalke, disa krijim i paqëlluar i autorit me brum të shqipes, shpeshherë emërzoj folje etj. Përgjithësisht, edhe fusha e leksikut, si edhe e rrafshëve të tjera gjuhësore pasqyron gjuhën e një individi. Ajo nuk e paraqet me besnikëri shqipen e folur të shekullit XIX në anët e Maqedonisë perëndimore. Megjithë shumë pështjellime, gabime e paqartësi që ka gjuha e këtij autori, ajo mbështetet në të folmen e Dibrës dhe të qarkut të saj.

Tipar tjetër i leksikut të shqipes së fjalorëve të Pulës është edhe përdorimi i herëpashershëm i sinonimeve për të shpjeguar e qartësuar më mirë fjalët. Kjo mund të konsiderohet edhe si përpjekje e autorit për t'i kapërcyer kufijtë vendorë dhe vepra të ketë karakter më të përgjithshëm e përdorim më të gjerë.

**SUMMARY**  
**THE PARALLEL IN THE ALBANIAN IN THE TWO DICTIONARIES**  
**OF GJORGJI PULEVSKI**

The ultimate objective of this study is to present the Albanian language, more accurately the Albanian idiolect of Gjorgji Pulevski in his two multilingual dictionaries: I. The Macedonian-Albanian-Turkish-Greek Dictionary; Belgrade, 1873 and II. The Conversational Dictionary in three languages: Macedonian-Albanian-Turkish, Belgrade, 1875.

But, perhaps the greatest strength and uniqueness of this study comes from its contrastive approach; it describes clearly and compares the two dictionaries of Pulevski, being based on the first original edition of the two dictionaries.

In the linguistic analysis of the Albanian language in the two previously mentioned dictionaries, one can notice the application of the classical method of the philological analysis, more precisely the method of analysis, synthesis, the contrastive method, the statistic method, et cetera.

The study “The parallel in the Albanian in the two dictionaries of Gjorgji Pulevski” shows an adequate adduction of bio-bibliographical data about the author, information on the most important achievements in his life, a study of the form and structure of the dictionaries and their significance, afterwards it analyses the graphical characteristics, the phonetic and phonological points in the Albanian language in these dictionaries, the common problems in translation, the lexical and syntax characteristics. We have analyzed the Albanian language in these dictionaries through the dialectal prism and finally resulting in a precise summary.

Very different are the works of Gjorgji Pulevski. He was lexicographer, he wrote poetry, he traced the history of the latter back to fabulous times, he dealt with folklore, he fighter against the Ottoman Empire, he was a grammarian, etc. Pulevski was autodidact, with a profession of a mason (bricklayer), or as he Called himself an architect. Pulevski was born in Galičnik in 1838, a village in Malla Reka in Debar.

We are uncertain about the year of birth as there are some evidences that show that he might have been born fifteen or twenty years earlier. Nevertheless, he spent his childhood in Debar (Macedonian), whilst the most part of his life he spent in Belgrade and Sofia, taking an active part in the battle against the Turkish. In the linguistic characteristics one can notice that he came into touch with Albanians from different countries.

Gjorgji Pulevski edited two multilingual dictionaries: I. Macedonian-Albanian-Turkish-Greek Dictionary; Belgrade, 1873 and II. Macedonian-Albanian-Turkish Dictionary, Belgrade, 1875. They differ both in their structure and their alignment. The first dictionary may be called as an authentic dictionary; there is information and order-alphabetically listed words. In the first column we are given the words in Macedonian and in others we are given the translations.

There is lack of information about words, phonological information about how the word is pronounced, grammatical (syntactical and morphological) information about its part of speech (e.g. noun, verb) and inflections (e.g. for plural number or past tense), and semantic information about the word's meaning, the ambiguity of the word, its usage, et cetera.

The four linguistic dictionary enlists approximately 2560 words or phrases in Albanian having in regard that there are cases when one word appears in different forms i.e. the problem of polysemy and homonymy. This dictionary contains no more than 98 pages with the format of 35 x 42,5 inches. The words are divided into 74 branches of words, with different lexical fields.

The trilingual dictionary has altogether 162 pages of answered questions through sentences or complex sentences in three columns in Macedonian, Albanian and finally in Turkish.

Considering the time when the dictionaries were edited we should stress the fact that they merit to be listed in the rank of the multilingual dictionaries of that period and to be marked in the lexicography of Albanian language.

These dictionaries provide us a precious material (although not authentic) for the interlingual influences among languages from the Balkans during the nineteenth century.

The two dictionaries have a historical value for the Albanian logical studies, respectively for the languages and the culture of the Balkans. The alphabet that Pulevski used was phonemic being provided with the syllabic alphabet.

Generally speaking, he wrote in accordance with the phonetic rule according to which words are pronounced in the same way as they are spelled. In orthography, the phoneme is represented by a grapheme, for that reason the graphic system of Pulevski will be analyzed in our studies. In general, Pulevski used one letter for one phoneme although there are cases where two letters are used for a single phoneme and sometimes one syllable is represented by a phoneme (according to the Russian and Bulgarian language). One can notice the non-conformity between the graphemes and the phonemes which will be studied later in the course of one study.

The graphic system of the texts of Pulevski differs from one text to the other and is not similar. The graphic of the dictionary edited in Belgrade, 1873 differs from the dictionary edited in Belgrade, 1875. The first dictionary is printed in the traditional Cyrillic alphabet (with Serbian-Russian and Slavonic letters) while the trilingual dictionary is printed with the reformed Cyrillic alphabet of Vuk Karaxhiq.

The question of the graphic system of Pulevski has been object of study for many Macedonian linguists Ristovski, Tome Sazdov, and so on. The same alphabet has been used for the orthography of the linguistic parallels in the dictionaries, i. e. in Macedonian, Albanian, Greek and Turkish. In this study we have seen the value of this graphic system used to present the phonemes of the Albanian idiolect of Pulevski.

With the intention of making clear the graphic that Pulevski used we will illustrate the two alphabets, the alphabet of the first dictionary and that of the second dictionary.

The alphabet of the Macedonian-Albanian-Turkish-Greek Dictionary:

The phonetic alphabet							
А а	Б б	Ц ц	Ч ч	Д д	Е е	Ь (ь)	Ф ф
Г г	Ђ ђ	Х х	И и	Ј ј	К к	Л л	Лл л
М м	Н н	О о	П п	Ћ ћ	Р р	С с	Ш ш
Т т	Ѳ Ѳ	У у	В в	Ѣ Ѣ	З з	Ж ж	
The syllabic alphabet							
Ѣ	Ја ја	Ју ју	Ы ы				

The alphabet of the Macedonian-Albanian-Turkish Conversational Dictionary:

The phonetic alphabet							
А а	Б б	Ц ц	Ч ч	Д д	Е е	-	Ф ф
Г г	Ђ ђ	Х х	И и	Ј ј	К к	Љ љ	Л л
М м	Н н	О о	П п	Ћ ћ	Р р	С с	Ш ш
Т т	Ѳ Ѳ	У у	В в	Ѣ Ѣ	З з	Ж ж	
The syllabic alphabet							
Је је	Ја ја	Ју ју	Ји ји				

These two tables indicate that the number of the letters in these dictionaries in Albanian is the same – 35 letters, but we should point out that two dictionaries have only one difference. The first dictionary has more letter than the second dictionary, but of course of no great phonemic value.

**The graphic system in the dictionaries of Pulevski in comparison with the Contemporary Albanian alphabet.** – In the course of the elaboration of the graphical system of the texts in Albanian of the two dictionaries of Pulevski we have compared the graphemes that come from the dictionaries with the letters of the alphabet of the Albanian language. With the purpose to gain an explicit idea of the alphabet of Pulevski we will illustrate a table pointing at the essential phonemic value of the letters by writing of the left side the letters of the alphabet of the Contemporary Albanian language while on the right side will be written the letters used in the dictionaries of Pulevski:

The Albanian alphabet	The alphabet of Pulevski	Examples
<b>a</b>	а	вла, влаа, авул, машкул, кока, калаа
<b>b</b>	б	барка, барна, букур, брум, бјешка, мбас
<b>c</b>	ц	цопа, гац, маца, циљи, цопацоп, копуц
<b>ç</b>	ч	чаји, че кач, чепъ, те пача, чиш
<b>d</b>	д	дита, дега, перенди, дии, дамъ, вдесин
	д	еде, и мад, у збард, у дерд, ден, верд, уда
	ј	ји
	л	ул, ултар
	лл	улла, уллтар
	е	пела, деле, беса, рее, тетъ, леш

<b>e</b>	ѣ	нѣсеръ, мѣс
	-	з-м-р, з-м-рат
	с	катеръ, ка веше, аште
	ь	катъръ, вогълъ, мьзь, с'ьштъ, кьмбь
	ъ	ьштъ, кьпуцатъ
	-	т-и, з-м-р, вог-лъ, к-та, м-нѣс, данд-р
<b>f</b>	ф	фара, фрор, фтохт, фич, нофула
<b>g</b>	г	гуръ, гропа, гомари, гаць, груа
<b>gj</b>	ђ	ђат, џашт, џиџ, џит, џуђи
<b>h</b>	х	ханат, фтохт, духет, џуха, у хоћ
	и	мишин, кии, шии, миир, зотнии, дети
	ы	дылли бые, фаы, ны, сыи, сыт, џумшты
<b>j</b>	ј	јан, јет, маји, уји, вјети, бије, кусија
	я	вия, зоня, гоя, яка, фяли, мялти, бия
	ѣ	бринѣ, џунѣт
<b>je</b>	ѣ	мѣкра, вѣра, пѣшт, пѣргулл, нѣрс
<b>ju</b>	ю	юве, пьоте, јю, јюве, фјютуръ
<b>k</b>	к	кам, нук, кафе, кур, калнор, ка
	лъ	лълье, фольим, џуми, џона, пеља, деље
	л	лелек
	л	бал, троли, Анадол, славјан, коломбоћ
	лл	ветулла, молла, каллнор, даллга
<b>m</b>	м	мбас, муји, манастир, земра, шум
<b>n</b>	н	нук, на, натан, вендин, јан, анза
	њ	њи, њом, њофе, њерии, доњи, нањи
	ня	дуня, зоня, няни, куняя
<b>o</b>	о	ода, зот, нофула, пошта, вдор, мос бон
<b>p</b>	п	перенди, пор, па, апо, паша, пруга, прсе
<b>q</b>	ћ	ћелћеди, дућан, ћора, шећер, шћепон
<b>r</b>	р	кур, мир, лепуръ, грош, корба, кумри
<b>s</b>	с	соръ, беса, роса, прсе
<b>sh</b>	ш	шкалль, дашь, деш, душк, шкиле, шкип
<b>t</b>	т	трупа, пует, сахат, дит, труп, те мрети
	џ	џаш, џон, џоште, дриџ
	т	тире, тошин, тесат, рет, цита, тес, ктес
	с	суа, дрисъ, сартъ, џисъ, мбасуръ, сатъ
<b>u</b>	у	дул, пруга, фуш, унда, гуша, кумбулла
<b>v</b>	в	венди, вера, вии, вдор, ветулла, јава
<b>xh</b>	џ	џал, џепат, џамиит, миџъ, џеваир
<b>Y</b>	уи	дуи, друи, суи, дуимадијет, дуизет
<b>z</b>	з	зине, забель, збразе, брез, шкозь
<b>zh</b>	ж	жаба, жив, аждер

The basic phonological and phonetically features of texts in Albanian in the dictionaries of Pulevski:

1. *The phonological distinction in the inherent length of the vowels.*- The short and medium vowels are written by only one letter, whilst the vowels of longer duration, on the whole, are written by duplicating of the same letters.

2. *The inventory of phonemes without nasal vowels.* – Based on the counteraction of the phonological value on the length of the nasal phonemes (short ~ long), with the absence of the nasal phonemes (since it does not have), we state that Albanian language in the dictionaries of Pulevski has altogether 12 vowels in stressed syllables:

/a/, /a:/, /u/, /u:/, /e/, /e:/, /o/, /o:/, /i/, /i:/, /Y/ and /ë/. The analysis of the text in Albanian resulted in 26 consonants. When comparing to the Contemporary Albanian language we notice the absence of the affricate [x], the sonorous [rr] and the glottal fricative [h].

3. *The central half-open vowel /ë/.* – The vowel /ë/ in unstable or better said is variable in the Northern dialect of Albanian language it is not used in stressed syllables and it does not participate in the group of the vowels. Nevertheless, there are some cases of preservation of this vowel in orthography even in final positions.

4. *The vowel /ë/ undergoes a considerable change into /o/.*- We noticed this change in the dictionaries, for example: numor (< numër) I 9, pollomba (< pëllëmba) I 24, thongjill (< thëngjill) I 38, kopucar (< këpucar) I 55, fomei (< fëmijë) II 155, tono (< tonë) II 70 and 74, et cetera.

5. *The nasal vowel [ã] changes into [o] throughout the Northern dialect.* – In words like nona < nana, bohet < bahet II 87, hona < hana, bone < bane etc. the nasal [ã] formerly used in the Northern dialect, undergoes such a considerable change that is completely changed into the lip rounded vowel [o].

6. *The vowel [ë] changes into [i].* – The central, half-open, lax vowel [ë] when unstressed becomes [i].

7. *The loss of the central vowel [ë] when used in front of the sonorous sounds [r, l, ll, m, n, nj].* – This phenomenon is very often especially in pre sonorous positions.

8. *The vowels /i/ and /u/ become diphthongs.* – The joint of the stressed vowels [i] and [u] in the dictionaries of Pulevski is a phonetic phenomenon, and is typical of the region of the Kastriots' Principdom, respectively of the group of the Northern dialect of Albanian language.

9. *The diphthongs [ue] and [ua] change into the monophony [u:].* – The vocal grup [ue] has undergone a change into the vowel [u:], and such preserved in a few cases in the dictionaries of Pulevski, for example du:l (< doli) I 15, II 70; bu:ll (< buell, buall) I 41, kapru:ll (< kapruell) I 47, shkru:r (< shkruar) I 61, besu: (< besue, besuar) I 68, i kullu:m (< i kulluem, i kulluar) I 90, et cetera.

10. *The presence of the diphthong [ua].*- We have come across this diphthong many times in the course of the analysis.

11. Being aware of the fact that the dictionaries are written in the Northern dialect of Albanian language there are some exceptions i.e. forms where the

intervocalic [n] is changed into [r] in a considerable number of words, such as: egërsira II 9, ature (atyre) II 13, 15; i varfër, vllazër II 67, verë (pije), diturija I 59, I 88; breshër II 88, also in the participle mood of the Southern dialect such as: shitur I 88, shtrirë I 72, shkurtuar, çiruar I 72; mbledhur, zbuluar, grisur I 71, gëzuar I 59, shitur I 88, et cetera.

12. *Vowel [y] changes into [i].* – The front, close vowel [y] in most cases changes into [i], for example: tlin < tëlin < tëlien < tëlyen I 39, brim < brymë, fill < fyell I 57, et cetera.

13. *The diphthongation of [y] into [ëi] and sometimes into [ei].* – In a considerable number of words the stressed vowel [y] apart from being changed into [i] under some existing circumstances becomes a diphthong [ëi], for example fëit < fit < fyt, frëim < frim < frymë, sëi < si < sy et cetera.

14. *The assimilation of [y] into [u].* – Not very frequently has [y] evolved into [u], but there are some cases in the dictionaries that show this phenomenon: shut < shyt I 42, çush < çysh II 71, kruqa < kryqa II 73, nrushe < ndryshe II 72, etc.

15. The usage of vowel [y] which is slightly different from the common one, which is spelled in the group of letters such as <ui>, which we will write [Y].

16. *The presence of the group [vo] in initial positions.* – This group typical of the Northern dialect is present in the dictionaries of Pulevski.

17. *The diphthong [ie] has become [i:].* – In order to prove this statement we will use some examples: dilli (< dielli) I 91 dhe II 70; çilli (< qielli) I page 11, 14.

